

Hëna e Re

Viti XXXVI | Nr.377 | Shkurt 2023 | Rexheb - Shaban 1444 | Çmimi 50 den



**KËTË VIT,
DY MIJË HAXHINJ**



**HORIZONTE TË REJA
PËR THIRRJEN ISLAME**



**TËRMETI: TRISHTIM
DHE DHIMBJE NË TËRË BOTËN**

BFI: MAHDARI PËR 2 MIJË HAXHINJ

Më 20 shkurt, 2023, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu nënshkroi Marrëveshjen e Haxhit në Ambasadën e Arabisë Saudite në Tiranë, thuhet në njoftimin e BFI.

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV u prit nga Ambasadori i Arabisë Saudite në Tiranë, z. Fejsal bin Gazi Hifdhi, me të cilin nënshkroi Marrëveshjen Ministri e Haxhit (firmosur nga Ministri i Haxhit, dr. Teufik er-Rebiah) - Bashkësia Fetare Islame e RMV.

Marrëveshja - Mahdari përcakton kuotën prej 2.000 haxhinjve. Në të përfshihen të gjitha rregullat dhe kushtet e organizmit të Haxhit 2023 - 1444 H.

Reis'ul-Ulemanë në këtë udhëtim zyrtar e shoqëronin h. Abedin ef. Imeri, Myfti i Kumanovës; mr. Salim ef. Sulejmani, Myfti i Strugës; dhe h. Ismet ef. Ademi, Drejtor për Marrëdhënie me




Botën Arabe.

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu falënderoi Ambasadorin e Arabisë Saudite për pritjen vëllazërore, me të cilin

po ashtu u bisedua gjerësisht për shumë çështje dhe angazhime rreth bashkëpunimit në përgjithësi, thuhet në njoftimin e BFI.

GURI I ZI NË QABE (HAXHERUL ESVED)



Pejgamberi, Muhamedi (a. s.), ka thënë: "Guri i Zi ka zbritur nga xheneti dhe ishte më i bardhë se qumështi, por gabimet e bijve të Ademit e kanë nxirë atë."

"Vallahi, Allahu do ta ringjallë atë (Gurin e Zi) Ditën e Gjykimit; do të ketë dy sy që të shikojë, gjuhë që të flasë dhe do të dëshmojë për këdo që e ka përsëndetur atë me sinqeritet."

Allahu ua mundësoftë të gjithëve që të vizitojnë Qabënë dhe të përsëndesin Haxherul Esvedin.

(Nga Erjol Haxhiu/në bashkëpunim, F.4.02.2023)

PARIMI I PRIORITETEVE

Problemi kryesor te shumica e grupeve të rizgjimit islam është mungesa e njohjes së parimit të prioriteteve:

- Ata më shumë kujdesen për degët sesa për çështjet bazë dhe për gjërat sekondare sesa për ato esenciale.

- Ata kujdesen më shumë për çështjet për të cilat ka mendime të ndryshme nga dijetarët sesa për çështjet unanime të të gjithë dijetarëve.

- Ata nxisin beteja rreth një çështje nafile (vullnetare), në kohën kur njerëzit kanë braktisur farzet.

- Ata më shumë kujdesen për formalitetet dhe çështjet që duken sesa për çështjet substanciale.

(Nga Jusuf Kardavi; e solli në shqip: Naser Ramadani/në bashkëpunim)



EDITORIAL

PARA RAMAZANIT

Jemi duke i përjetuar ditët e muajit Shaban, muajit që karakterizohet me dy ngjarje të mëdha dhe të rëndësishme. E para është Nata e Beratit, e cila bie në natën e 15-të të muajit Shaban dhe e cila na e paralajmëron ardhjen e shpejtë të muajit Ramazan, muajit tonë më të dashur, kështu që sa më mirë duhet të përgatitemi shpirtërisht dhe fizikisht për agjërim dhe për ibadete të tjera.

Se çfarë nate është dhe çfarë rëndësie ka kjo natë, këtë më së miri na e përshkruajnë hadithet e Muhamedit (a. s.): "Në natën e pesëmbëdhjetë të muajit Shaban të gjitha veprat nxirren përpara Zotit të Gjithësisë. Për këtë arsye, unë dëshiroj që veprat e mia të nxirren para Tij deri sa unë jam duke agjëruar."

Karakteristika e dytë është ndërimi i Kibles së myslimanëve nga Mesxhidi Aksa në Jerusalem (Kuds) në drejtim të Qabesë, në Mekë, që është një ngjarje shumë e rëndësishme.

Lidhur me këtë ja se çka i thotë Allahu (xh. sh.) Muhamedit (a. s.): "Ne, shumë herë po e shohim kthimin e fytyrës tënde kah qielli e Ne gjithqysh do të drejtojmë ty në drejtim të një Kibleje (Qabesë) që ti e do atë. Pra, kthehu anës së xhamisë së shenjtë (Qabesë) dhe kudo që të jeni (o besimtarë) kthehuni kah ajo anë. E atyre që u është dhuruar libri, ata e dinë sigurisht se kjo (kthesë) është e vërtetë nga Zoti i tyre. E, Allahut nuk mund t'i fshihet ajo që vepronë ata." (El-Bekare: 144)

I dërguari i Allahut në këtë muaj i shtonte adhurimet, respektivisht ibadetet dhe veprimet e mira, si: agjërimin, sadakanë etj. Duhet theksuar se më së shumti që agjëronte Pejgamberi (a. s.) ishte në muajin Shaban, respektivisht e agjëronte shumicën e këtij muaj. Agjërimin gjatë këtij muaji ai e shoqëronte me shtim të ibadetit, e veçanërisht me namaz nafile gjatë natës.

Bazuar në veprimet e Pejgamberit (s. a.), besimtarët që e përjetojnë muajin Shaban e rritin vëllimin e punëve të mira, duke lexuar Kuran, duke shpërndarë lëmoshë dhe sadaka, duke u solidarizuar me të varfrit dhe njerëzit në nevojë, me qëllim që edhe ata të ndihmohen për pritjen e muajit të Ramazanit.

Përpjekjet e çdo besimtari për ta ngritur nivelin e devotshmërisë personale dhe për të arritur kënaqësinë e Krijuesit tonë gjithsesi do të shtohen edhe gjatë muajit Shaban, si një rrugëtim devotshmërie drejt muajit të madh, muajit Ramazan.

Ditët para nesh, deri më 23 mars të këtij viti, kur edhe fillon Ramazani, le t'i shfrytëzojmë për përgatitje për të pritur dhe përjetuar sa më mirë këtë muaj e të mirat e tij të shumëfishta. Ramazani është muaj i dritës absolute, muaj i adhurimeve, muaj i ngjarjeve të shumta të historisë islame, muaj në të cilin u shpall Kurani famëlartë, që është udhërrëfyes i vërtetë i njerëzimit dhe dallues i saktë i punëve të mira dhe të këqija.

Që jeta fetare islame gjatë këtij muaji të jetë në vrullin më të madh, për këtë do të kujdeset Bashkësia Fetare Islame e vendit tonë, së bashku me organet e veta bazë, respektivisht me të gjitha Myftinitë dhe institucionet edukativo-arsimore në nivel të Rijasetit. Për këtë qëllim, nga Rijaseti i BFI-së hartohet Programi i Ramazanit, i cili do të jetë pikënisja e të gjitha aktiviteteve që duhet bërë gjatë muajit Ramazan.

Në këtë drejtim, në radhë të parë duhet të sigurohet nëpunës fetarë për secilin xhematë, respektivisht për çdo xhami, të cilat po ashtu duhet të përgatiten me kushte optimale për të pranuar një numër sa më të madh besimtarësh. Po ashtu, nga ana e organizatës humanitare "Hilal" bëhen përpjekje që aspekti solidar dhe humanitar gjatë këtij muaj të jetë në nivelin më të lartë të mundshëm, me qëllim që të gjitha familjet në nevojë të kenë mundësi edhe ato ta përjetojnë me kënaqësi muajin e Ramazanit.

Revista "Hëna e Re", në përmbajtjen e saj lexuesve do t'u ofrojë punime të ndryshme kushtuar muajit të Ramazanit, si dhe informacione rreth aktiviteteve të realizuara gjatë këtij muaji. Me këtë rast, Redaksia e Revistës të gjithë lexuesve ua uron ardhjen e muajit të Ramazanit, duke e lutur Allahun (xh. sh.) që të na shpërblejë me shpërblimet e Tij të pakufishme për ibadetet e bëra gjatë këtij muaji.

Q. Osmani



PANEL SHKENCOR PËR ISRANË DHE MIRAXHIN



Më 17 shkurt, 2023, Rijaseti i BFI të RMV, nën patronazhin e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në sallën për konferenca të Hotel Bushit në Shkup mbajti një tribunë shkencore me rastin e Natës së Israsë dhe të Miraxhit më temë "Porositë e Israsë dhe të Miraxhit në kohën bashkëkohore", thuhet në njoftimin e BFI.

Pas fjalës hyrëse të Reis'ul-Ulemasë, pas urimeve që u përcollin besimtarëve për Natën e Israsë dhe të Miraxhit, fjalën e morën panelistët z. Shaban Neziri, z. Nusret ef. Fazliu dhe

z. Enes ef. Halili, të cilët iu qasën temës nga aspekte të ndryshme dhe lan një përshtypje të mirë.

Pjesëmarrës ishin shumë myftinj, drejtorë sektorësh, drejtori i Medresesë, administratorët e Paraleleve të Shtrira, mësimsdhënës dhe mësimsdhënese dhe shumë të pranishëm.

Organizimin e tribunës e menaxhoi h. Jusuf ef. Zimeri, Drejtor i Sektorit Fetar-Arsimor, në moderim të z. Musanif ef. Rufati, Drejtor i Sektorit për Shkencë dhe Kulturë, thuhet në njoftimin e BFI.

PËRTEJ PERDEVE TË SYRIT

Nga Hysein ef. Rizai

Sonte është nata kur qiejt buzëqeshin, sepse do të shohin fytyrën e bukur të Pejgamberit.

Sonte është nata kur i gjithë universi qëndron në heshtje, në pritje, sepse Zoti e pret zotëriun e njerëzimit atje ku koha ndalon.

Sonte është nata kur u bë farz namazi, që është drita e syve tanë, lartësimi i myslimanit dhe çelësi i xhenetit.

Është nata gjatë së cilës i zbritën të Dërguarit ajetet e fundit të sures Bekare.

Sonte është nata në të cilën Ebu Bekri merr epitetin es-Siddik (i sinqertë).

Sonte është Israja dhe Miraxhi!

Lutjet e bëra sonte pranohen. A nuk mbushen duart që janë të hapura sonte? A nuk falen myslimanët e sinqertë sonte?

O Ti që krijove këto mbretëri të pafundme nga një grimcë e vetme. O Ti që krijove këto bekime të pafundme për

robtë Tu!

Zoti ynë - i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti, Zoti Falës.

Sonte jemi pastruar nga papastërtitë e shpirttrave tanë. Sonte jemi të rrethuar nga besimi. Sonte u strehuam nën hijen e shpresave. Mos i kthe bosh këta duar që hapim, o Zot!

Ne sonte u penduam, me aq shumë krenari, nga arroganca, armiqësia, inati, tirania dhe fuqia.

Herët a vonë, ne do të kalojmë nëpër varr për të ardhur te Ju. Mos na trego mundimin e varrit, o Zot!

Na jep shiun e faljes sonte; atë shi të rrëmbyeshëm. Na e hap rrugën për në Xhenet; perdet Tuaja të dritës, le te na japin krahë.

Zot, të lutem, mos na turpëro neve, robtë, në Ditën e Gjykimit.

(Autori është Referent në Myftininë e Tetovës. F.17.02.2023)

HORIZONTE TË REJA PËR THIRRJEN ISLAME

"I dëlirë dhe i pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Tij e barti natën nga Mesxhidi Haram (Qabeja në Mekë) deri në Mesxhidi-Aksa (në Jerusalem), rrethinën e së cilës Ne e kemi bekuar, për t'ia treguar disa nga argumentet tona. Ai, me të vërtetë, dëgjon dhe sheh çdo gjë!" (Isra: 1)

Nga Enes Halili

Nata e Madhe e Israsë dhe Miraxhit konsiston në ecjen e shpejtë të Pejgamberit (a. s.), madje brenda një intervali kohor jo të gjatë të një nate, nga Meka deri në Kudsi-Sherif (Jerusalem) dhe kjo është ajo që quhet Isra. Ndërkaq, bartja prej aty, përmes horizonteve qiellore, deri sa është takuar me Allahun e Gjithëfuqishëm, është ajo që njihet si Miraxh i Pejgamberit (a. s.).

KUR KA NDODHUR KJO NGJARJE?

Në qoftë se iu referohemi të dhënave historike, në veçanti jetëshkrimet të Pejgamberit (a. s.), mund të konstatojmë se kjo ka ndodhur përafërsisht 16 muaj para se Pejgamberi (a. s.) të emigronte në Medinë, saktësisht në natën e 27 të muajit Rexheb të vitit 621 miladi, ose në vitin e 12-të pejgamberisë së tij, kur ai ishte 52 vjeç.

RRETHANAT SHOQËRORE

Në aspektin doktrinar, ndodhia e Israsë dhe Miraxhit ka ndodhur në periudhën e Mekës, kur shpallja kuranore ishte përqendruar në ngritjen e godinës së besimit dhe pastrimin e botëkuptimeve të gabuara dhe të shtrembëruara në besim nga mendja dhe jeta e njerëzve.

Ndërkaq, në aspektin shoqëror, kjo periudhë ishte periudha e ushtrimit të dhunës dhe të torturave mbi komunitetin mysliman, si tentim për t'i zmbarsur nga feja dhe për ta treguar superioritetin e palës idhujtare në shoqërinë mekase. Në këtë mënyrë, ata ua ngushtonin hapësirën myslimanëve dhe u jepnin mesazh se "aty nuk ka vend për një besim si i tyre, derisa ata janë zotërinj në atë tokë".

Megjithatë, në veçanti mund të theksohen ndodhitë vijuese që i paraprindë ndodhisë së Israsë dhe Miraxhit:

-Vdekja e Ebu Talibit, xhaxhait të Pejgamberit (a. s.), i cili, edhe pse nuk i besoi misionit të tij, i shtyrë nga ndjenjat familjare dhe fanatizmi fisnor, e mbrojti Muhamedin (a. s.) nga sulmet fizike të idhujtarëve. Duke e pasur parasysh autoritetin e Ebu Talibit dhe gatishmërinë e tij që ta mbrojë nga çdokush që e sulmon Muhamedin (a. s.), idhujtarët mekas, edhe pse nuk e pranorin thirrjen islame, e kishin rëndë që fizikisht ta maltretojnë të Dërguarin (a. s.). Pas vdekjes së Ebu Talibit, idhujtarët i intensifikuan sulmet fizike kundër Muhamedit (a. s.), gjë që nuk mund ta bënin derisa ishte gjallë ai.

-Vdekja e Hatixhes, gruas së parë të Pejgamberit (a. s.), e cila i qëndroi besnikë atij dhe ishte prej të parëve që i besoi në thirrjen islame. Krahas kësaj, ajo e vuri në shërbim të misionit të tij gjithë pasurinë e vet dhe në çdo mënyrë e mbronte dhe e përkrahte Muhamedin (a. s.). Ajo ishte grua e mençur, e sjellshme,



e cila e qetësonte Muhamedin (s.a.v.s.) në momentet e rënda që i përjetonte në rrugën e misionit që kishte marrë. Për këtë, vdekja e Hatixhes ishte humbje e një mbështetësi të denjë të faktorit njeri për të Dërguarin (a. s.) dhe, pa dyshim, vdekja e saj e mërziti Muhamedin (a. s.).

Në anën tjetër, shtimi i dhunës së idhujtarëve ndaj të Dërguarit (a. s.) bëri që ai të drejtohet për në Taifë, të mundohet që atje ta përhap thirrjen islame e të kërkojë përkrahje dhe mbrojtje. Mirëpo, edhe atje nuk gjeti pranim, përkatësisht ata në vend që t'i ofrojnë përkrahje, e refuzuan.

Kërkesat e politeistëve mekas që ta besonin si pejgamber Muhamedin (a. s.) ishin jashtë sferës njerëzore, saqë Pejgamberi (a. s.) u tha: 'Unë nuk jam dërguar për këto kërkesat tuaja; unë jam dërguar nga Allahu për t'u treguar juve atë që më është dhënë mua. Unë jua kumtova. Nëse e pranoni, edhe kjo botë edhe bota tjetër do të jetë në favorin tuaj. Në qoftë se e kundërshtoni, për shkak të pëlqimit të Allahut do të duroj.'

Në të gjitha këto rrethana ndodhi ngjarja e Israsë dhe Miraxhit, si përgatitje për fazën e re të misionit të tij, që bart me vete mesazhin e mbështetjes shpirtërore për Muhamedin (a. s.) dhe hapjen e horizonteve të reja për thirrjen islame.

Me fjalët e tjera, pasimi i ndodhisë së Israsë dhe Miraxhit pas këtyre ndodhive madhështore është mesazh i optimizmit dhe vullnetit për aktivitet, si dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme të Allahut të madhërishtë të gjithë asaj që ndodh mes njerëzve dhe të rrethanave në të cilat gjendet i dërguari i Tij. Ky udhëtim i dha vullnet Muhamedit (a. s.) dhe i bëri me dije se Allahu i madhërishtë nuk e ka lëshuar prej dore, edhe krahas rrethanave ekzistuese dhe përsheqjes së marrëdhënive me idhujtarët dhe dhunës që ata ushtronin mbi të dhe mbi ithtarët e tij, pas vdekjes së Ebu Talibit, në veçanti.

Allahu (xh. sh.) e përgatiti këtë rrugëtim për ta ngushëlluar zemrën e Pejgamberit (a. s.). Me anë të kësaj, Zoti e informonte se Ai kishte qenë duke e vëzhguar që nga dita kur Pejgamberi (s.a.v.s.) kishte deklaruar njësimin dhe adhurimin e Tij.

Kur jemi te konteksti historik i ndodhisë së Israsë dhe Miraxhit, duhet të ndalem edhe në reflektimin e kësaj ndodhie në jetën e ummetit në drejtim të ngjalljes së optimizmit dhe nxitjes së dëshirës për veprim për realizimin e qëllimeve, pa marrë parasysh rrethanat ekzistuese.

MESAZH I QARTË

I dërguari i Allahut (s.a.v.s.) u ballafaqua me këto ndodhi që e ngushtuan dhe e mërzitën shumë. Por, erdhi Israja dhe Miraxhi që e nxori mbi ambientin dhe rrethanat e rënda që e kishin ngushtuar, e bëri të shihte horizonte të gjera të paimaginueshme, që janë mesazh i qartë se Allahu i madhërishtë ia mundëson njeriut atë që as vetë ai nuk mund ta imagjinojë.

Ngjitja e të dërguarit të Allahut nga toka në sferat e larta qiellore simbolizon aspiratat e larta që duhet t'i ketë myslimani, edhe pse në një periudhë të caktuar historike mund të ballafaqohet me kriza të thella. Myslimani këtë fuqi dhe optimizëm e merr nga namazi ditor, i cili është urdhëruar pikërisht në Miraxh, edhe pse njeriu ndonjëherë ndoshta mund të ketë mendime pesimiste.

Myslimani duhet të shohë sa më larg, nga pozicioni i tij i ngjites në piedestale të larta përmes namazit, që është Miraxh për të. Pejgamberin (a. s.) sa herë që e mundonin kurejshitetë pabesimtarë, natyrisht që ndihej i thyer shpirtërisht.

Prandaj, Allahu (xh. sh.) deshi t'i tregonte të dashurit të Tij dhe ta siguronte se, sado që t'i vështirësohej fushëveprimi në tokë, Qielli do të jetë ai që do ta ndihmojë e do ta mirëpres dhe se Zoti i tij, i Cili e obligoi me këtë mision të pastër fisnik, me gjithë këto vështirësi e mundime, patjetër do ta ndihmojë e do ta bëjë triumfues.

Dhe, si përfundim do të citoj një fjali të mendimtarit të shquar islam Muhamed Gazali, i cili ka thënë: "Kjo ngjarje ishte një balsam për vuajtjet e së shkuarës dhe mbjellje e farave të suksesit për të ardhmen."

(Kumtesë e lexuar në Panelin shkencor "Porositë e Israsë dhe të Miraxhit në kohën bashkëkohore", organizuar nga BFI e RMV më 17 shkurt 2023 në Shkup. Autori është Imam në fshatin Odër, Tetovë)

ISRAJA DHE MIRAXHI, NË ATMOSFERA SHPIRTËRORE

SHKUP - Më 17 shkurt, 2023, në përkujtim të Natës së Israsë dhe të Miraxhit, Myftinia e Shkupit organizoi ligjëratë javore dhe manifestim në xhaminë "Ebu Bekër es-Siddik" në lagjen Butel, thuhet në njoftimin e MSH.

Mysafirët e këtij manifestimi u mirëpritën nga hatibi Abaz Memed, Imami Blerim Limani, Këshilli i kësaj xhamie dhe xhematlinj të lagjes. Abaz efendi shprehu falënderimet për përzgjedhjen e kësaj xhamie për manifestimin e kësaj nate.

Në një atmosferë shpirtërore, para kolegëve hoxhallarëve dhe xhematlinjve të pranishëm, mesazhet e Israsë dhe të Miraxhit i përcolli hoxha Shaban ef. Tahiri, hatib dhe mualim në fshatin Llokë - Saraj.

Krahas ligjëratës, këtë manifestim e begatuan edhe zërat e bukur të interpretesve të ilahive, të udhëhequr nga hzf. Fatih Derdiyok.

Të njëjtën ditë, në Xhaminë Qendrore në Hasanbeg, Myftinia e Shkupit realizoi dhe një program fetar dedikuar gjinisë femërore me rastin e Israsë dhe të Miraxhit.

Ky program u begatua me ligjëratë, në të cilën Arife Iseni para të pranishmeve përcolli mesazhet e Israsë dhe të Miraxhit.

Krahas ligjëratës, ky manifestim u pasurua edhe me ashere, me ilahi dhe me pjesë të Mevludit, thuhet në njoftimin e MSH.

TETOVË - Myftinia e Tetovës, me rastin e Natës së Israsë dhe të Miraxhit, më 17 shkurt, 2023, pas namazit të akshamit, organizoi manifestim fetar në Xhaminë Tabhane – Tetovë, thuhet në njoftimin e MT.

Në këtë manifestim, të cilin e moderoi mr. Xhemil ef. Sadiku, morën pjesë: Myftiu i Tetovës, prof. dr. Qani ef. Nesimi; Myftiu i mëparshëm Alifekri ef. Esati; Imami i Xhamisë, Sead ef. Demiri; kolegë nga Myftinia, hoxhallarë të tjerë nga vendi dhe rrethina, si dhe një numër i madh xhematlinjsh.

Para xhematit u prezantua një program fetar-kulturor nga disa nxënës të Medresës Isa Beu dhe studentë të FSHI, të udhëhequr nga Referenti për kulturë pranë Myftinisë së Tetovës, dr. Hysein ef. Rizai.

Programi filloi me lexim të Kuranit famëlartë dhe vazhdoi me ilahi dhe me kaside.

Myftiu i Tetovës në fjalën e rastit foli mbi vlerën e Natës së Israsë dhe të Miraxhit. Ai në fjalimin e tij potencoi që kjo natë e këtij viti, 17 shkurt 2023, na ka sjellë përpara një koincidence të dy ngjarjeve shumë të mëdha dhe të rëndësishme, ku njëra prej tyre është 28-vjetori i fillimit të ligjëratave të para në UT, ndërsa e dyta është 15-vjetori i Pavarësisë së shtetit të Kosovës, duke lutur Allahun fuqiptotë që të gjithë ata që kanë kontribuar për këto dy arritje t'i shpërblejë me shpërblimet e Tij të pamërta.

Në fund, Myftiu i bëri lutje Allahut fuqiptotë të na e mundësojë që këtë natë ta kalojmë në ibadet dhe të na mbulojë me mëshirën e Tij.

Manifestimi u mbyll me leximin e disa ajeteve nga hafëzi i mirënjohur, hzf. mr. Idriz ef. Osmani.

Duanë e këtij manifestimi e bëri Myftiu i mëparshëm Alifekri ef. Esati, i cili falënderoi dhe gjithë hoxhallarët që janë të ndjerë për sakrificën, për përkushtimin dhe kontributin që kanë dhënë në ngritjen e vetëdijes fetare, për punën e tyre të palodhshme gjatë shërbimit në rrugën e fesë islame, duke e lutur Allahun fuqiptotë që t'i shpërblejë me të mirat e Tij.

Në namazin e akshamit dhe të jacisë priu profesori i gjimnazit "7 Marsi", hzf. Naser ef. Rushani, thuhet në njoftimin e MT.

KËRÇOVË - Myftinia e Kërçovës, në Xhaminë e fshatit Zajaz Xhuma, realizoi ligjëratë me rastin e Natës së Israsë dhe të Miraxhit më 17 shkurt, 2023, thu-

het në njoftimin e MK.

Pas namazit të jacisë, mysafirët në Xhaminë e fshatit Zajaz Xhuma u mirëpritën nga Imami nikoqir, Muhamed ef. Mehmedi, nga Këshilli i Xhamisë dhe xhemati në përgjithësi.

Në këtë mbrëmje Myftinia e Kërçovës kishte mysafir Myftiun e Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili, i cili shoqërohej nga Referenti i Myftinisë, Fejsal ef. Kadriu.

Mbrëmja u hap me lexim të Kuranit famëlartë nga imami Xhabir ef. Emini, ndërsa më pas Myftiu i Kërçovës, Qamil ef. Rushiti, përshëndeti të pranishmit.

Fjalën kryesore e kishte Myftiu i Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili, i cili foli për vlerën e Israsë dhe të Miraxhit, duke nxjerrë dhe mesazhet edukative të kësaj ngjarjeje, e cila, siç dihet, ndryshoi rrjedhën e botës në përgjithësi dhe të myslimanëve në veçanti.

Pas ligjëratës u vijua me ilahi dhe kasidë nga vogëlushët Qemal dhe Abdylkader.

Mbrëmja u mbyll me lexim Kurani nga Qemal ef. Mahmudoski dhe me lutjen që u bë nga mysafiri, Fejsal ef. Kadriu.

Allahu i shpërbleftë të gjithë për mundin dhe angazhimin, thuhet në njoftimin e MK-Zyra për Informim.

GOSTIVAR - Tribunë fetare në Xhaminë e Vjetër të fshatit Forinë kushtuar Natës së Israsë dhe të Miraxhit më 18 shkurt, 2023, thuhet në njoftimin e MG.

Me ftesë të nëpunësve fetarë dhe të Këshillit të Xhamisë, kanë marrë pjesë: Myftiu i Gostivarit, h. Sabahudin ef. Zendeli, i shoqëruar nga Referenti h. Harbin ef. Osmani, hoxhallarë të zonës dhe shumë xhematlinj.

Ligjërues në këtë tribunë fetare ishte prof. dr. Abdulxhemil ef. Nesimi, profesor në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup dhe vaiz në Xhaminë e Kadrit në Gostivar, i cili e shtjelloi në detaje temën në fjalë.

Fillimisht, pas këndimit të Kuranit famëlartë dhe fjalës përshëndetëse të nëpunësve fetarë, Myftiu i drejtua xhematit të nderuar me disa fjalë të shkurtra, duke e përshëndetur këtë organizim të qëlluar.

Në namaz të jacisë priu h. Harbin ef. Osmani, Referent pranë Myftinisë së BFI-Gostivar, thuhet në njoftimin e MG.

KUMANOVË - Më 18 shkurt, 2023, pas namazit të iqindisë, Myftinia e BFI-Kumanovë organizoi tribunë fetare në xhaminë "Haxhi Shefket" të qytetit me rastin e manifestimit të Israsë dhe të Miraxhit, thuhet në njoftimin e MK.

Programi, i përgatitur nga Myftinia e Kumanovës nën udhëheqjen e h. Umej ef. Fejzuli, përmbante lexim të Kuranit famëlartë, këndim të disa ilahive nga Kori i Myftinisë, si dhe disa pjesë nga Mevludi.

Hapja e programit u bë me leximin e disa ajeteve kuranore nga h. Abdullah ef. Shaqiri, Imam në xhaminë "Haxhi Shefket". Pastaj të pranishmit i përshëndeti Imami i Xhamisë, hoxhë Rexhep ef. Bekteshi, duke u dëshiruar mirëseardhje pjesëmarrësve në këtë manifestim.

Në vazhdim, Myftiu h. Abedin ef. Imeri i përshëndeti të pranishmit dhe ua uroi këtë natë madhështore.

Pastaj fjala ishte e hoxhës së nderuar Berat ef. Ramadani, i cili ishte i përzgjedhur që të ligjërojë më gjerësisht për ngjarjen e Israsë dhe të Miraxhit.

Më pas, Kori i Myftinisë vazhdoi me disa ilahi dhe pjesë nga Mevludi dhe, në fund, pati dhe lexim të disa ajeteve kuranore nga hzf. Seid ef. Imeri, thuhet në njoftimin e MK, nënshkruar nga Myftiu Abedin ef. Imeri.

MANASTIR - Mbrëmje më plot shpirt në Xhaminë Hajdar Kadi në Manastir më 18 shkurt, 2023, duke përkujtuar Natën e Israsë dhe të Mi-

raxhit, thuhet në njoftimin e MM.

Mbrëmja kaloi me Kuran, me ligjëratë dhe me ilahi.

Kontributin e tyre e dhanë dhe mysafirët e lartë nga Turqia: Mustafa Mesten, Atashe për çështje fetare në Ambasadën e Republikës së Turqisë dhe hafëz Fatih Derdiyok. Pjesëmarrës ishte edhe Imami i Xhamisë Mustafa Pasha në Shkup, Abdusamed ef. Zeqiri, thuhet në njoftimin e MM.

STRUGË - Më 18 shkurt, 2023, Myftinia e Strugës në Halveti Teqe - Strugë organizoi manifestim fetar për nder të Natës së Miraxhit, thuhet në njoftimin e MS.

Programi, i moderuar nga Referenti pranë Myftinisë Musa ef. Biba, filloi me një ashere të lexuar nga Imami i fshatit Kalisht, Pajtim ef. Iseni.

Pastaj Kori i Xhamisë e zbukuroi këtë program me dy ilahi.

Mesazhin e kësaj nate e dha Myftiu i Strugës, mr. Salim ef. Sulejmani, i cili foli për mësimet e nxjerra nga kjo mrekulli madhështore.

Manifestimi përfundoi me një pjesë Kurani nga Imami i Xhamisë Mustafa Çelebi në Strugë, Izet ef. Nexhipi. Na qoftë me hair! – thuhet në njoftimin e MS.

OHËR - Myftinia e BFI-Ohër më 19 shkurt, 2023, me namazin e akshamit, organizoi manifestimin fetar "Isra & Miraxh" - "Në përkujtim të mrekullisë së Israsë dhe të Miraxhit" - në Xhaminë Tausanllë (Karabej-mëhallë), thuhet në njoftimin e MO.

Program ishte begatuar me Kuran, me ligjëratë, me pjesë nga Mevludi dhe me dua-hatme.

Rreth Israsë dhe Miraxhit folën h. Samet ef. Ajdari, Myftiu i Myftinisë së Ohrit, dhe Imami h. Sejfullah ef. Kalajci.

Paqja, mëshira, mirësitë dhe begatitë e Allahut të madhërishtëm qofshin gjithmonë mbi të gjithë ju, thuhet në njoftimin e MO.



Myftinia e Shkupit: ligjëratë javore dhe manifestim në xhaminë "Ebu Bekër es-Siddik" në lagjen Butel.



Nga manifestimi fetar në Xhaminë Tabhane - Tetovë.



Tribunë fetare në Xhaminë e Vjetër të fshatit Forinë (Gostivar) kushtuar Natës së Israsë dhe të Miraxhit.



Tribunë fetare në xhaminë "Haxhi Shefket" në Kumanovë.



Mbrëmje më plot shpirt në Xhaminë Hajdar Kadi në Manastir.

PËR "ETIKËN E RELIGJIONEVE" NË FILLORE

Fondacioni i mirënjohur "Konrad Adenauer", nën udhëheqjen e përfaqësuesit z. Daniel Braun, organizoi më 16 shkurt, 2023, në Shkup, një tryezë të rrumbullakët me temë "Religjioni në arsim - përvojat dhe sfidat", thuhet në njoftimin e BFI.

Në të me ligjëratë hyrëse mori pjesë Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i cili në fjalimin e tij foli për nevojën e vazhdimin të lëndës "Etika e religjioneve" në arsimin fillor, sepse ajo lëndë, tha ai, është pritur shumë mirë nga fëmijët dhe prindërit e tyre, ka ndikuar pozitivisht në ngritjen morale të nxënësve, (ajo) është vlerë bashkëkohore dhe, si e tillë, është e domosdoshme në kohën e anomalive të shumta që rrezikojnë rininë, si: alkoolizmi, narkomania, prostitucioni e të tjera.

Andaj, Kryetari i BFI të RMV kate-



gorikisht kërkoi që lënda "Etika e religjioneve" të vazhdojë; jo vetëm në një klasë, por në shumë klasa të tjera, respektivisht në shumë vite.

Të gjithë ishin të këtij mendimi, si: Mitropolit i KOM-AO, z. Josifi; dinjitari i Kishës Katolike, Vinko Maslač (Maslač); Kryetari i Bashkësisë He-

braike, z. Levi Pepi.

Në diskutim morën pjesë edhe deputetët e Kuvendit të RMV, si: Arbër Ademi, Zhaklina Llazarevska dhe Nikola Micevski, të cilët po ashtu dhanë mendimin se lënda fetare duhet të vazhdojë të jetë pjesë përbërëse e arsimit fillor, thuhet në njoftimin e BFI.

BFI STARTON ME PROJEKTIN "NË SHËRBIM TË JETIMËVE"

Më 13 shkurt, 2023, Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë së Veriut doli me Njoftim, në të cilin thuhet:

Të nderuar besimtarë!

Rijaseti i BFI të RMV ju njofton se starton me implementimin e projektit nën moton: "Në shërbim të jetimëve", mbështetur nga organizata "Hilal el-Ahmer" nga Emiratet e Bashkuara Arabe.

Projekti ka të bëjë me përkujdesjen e jetimëve në të gjithë territorin e Maqedonisë së Veriut dhe do të përfshijë shifrën deri 5000 (pesë mijë) jetimë.

Projekti përfshin: asistencën mujore në mjete financiare; pagesën e harxhimeve shkollore duke përfshirë paketa për fillim të vitit; organizimin e kurseve, seminareve dhe trajnimeve të ndryshme për jetimët; organizimin e ekskursioneve të ndryshme; dhurimin e teshave verore dhe dimërore; paketa ushqimore të Ramazanit dhe të Bajramit; paketa për ngrohje si: dru etj.; mbështetje të fëmijëve që tregojnë aftësi të ndryshme; paketa shëndetësore.

Ky njoftim në formë qarkoreje u është përcjellë të gjitha Myftinive të BFI, andaj kërkohet prej jush që sa më shpejt të paraqiteni në Myftininë së cilës i takoni, që të sjellin numrin e jetimëve nga xhamatet, me qëllim të kompletimit të listave.

KUSHTET që duhet të plotësojë çdo aplikues janë:

Jetim i mbetur pa baba ose dy prindërit.

Të jetë i moshës deri në 13 vjeç;

Nga një familje mund të regjistrohet një numër i pacaktuar jetimësh.

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:

1. Certifikata e lindjes

2. Certifikata e vdekjes së prindit;


3. Dy fotografi

4. Numri i telefonit për kontakt

5. Vërtetimi prej shkolle nëse aplikuesi shkon në shkollë

6. Adresa e banimit.

Listat të dërgohen sa më shpejt që të jetë e mundur. Kohë pas kohe mund të dërgoni lista të përditësuara në Rijasetin e BFI-së



No. 03-03/34
Date: 02.02.2023

Drejtuar: Muftinive të BFI-së

Lënda: Letërkore për jetimat

Të nderuar,

Rijaseti i BFI-së ju njofton se starton implementimi i projektit nën moton "Në shërbim të jetimëve". Projekti ka të bëjë me përkujdesjen e jetimëve në të gjithë territorin e Maqedonisë dhe do të përfshijë shifrën prej 5000 (pesë mijë) jetimëve.

Projekti përfshin:

- Asistencë mujore në mjete financiare
- Pagesën e harxhimeve shkollore duke përfshirë paketa për fillim të vitit
- Organizimin e kurseve, seminareve dhe trajnimeve të ndryshme për jetimët
- Organizimin e ekskursioneve të ndryshme
- Dhurimin e teshave verore dhe dimërore
- Paketa ushqimore të Ramazanit dhe Bajramit
- Paketa për ngrohje si dru, etj.
- Mbështetje të fëmijëve që tregojnë aftësi të ndryshme
- Paketa shëndetësore

Për më tej kërkohet nga ju që të angazhoni të gjithë nëpunësit fetar që të sjellin numrin e jetimëve nga xhamatet respektive me qëllim të kompletimit të listave.

Kushtet që duhet të plotësojë çdo aplikant janë:

- Jetim i mbetur pa baba
- Të jetë i moshës deri 13 vjet
- Nga një familje mund të regjistrohen numër i pacaktuar jetimësh
- Dokumentet që duhet të sjellin:
 - Certifikata e lindjes
 - Certifikata e vdekjes së babës
 - Dy fotografi
 - Numër kontakti
 - Vërtetim prej shkolle nëse aplikanti shkon në shkollë
 - Adresa

Listat të dërgohen sa më shpejt që të jetë e mundur, (kohë pas kohe mund të dërgoni lista të azhuruara) në Rijasetin e BFI-së në këtë email: jetimatbfi@gmail.com, me qëllim të kompletimit të njëjave. Lista e bashku me dokumentet për secilin jetim të evidentohen sipas tabelës në bashkëngjitje të këtij dokumenti.

në këtë email: jetimatbfi@gmail.com, me qëllim të kompletimit të të njëjtave.

Listat, së bashku me dokumentet për secilin jetim, të evidentohen sipas tabelës në bashkëngjitje të këtij dokumenti.

Në fund, shprehim falënderime të sinqerta për Ambasadorin e RMV, z. Abdulkadër Mehmeti në Ebu Dabi të EBA për kontributin e madh në menaxhimin e marrëveshjes mes BFI të RMV dhe organizatës "Hilal el-Ahmer" të EBA.

Paraqitja të bëhet nëpër Myftininë të BFI të RMV.

Komisioni për Menaxhimin e Projektit "Në shërbim të jetimëve"

PIKËLLIM I MADH NGA TËRMETI NË TURQI DHE SIRI

Të hënën në mëngjes, më 6 shkurt, 2023, një tërmet i fortë goditi Turqinë dhe Sirinë. Lëkundja e tokës ka qenë me fuqi prej 7.8 ballë të shkallës rihter. Tërmeti ka shkaktuar vdekjen e mbi 40 mijë njerëzve, si dhe shumë dëme materiale, ka raportuar media botërore.

Pas fatkeqësisë së rëndë telegram ngushëllimi ka dërguar Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Në telegram thuhet: "Me pikëllim të madh morëm lajmin e hidhur me rastin e goditjes nga tërmeti të disa vendeve të Turqisë, që solli dëme të mëdha në sferën materiale, por dhe në atë njerëzore. Në emër të BFI të RMV dhe në emër të të gjithë besimtarëve të vendit, Republikës së Turqisë dhe Dijanetit të Turqisë u shprehim ngushëllime të thella dhe përkrahje në këto momente të rënda, me lutje drejtuar Allahut Fuqiptotë që ta ndihmojë popullin e prekur, familjeve të viktimave t'u japë durim të paluhatshëm, ndërsa të gjithë atyre që humbën jetën i Madhi Zot t'u falë xhenetin e amshueshëm. Solidarizohemi me gjithçka me popullin e prekur në këto momente të rënda për të. Zoti i ndihmoftë."

BFI, menjëherë pas tërmetit doli me një komunikatë të titulluar "përkrah Turqisë në këto momente të rënda", në gjuhën shqipe, turke dhe maqedonase.

Të njëjtën ditë, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu u është drejtuar me një Qarkore të 13 Myftinive, Fakultetit të Shkencave Islame dhe SHMI "Medreseja Isa Beu" në Shkup, në të cilën thuhet:

"Me rastin e tërmetit katastrofal në Republikën e Turqisë, si pasojë e të cilit humbi jetën një numër i madh i qytetarëve dhe shumë të tjerë mbetën të lënduar, me dëme materiale me përmasa të mëdha, kërkohet nga organet dhe institucionet edukativo-arsimore të lartpërmendura që të organizojnë lexim të Kuranit dhe të bëjnë lutje të ndryshme në shenjë solidarizimi me popullin e prekur nga tërmeti.

Njëherësh, ju informojmë se lutja e përbashkët do të organizohet në Xhaminë Mustafa Pasha në Shkup më 7 shkurt, 2023, në namazin e drekës. Po ashtu, ditën e premte, në namazin e xhumasë, të bëhen dua (lexim të Fatihasë) për shpirtat e merhumëve.

I bëjmë lutje Allahut (xh. sh.) që t'i mëshirojë të vdekurit dhe t'i shërojë të lënduarit, ndërkaq familjeve t'u jap durim. Vesselamu alejkum."

Me ngushëllime dhe lutje pas tërmetit shkatërrues në Turqi dhe në Siri janë paraqitur më vete edhe Myftinitë e BFI të RMV, Fakulteti i Shkencave Islame dhe Medreseja Isa Beu.

TRISHTIM DHE DHIMBJE NË TËRË BOTËN

Nga Shaqir ef. Fetahu

Tërmeti i rëndë tragjikisht goditi popullin turk dhe sirian. Me mijëra të vdekur, të lënduar, familje të goditura thellë në shpirt dhe në zemër nga humbja e më të dashurve, në veçanti fëmijëve, bijve dhe bijave të tyre, nënave, baballarëve.

E papërshkrueshme kjo në atë të dukshmen dhe të kësaj bote. Por, në atë shpirtëroren, transcendentalen, ata janë te mëshira e Allahut, tek Ai, në kaderin e të cilit ndodh gjithçka, pra edhe kjo.

E gjithë kjo është jashtë fuqisë së njeriut, e paevitueshme, e pandryshueshme, e patejkalueshme. Ndaj gjithë kësaj jemi të paafatë, të pafuqishëm, të dobët. Jashtë planifikimit tonë.

Këtu ka vetëm një fuqi. Ajo shpirtërore. Besimi në caktimin e Allahut. Kaq ka qenë jeta e tyre. Kështu ka qenë kalimi i tyre në botën tjetër.

E jona është të kuptojmë se sa e paparashikueshme është jeta jonë, se sa e vogël është mundësia dhe fuqia jonë, se sa e shkurtër është jeta jonë, se sa e befasueshme është jeta jonë, se sa e nevojshme është të kuptojmë se në çdo moment mund të përfundojë e jona e kësaj bote; se sa e shtrenjtë është çdo minutë e kohës, se sa e domosdoshme është të jetojmë prej momentit të parë në veprat e mira, në syninet e pastra, në qëllimet fisnike, në shërbim të njëri-tjetrit, të njeriut dhe të Zotit, se sa i afërt është kalimi në botën tjetër, se sa e nevojshme është të forcojmë lidhjen me Zotin, me moralin, me të mirën, me të devotshmen, konstruktiven, sepse ja sa e paplanifikueshme dhe e papritur është kjo jetë.

Vërtet s'kemi kohë të hamendemi në të mirën, në paqësoren, në humanen, në afërsinë, komunikimin, ndihmën, buzëqeshjen, ndaj gjithçkasë.

Andaj, të shpejtojmë në vepra të mira, në veçanti ndaj atyre që ju duhemi dhe që kanë nevojë, e më të nevojshëm janë familjet e viktimave dhe të të lënduarve. Lutjet tona qofshin për ta; munda dhe përpjekjet tona qofshin të pranuar.

Zoti i Madh! Jepu forcën e besimit dhe të durimit. Jepu ndihmën dhe bekimin Tuaj. Përfshijë në mëshirën Tëndë ata që dhanë jetën. Shëroji të lënduarit, të shqetësuarit, të goditurit. Bëji të paluhatshëm në këto momente të rënda.

I Madhi Zot! Neve që po vazhdojmë jetën, na jep forcën e kuptimit të qëllimit të jetës sonë, na e jep dashurinë ndaj madhërisë Tëndë. Na jep forcën e veprimit në fushën e pakufishme të devotshmërisë, të fisnikërisë, të mirësisë, bujarisë dhe shërbimit të pakufishëm ndaj njeriut.

Zoti i Madh. Ti je Ai që fal dhe na fal neve.

(Autori është Kryetar/Reis'ul-Ulema i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ky tekst fillimisht është publikuar në faqen personale, pastaj edhe në faqen e BFI, në Facebook.)



VIZITË AMBASADORIT TURK NË SHKUP

Më 17 shkurt, 2023, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu qëndroi në Ambasadën e Republikës së Turqisë (Turkiye Cumhuriyeti) në Shkup, thuhet në njoftimin e BFI.

Aty u prit nga Ambasadori z. Hasan Mehmet Sekizkok (Sekizkøk), të cilit, në emrin e vet dhe të Bashkësisë Fetare Islame të RMV i përcolli ngushëllime me plot dhimbje për goditjen e trishtueshme të tërmetit në pjesën jugore të Turqisë. Me këtë, u shpreh solidarizim dhe përkrahje në këto momente të vështira, posaçërisht për të gjithë ata që humbën jetën, për të lënduarit dhe familjet e tyre.

Reis'ul-Ulemaja, në të njëjtën kohë, informoi Ambasadorin Turk edhe për an-

gazhimin e madh të BFI të RMV dhe të gjithë faktorëve të saj në aksionet që ka organizuar për të ndihmuar popullatën turke në këto momente të vështira.

Ambasadori Sekizkøk shprehu falënderimet e tij për ngushëllimet dhe në të njëjtën kohë falënderoi Reis'ul-Ulemanë për angazhimin e BFI të RMV për t'i ofruar ndihmë popullit turk në këtë fatkeqësi.

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu edhe një herë i drejtoi lutje Allahut fuqiptotë që atyre që humbën jetën t'u falë Xhenetin e amshueshëm, të lënduarve t'u japë shërim të shpejtë, ndërsa familjeve durim të paluahatshëm, thuhet në njoftimin e BFI.



DUA PËR VIKTIMAT E TËRMETIT

Më 7 shkurt, 2023, në Xhaminë e Mustafa Pashës në Shkup u bë dua për viktimat e tërmetit në Turqi dhe në Siri, thuhet në njoftimin e BFI.

Në duanë e hatmeve të Kuranit famëlartë për shpirtin e merhumëve - viktimave që humbën jetën nga tërmeti i trishtueshëm, të lexuar nga nxënësit e Medresesë Isa Beu, nga studentet dhe studentët e FSHI, mori pjesë dhe Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Reis'ul-Ulemaja mbajti një fjalim të shkurtër, ku shprehu ngushëllimet dhe dhimbjen për viktimat dhe dëmet e mëdha të këtij tërmeti, duke ngushëlluar popullin turk dhe sirian, në veçanti familjet e viktimave, me lutje drejtuar Allahut fuqiptotë për durim në këto momente të vështira.

Njëherësh, ai falënderoi Fakultetin e Shkencave Islame dhe SHMI "Medreseja Isa Beu", me Paralelet e Shtrira të saj, për leximin e hatmeve të Kuranit famëlartë.

Bashkë me Reis'ul-Ulemanë ishin: Myftiu i Myftinisë së Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili, i cili po ashtu iu drejtua xhematit dhe shprehu ngushëllime; Sekretari i Përgjithshëm i BFI z. Irsal Jakupi; Drejtori i Sektorit të Mërgatës dr. Selver Xhemaili, Shefi i Kabinetit dr. Abdulke-



rim Iseni, Drejtori i Sektorit për Shkencë dhe Kulturë z. Musanif ef. Rufati, Përgjegjësi për Marrëdhënie me Turqinë z. Nizam Reshit.

Nga Ambasada e Turqisë ishte z. Mustafa Mesten, Atashe për Çështje Fetare.

Reis'ul-Ulemaja falënderoi Imamin e Xhamisë, h. Abdusamed ef. Zeqiri dhe Këshillin e Xhamisë për organizimin e këtij tubimi fetar.

Në fund u lexua pjesë nga Kurani famëlartë nga hafëzi i mirënjohur turk Fatih Derdiyok, ndërsa duanë e bëri Myshaviri (mëshavir, shqip: këshilltar) z. Mustafa Mesten, thuhet në njoftimin e BFI.

Myftiu i Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili, në faqen e vet në Fa-

cebook kishte shkruar: "Sot, më 7 shkurt, BFI në koordinim me Atasheun për Çështje Fetare pranë Ambasadës së Turqisë z. Mustafa Mesten, për të ndarë dhimbjen me vëllezërit tanë, në Xhaminë Mustafa Pasha, bashkëngjitur me namazin e drekës, organizoi lexim të Kuranit, dua dhe lutje të përbashkët për të vdekurit dhe të lënduarit nga tërmeti që përfshiu Turqinë dhe Sirinë. Allahu fuqiptotë i mëshiroftë të vdekurit, i shëroftë të lënduarit, ndërsa familjeve ua shtoftë durimin."

Të gjitha njoftimet BFI i ka shkruar në gjuhën shqipe, në gjuhën turke dhe në gjuhën maqedonase, praktikë kjo tashmë e zakonshme e Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

IUMS: FETVA

SHEHID, PËR SHKAK TË VUAJTJEVE

Komisioni për Ixhtihad dhe Fetva pranë Unionit Botëror të Dijetarëve Myslimanë (International Union of Muslim Scholars, IUMS, Doha, Qatar, themeluar në vitin 2004, <https://iumsonline.org/en/default.aspx>) pas tërmetit në Turqi dhe në Siri ka dalë me një informatë në të cilën thuhet:

-A e marrin statusin e dëshmorit (të shehidit) viktimat si pasojë e tërmetit dhe, ajo që ka ndodhur, a është ndëshkim dhe hakmarrje e Zotit, për shkak të mëkateve të njerëzve?

Hadithe autentike të përcjella prej të dërguarit të Allahut flasin se kushdo që vdes nën rrënoja të ndërtesave, për shkak të tërmetit apo për shkaqe të tjera, është **dëshmor (shehid)**.

Në një hadith qëndron: "Shtatë persona janë dëshmorë (shehidë), përpos atij që vritet në luftë në udhë të Allahut: kush vdes nga ndonjë epidemi, është dëshmor; kush vdes nga pleuritit,ⁱ është dëshmor; kush vdes nga përmbytja në ujë, është dëshmor; kush vdes nga sëmundje të barkut (interne),ⁱⁱ është dëshmor; kush vdes nga djegia (që digjet), është dëshmor; kush vdes nën rrënoja, është dëshmor;ⁱⁱⁱ edhe gruaja që vdes duke qenë shtatzënë, është dëshmore." Hadithin e kanë transmetuar Maliku, Ebu Davudi dhe Nesaiju.

Personi që vdes nën rrënoja konsiderohet dëshmor (shehid) për shkak të vuajtjeve të mëdha që përjeton. Gjykatësi



Ijad ka thënë: "Këto vdekje janë konsideruar shehidllëk, si mirësi që Allahu ua ka dhënë personave që e kanë përjetuar një vdekje të tillë për shkak të dhimbjeve dhe të vuajtjeve të mëdha që kanë përjetuar. Për atë që kanë përjetuar, Allahu i shpërblen me shpërblim të dëshmorëve, apo ka mundësi që këta që kanë përjetuar një vdekje të këtillë të jenë quajtur shehidë (dëshmorë) për shkak se kanë qenë dëshmitarë të dhimbjeve të mëdha dhe të forta me rastin e vdekjes. Për këtë, atyre u është dhënë ajo që u është dhënë edhe dëshmorëve."

Ndërkaq, interpretimi i ndodhjes së tërmeteve dhe fatkeqësive të tjera që ndodhin në natyrë si hakmarrje dhe ndëshkim i Allahut për ata të cilët që goditur, është qasje jo e drejtë dhe jo e saktë, pasi bie ndesh me vërtetet islame të ngushëllimit dhe të ndihmimit të të prekurve nga

fatkeqësitë. Bile, ky interpretim bie ndesh me tekstet fetare autentike, siç është rasti me hadithin të cilin e përmendëm më parë, pasi - si është e mundur që personi që vdes nën rrënoja të jetë shehid dhe të shpërblehet me pozitë më të larta në xhenet dhe në të njëjtën kohë ndaj tij të jetë bërë hakmarrje prej Allahut?

Nuk ka pengesë që, kur ndodhin fatkeqësi dhe situata të rënda, njerëzit të këshillohen që të pendohen prej mëkateve, t'i kthehen Allahut dhe pjesën e ngelur të jetës ta shfrytëzojnë në adhurim dhe përkushtim ndaj Allahut. (13.02.2023)

Prej arabishtes: Bashkim Aliu/enkas për "Hënën e Re"

ⁱ Sipas njërës shpjegimi që i është bërë nocionit të përdorur për këtë sëmundje në gjuhën arabe (B. A.).

ⁱⁱ Dijetarët kanë shpjeguar se me nocionin "batnun" (bark) mendohet për sëmundjet që i godasin organet e trupit të njeriut, si: mushkëritë, lukthin, zorrët, pankreasin etj. Ibn Uthejmin ka përmendur se këtu bën pjesë edhe ai që vdes si shkak i plasjes së zorrës qorre. Po ashtu, disa dijetarë, në këtë lloj, e kanë përfshirë edhe sëmundjen e leukemisë dhe të kancerit, edhe pse disa të tjerë nuk e kanë mbështetur këtë mendim - nëse kanceri nuk është në bark apo në lukth, duke u nisur nga kuptimi tekstual i fjalës "bark", të përmendur në hadith. Imam Neveviju ka dhënë një shpjegim të përgjithshëm të këtij nocioni dhe sipas tij e kemi këtë formulim: "Çdo sëmundje që e godet brenësinë e trupit të njeriut" (B. A.).

ⁱⁱⁱ Disa dijetarë, fjala vjen, si ish-myftiu i Arabisë Saudite, Abdul Aziz ibn Baz, këtu i fusin edhe viktimat e aksidenteve të komunikacionit (B. A.).

MBLEDHJE E JASHTËZAKONSHME E RIJASETIT

Rijaseti i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 7 shkurt, 2023, mbajti mbledhje të jashtëzakonshme, thuhet në njoftimin e BFI.

Mbledhja u kryesua nga Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu dhe në të kryesisht u bisedua për dy çështje kryesore dhe shumë aktuale: 1. Akreditimi i SHMI "Medreseja Isa Beu" në Shkup; 2. Pasojat e tërmetit të trishtueshëm që goditi jugun e Turqisë dhe veriun e Sirisë.

Në çështjen e parë u diskutua gjerë e gjatë mbi Elaboratin dhe Programin mësimor për akreditimin e SHMI "Medreseja Isa Beu" në Shkup, me Paralelet e Shtrira, pas së cilës ato unanimisht u miratuan.

Çështja e dytë, respektivisht goditja e rëndë që kanë pësuar populli turk dhe sirian nga tërmeti, u bisedua si një tragjedi e madhe që shkaktoi me mijëra viktimat



dhe të lënduar, si dhe dëmet të mëdha materiale. Rijaseti i BFI të RMV me keqardhjen më të madhe, në emër të të gjithë besimtarëve, i shprehu ngushëllimet më të dhimbshme Republikës së Turqisë dhe Dijanetit të Turqisë, popullit sirian, duke iu lutur Allahut fuqiptotë që familjeve të viktimave t'u japë durim dhe qëndrueshmëri, viktimave - Allahu Fuqiptotë t'u falë xhenetin e amshueshëm, të lënduarve

-shërim të shpejtë dhe stabilizim të situatës së vështirë.

Rijaseti i BFI të RMV unanimisht doli me vendim që këtë të xhuma (10.02.2023) të organizojë aksion në të gjitha Myftinitë për grumbullimin e të mirave materiale, me qëllim solidarizimi dhe ndihme për familjet e dëmtuara nga tërmeti në Turqi dhe në Siri, thuhet në njoftimin e BFI.

SOLIDARIZIM ME TURQINË DHE SIRINË

MYFTINIA E SHKUPIT: Mbi bazë të Vendimit të Rijasetit të Bashkësisë Fetare Islame të RMV numër 03-75, të datës 8.02.2023, "Aksion solidarizimi me familjet e viktimave dhe të lënduarve nga tërmeti në Turqi dhe në Siri", mirënjohje dhe falënderime të përzemërta për të gjithë besimtarët e Myftinisë së Shkupit, nëpunësit fetarë dhe këshillat e xhamive në krye me Myftiun e Myftinisë Shkup, dr. Qenan ef. Ismaili, për solidarizimin me vëllezërit turq dhe sirianë, të cilët u goditën nga tërmeti i madh që ndodhi më 6.02.2023, thuhet në njoftimin e BFI (16.02.2023).

Allahu ju shpërbleftë për bujarinë dhe ju mbroftë nga të gjitha të këqijat!

Shuma totale e tubuar **në Myftininë e Shkupit: 157.620,00 €.**

Mjetet e tubuara nga ky aksion në nivel republikan do të dorëzohen në **Diyanet Vakfi** të Republikës së Turqisë.

Në vazhdim dhe rezultatet e Myftinive të tjera në nivel të Bashkësisë Fetare Islame të RMV (13 gjithsej).

MYFTINIA E GOSTIVARIT: Mirënjohje dhe falënderime të përzemërta për të gjithë besimtarët e Myftinisë së Gostivarit, nëpunësit fetarë dhe këshillat e xhamive në krye me Myftiun e Myftinisë Gostivar, h. Sabahudin ef. Zendeli, për solidarizimin me vëllezërit turq dhe sirianë, të cilët u goditën nga tërmeti i madh.

Allahu ju shpërbleftë për bujarinë dhe ju mbroftë nga të gjitha të këqijat!

Shuma totale e tubuar **në Myftininë e Gostivarit: 55.936,00 €.**

MYFTINIA E PRILEPIT: Mirënjohje dhe falënderime të përzemërta për të gjithë besimtarët e Myftinisë së Prilepit, nëpunësit fetarë dhe këshillat e xhamive në krye me Myftiun e Myftinisë Prilep, h. Shefket ef. Imeri, për solidarizimin me vëllezërit turq dhe sirianë, të cilët u goditën nga tërmeti i madh që ndodhi më 6 shkurt.

Allahu ju shpërbleftë për bujarinë dhe ju mbroftë nga të gjitha të këqijat!

Shuma totale e tubuar **në Myftininë e Prilepit: 9.730,00 €.**

MYFTINIA E KËRÇOVËS: Mi-

rënjohje dhe falënderime të përzemërta për të gjithë besimtarët e Myftinisë së Kërçovës, nëpunësit fetarë dhe këshillat e xhamive në krye me Myftiun e Myftinisë Kërçovë, h. Qamil ef. Rushiti, për solidarizim me vëllezërit turq dhe sirianë, të cilët u goditën nga tërmeti i madh shkaktuar.

Allahu ju shpërbleftë për bujarinë dhe ju mbroftë nga të gjitha të këqijat!

Shuma totale e tubuar **në Myftininë e Kërçovës: 20.918.00 €.**

MYFTINIA E KUMANOVËS: Mirënjohje dhe falënderime të përzemërta për të gjithë besimtarët e Myftinisë së Kumanovës, nëpunësit fetarë dhe këshillat e xhamive në krye me Myftiun e Myftinisë Kumanovë, h. Abedin ef. Imeri, për solidarizim me vëllezërit turq dhe sirianë, të cilët u goditën nga tërmeti i madh.

Allahu ju shpërbleftë për bujarinë dhe ju mbroftë nga të gjitha të këqijat!

Shuma totale e tubuar **në Myftininë e Kumanovës: 38.529.00 €.**

MYFTINIA E OHRIT: Mirënjohje dhe falënderime të përzemërta për të gjithë besimtarët e Myftinisë së Ohrit, nëpunësit fetarë dhe këshillat e xhamive në krye me Myftiun e Myftinisë Ohër, h. Samet ef. Ajdari, për solidarizim me vëllezërit turq dhe sirianë, të cilët u goditën nga tërmeti.

Allahu ju shpërbleftë për bujarinë dhe ju mbroftë nga të gjitha të këqijat!

Shuma totale e tubuar **në Myftininë e Ohrit: 4.584,00 €.**

MYFTINIA E MANASTIRIT: Mirënjohje dhe falënderime të përzemërta për të gjithë besimtarët e Myftinisë së Manastirit, nëpunësit fetarë dhe këshillat e xhamive në krye me Myftiun e Myftinisë Manastir, h. Amit ef. Rasimi, për solidarizim me vëllezërit turq dhe sirianë, të cilët u goditën nga tërmeti i madh i datës 6 shkurt.

Allahu ju shpërbleftë për bujarinë dhe ju mbroftë nga të gjitha të këqijat!

Shuma totale e tubuar **në Myftininë e Manastirit: 10.155.00 €.**

MYFTINIA E STRUGËS: Mirë-



johje dhe falënderime të përzemërta për të gjithë besimtarët e Myftinisë së Strugës, nëpunësit fetarë dhe këshillat e xhamive në krye me Myftiun e Myftinisë Strugë, h. Salim ef. Sulejmani, për solidarizim me vëllezërit turq dhe sirianë, të cilët u goditën nga tërmeti i madh.

Allahu ju shpërbleftë për bujarinë dhe ju mbroftë nga të gjitha të këqijat!

Shuma totale e tubuar **në Myftininë e Strugës: 26.472.00 €.**

MYFTINIA E DIBRËS: Mirënjohje dhe falënderime të përzemërta për të gjithë besimtarët e Myftinisë së Dibrës, nëpunësit fetarë dhe këshillat e xhamive në krye me Myftiun e Myftinisë Dibër, h. Reshat ef. Kaçallniku, për solidarizimin me vëllezërit turq dhe sirianë, të cilët u goditën nga tërmeti i madh.

Allahu ju shpërbleftë për bujarinë dhe ju mbroftë nga të gjitha të këqijat!

Shuma totale e tubuar **në Myftininë e Dibrës: 20.985.00 €.**

MYFTINIA E VELESIT: Mirënjohje dhe falënderime të përzemërta për të gjithë besimtarët e Myftinisë së Velesit, nëpunësit fetarë dhe këshillat e xhamive në krye me Myftiun e Myftinisë Veles, h. Nejaz ef. Murati, për solidarizimin me vëllezërit turq dhe sirianë, të cilët u goditën nga tërmeti i madh (6.02.2023).

Allahu ju shpërbleftë për bujarinë dhe ju mbroftë nga të gjitha të këqijat!

Shuma totale e tubuar **në Myftininë e Velesit: 17.639.00 €.**

MYFTINIA E SHTIPIT: Mirënjohje dhe falënderime të përzemërta për të gjithë besimtarët e Myftinisë së Shtipit, nëpunësit fetarë dhe këshillat e xhamive në krye me Myftiun e Myftinisë Shtip, h. Nasir ef. Rexhepi, për solidarizimin me vëllezërit turq dhe sirianë, të cilët u goditën nga tërmeti i madh.

Allahu ju shpërbleftë për bujarinë dhe ju mbroftë nga të gjitha të këqijat!

Shuma totale e tubuar **në Myftininë e Shtipit: 11.140.00 €.**

MYFTINIA E RESNJËS: Mirënjohje dhe falënderime të përzemërta për të gjithë besimtarët e Myftinisë së Resnjës, nëpunësit fetarë dhe këshillat e xhamive në krye me Myftiun e Myftinisë Resnjë, h. Xhunejt ef. Jashar, për solidarizimin me vëllezërit turq dhe sirianë, të cilët u goditën nga tërmeti i madh.

Allahu ju shpërbleftë për bujarinë dhe ju mbroftë nga të gjitha të këqijat!

Shuma totale e tubuar **në Myftininë e Resnjës: 5.500.00 €.**

MYFTINIA E TETOVËS: Mbi bazë të Vendimit të Rijasetit të Bashkësisë Fetare Islame të RMV numër 03-75, të datës 8.02.2023, "Aksion solidarizimi me familjet e viktimave dhe të lënduarve nga tërmeti në Turqi dhe në Siri", mirënjohje dhe falënderime të përzemërta për të gjithë besimtarët e

Myftinisë së Tetovës, nëpunësit fetarë dhe këshillat e xhamive në krye me Myftiun e Myftinisë Tetovë, h. Qani ef. Nesimi, për solidarizimin me vëllezërit turq dhe sirianë, të cilët u goditën nga tërmeti i madh që ndodhi më datë 6.02.2023.

Allahu ju shpërbleftë për bujarinë dhe ju mbroftë nga të gjitha të këqijat!

Shuma totale e tubuar **në Myftininë e Tetovës: 111.224.00 €.**

Mjetet e tubuara nga ky aksion në nivel republikan do të dorëzohen në **Diyanet Vakfi** të Republikës së Turqisë.

Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë së Veriut në vazhdimësi i publikon njoftimet e 13 Myftinive rreth zhvillimit të aksionit humanitar në ndihmë të Turqisë dhe të Sirisë pas tërmetit të rëndë që goditi këto dy vende më 6 shkurt, thuhet në njoftimin e BFI (17.02.2023).



Mjetet e mbledhura nga aksioni humanitar nëpër Xhamitë e BFI-së e RMV për familjet e viktimave dhe të lënduarve nga tërmeti në Turqi dhe Siri

NR	Emri:	Shuma:
1	Muftinia Shkup	168.500 €
2	Muftinia Tetovë	112.324 €
3	Muftinia Gostivar	58.350€
4	Muftinia Kumanovë	40.174 €
5	Muftinia Strugë	27.522 €
6	Muftinia Dibër	20.985 €
7	Muftinia Kercovë	20.918 €
8	Muftinia Veles	17.639 €
9	Muftinia Manastir	11.192 €
10	Muftinia Shtip	11.840 €
11	Muftinia Prilep	9.745 €
12	Muftinia Resnje	6.000 €
13	Muftinia Ohër	4.569 €
14	Paralelet e medreseve Shk,Te	2.009 €
15	Pagesa në llogari të Rijasetit	356 €
16	Totali:	512.123€

BFI e RMV konstatoi shumën e aksionit humanitar për pasojat e tërmetit në Turqi dhe Siri: 512.123 euro. U jemi mirënjohës të gjitha Myftinive, myftinjve, drejtorëve të sektorëve, mutevelive, imamëve dhe gjithë besimtarëve. Mjetet materiale dorëzohen në llogarinë bankare të Dijanetit të Republikës së Turqisë (Diyanet İşleri Başkanlığı, Türkiye). Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu me një delegacion në emër të BFI dhe të besimtarëve së shpejti do të vizitojë Kryetarin e Dijanetit, prof. dr. Ali Erbaş (Erbash) për të ndarë dhimbjen së bashku. Zoti ju bekoftë, thuhet në njoftimin e BFI. (21.02.2023)

FALËNDERIM PËR NDIHMËN

Të nderuar besimtarë! Bashkësia Fetare Islame e RMV, me në krye Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, falënderon të gjithë besimtarët e vendit për ndihmën dhe mbështetjen e madhe financiare që dhanë sot, më 10 shkurt, 2023, në aksionin e ndërmarrë nga BFI e RMV në të gjitha xhamitë e vendit për të ndihmuar të prekurit nga tërmeti në Turqi dhe në Siri. Ditët në vijim në faqet e institucioneve tona do të bëhet publikimi i shumës së grumbulluar nga Këshillat e Xhamive. Zoti ju shpërbleftë për bujarinë dhe zemërgjerësinë, thuhet në njoftimin e BFI.

Republika e Turqisë është një vend i madh dhe do ta kapërcejë shpejt këtë fatkeqësi, e cila do të gjunjëzonte shumë vende, ka shkruar dr. Samir Vildiq (Samir Vildić), Sarajevë.

Nuk duhet të harrojmë se ky tërmet kishte fuqinë e mbi 300 bombave atomike. Ai preku një rajon sa dy Bosnje e Hercegovina (apo sa 10 Kosova), ku jetojnë mbi 13 milionë njerëz. Më shumë se 12.000 ndërtesa u shkatërruan dhe deri më tani kemi mbi 20.000 dëshmorë.

Presidenti Tajip Erdoğan (Recep Tayyip Erdoğan) tha se shteti do të ndërtojë shtëpi për të gjithë brenda një viti dhe atë vit të gjithëve do t'u paguhet qiraja. Turqia është një vend i madh, me një lider të madh dhe një rrëz të mrekullueshëm. Falënderimi i qoftë Zotit, ka shkruar Samir Vildiq, të cilin shkrim në shqip e sjell Mirsad Asllani më 10 shkurt, 2023, në faqen e vet në Facebook.

SËRISH DRIDHJE TË TOKËS

Më 20 shkurt, 2023, në orët e mbrëmjes, sërish janë shënuar dy dridhje të tokës. Thuhet se në Hatayi fuqia ka qenë 6.7 shkallë. Të dhëna të tjera raportojnë për magnitudë 6.4 dhe 5.8 rihter.

Dridhjet janë shënuar në vendet bregdetare si Antalya, Alanya e deri në Bejrut të Libanit.

Për banorët që për dy javë presin të afërmit e tyre të nxirren nga gërmadhat, këto dridhje kanë qenë një shqetësim i ri. (desk/HeR)

SERVETI, HERO I VËRTETË...

Kur Allahu të do, Ai të bën sebeb që nga duart tua të ushqehet, të vishet dhe të strehohet dikush, shkruan Irfan Agushi (Radushë/Zvicër).

Kjo veturë e ngarkuar fort, është shembulli më i mirë i solidarizimit me njerëzit e prekur nga tërmeti në Turqi dhe në Siri.

Mund ta paramendoj që ky burrë u zgjua herët në mëngjes, si zakonisht. Mund të kishte falur dhe sabahun, të hajë mëngjesin dhe para se të dalë nga shtëpia merr lajmin makabër të tërmetit. Ndjek ndodhitë, të cilat sa vijnë e bëhen më të vështira.

I prekur deri në palcë, merr veturën dhe fillon të ngarkojë çfarë e shihet të arsyeshme dhe çfarë gjen në shtëpi.

Ky burrë mund të ketë një veturë shumë të lirë, madje mund edhe t'i ketë bërë problem kur ka dashur ta ndez, por nga ajo që shihet, më lejohet të them se ky burrë e ka zemrën e madhe.

Nuk besoj që të ketë kursime në bankë si shumica prej nesh, pasi vetura e ngarkuar e tregon atë. Madje, besoj se shumë nga këto gjëra të ngarkuara mbi veturë dhe brenda saj do t'u mungojnë fëmijëve të tij. Por, ai e ka kuptuar drejt mesazhin e humanizmit dhe të sadakasë: është tamam nga ata të cilët peygamberi Muhamed (s.a.v.s.) i porositi duke iu thënë se "ushqimi për një, është i mjaftueshëm për dy veta" - të ndash me vël-lain dhe motrën tënde atë që ke.

Myslimanët janë vëllezër. Nëse një pjesë e trupit lëndohet, e ndjen i gjithë trupi. Ashtu na mëson Islami, ashtu na ka porositur Peygamberi, andaj është turp për çdo mysliman që ta kalojë këtë tragjedi duke mos bërë asgjë.

Ky burrë me këtë veturë të stërmbushur me gjëra të shumta, më kujtoi Xhabir ibn Abdilahun (r. a.), një sahabi të cilin njerëzit e dinin të varfër, por tek Allahu njihej si shumë i pasur.

"Në Luftën e Hendekut myslimanët u detyruan me javë të tëra të qëndrojnë pas Hendekut për të ndaluar ushtrinë armike. Si rezultat i kësaj, filloi të ndihet uria, mungesa e ushqimit. Në një moment,



duke e ditur këtë, Xhabiri (r. a.) shkoi dhe i thotë Muhamedit (s.a.v.s.): 'Eja tek unë të hamë drekë.' 'A vetëm unë, o Xhabir', ia ktheu Resulullahu.

'Merr edhe një ose dy me vete', i thotë Xhabiri (r. a.).

Transmenton Xhabiri (r. a.): 'Mendova për Ebu Bekrin dhe Omerin (r.anhum).'

Më pas u ngrit Resulullahu dhe tha: 'Xhabiri na ka thirrur në gosti.'

Tregon Xhabiri (r. a.): 'Kur Muhamedi (s.a.v.s.) thirri gjithë ushtrinë, unë u shtanga. Gjithçka që kisha, ishin një pulë dhe pak elb. Ika dhe i tregova gruas, mirëpo ajo më qetësoi duke më thënë: 'Qetësohu! A e di Muhamedi (s.a.v.s.) se sa ushqim kemi?' 'Po', ia ktheva. 'Atëherë, ai e di se çfarë bën', tha ajo.

Erdhi Resulullahu bashkë me dhjetëra e qindra njerëz. Mua më tha: 'Lësho brenda nga 10 veta.' Unë e lëshova grupin e parë dhe mendova që u krye - kaq ushqim kishte. Por, jo. Vazhdova t'i fus njerëzit brenda, derisa nuk mbeti asnjë pa ngrënë. Kur kaloi grupi i fundit, hyra brenda dhe pashë që vetëm një pjesë nga ushqimi mungonte."

Ishte kjo një mrekulli e Allahut të madhërishtëm, por ajo që mua më bën ta mendoj këtë ngjarje shumë shpesh, është fakti që Allahu i madhërishtëm zgjodhi pikërisht Xhabirin dhe shtëpinë e tij, e kjo nuk mund të kishte ndodhur rastësisht.

Mrekullia e kësaj fatkeqësie janë nje-

rëzit e varfër si Xhabiri.

Ky burrë, me këtë veturë (nga Baku, Azerbajxhan-shën.), dhe gjithë të tjerët që e ndjejnë për obligim të ndihmojnë një pjesë të "trupit" të lënduar, janë mrekullia e Zotit.

E, Allahu kur të do, të bën sebeb që nga duart tua të ushqehet, të vishet e të strehohet dikush që gjendet në fatkeqësi.

O Zot, na e lehtëso këtë gjendje, shkruan Irfan Agushi më 8 shkurt, 2023.

Mediat e Azerbajxhanit arritën të heroi në foto - një nga lajmet më të bukura të ditës së djeshme, shkruan Ardit Hoxhllaku (Tiranë).

Personi u fotografua duke dërguar ndihma nga Azerbajxhani në Turqi me një makinë shumë të vjetër dhe të mbingarkuar.

Gazetarët nga Azerbajxhani e gjetën këtë hero.

Ai quhet Server Besirli. Shtëpia në të cilën jeton është një shtëpi e vjetër dhe e vogël. Në fakt, është një banjë e kthyer në shtëpi.

Kur e pyeti gazetari se ku i gjete ata dyshekë dhe jorganë, ai tha: 'Nuk i gjeta. Ato ishin të vetmet që kishim në shtëpi. Ata, vëllezërit tanë, sot kanë më shumë nevojë se unë, prandaj boshatisa shtëpinë dhe i dërgova. Shpresoj t'u hyjnë në punë, sepse janë shumë të përdorura.'

Serveti nuk ka pasuri materiale, mirëpo ai ka një zemër të madhe, shkruan Ardit Hoxhllaku në Facebook më 9 shkurt, 2023.

SEID IMERI, PJESËMARRËS NË GARAT KURANORE NË KAJRO

Këto ditë, në Garat ndërkombëtare të Kuranit Qerim dhe të Hifzit, të 29-tat me radhë, që po mbahen në Kajro të Egjiptit, merr pjesë hafëzi i mirënjohur Seid ef. Imeri, i cili përfaqëson Bashkësinë Fetare Islame të RMV, thuhet në njoftimin e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Pas fazës kualifikuese, të cilën e kaloi me sukses, bëri kandidimin për leximin e Kuranit famëlartë në fazën e fundit, në finale, me një paraqitje dinjitoze.

Vetë kandidati deklaroi me sa vijon: "Ajo që dua të përmend, janë vlerësimet e larta që kishin komisioni dhe organizatorët për nivelin e lartë të mahrexhit të shkronjave (theksimin) dhe të texhvidit (rregullat kuranore) dhe për këtë i jam falënderues Allahut që isha nën përkujdesjen e mësuesit tim të jetës, shumë të shtrenjtë dhe më të mirit, prof. hfz. Bajram Ajeti. Po ashtu, falënderues jam edhe ndaj institucionit më të lartë fetar në vend, BFI të RMV, në krye me Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir Fetahu, që ma besuan mua të jem përfaqësues i Maqedonisë së Veriut në këto gara kuranore. Shpresoj dhe kam bindjen të jem në mesin e fituesve të top-10 vendeve të para, me lejen e Allahut (xh. sh.)."

Në fund, BFI e RMV përshëndet pje-

الترتيب	الاسم	الدولة	الدرجة	الجانحة
الأول	عبد الصمد آدم	غانا	99.90	٢٠٠ ألف حنيفة + شهادة لتقدير + المنتخب + موسوعة الثقافة الإسلامية
الثاني	فاطمة شايما زاهر	العالمية	99.45	١٥٠ ألف حنيفة + شهادة لتقدير + المنتخب + موسوعة الثقافة الإسلامية
الثالث	تتوير حسين	بنجلاديش	99.15	١٠٠ ألف حنيفة + شهادة لتقدير + المنتخب + موسوعة الثقافة الإسلامية
الرابع	هشيم صقر أحمد	كينيا	98.85	شهادة لتقدير + المنتخب + موسوعة الثقافة الإسلامية
الخامس	عمر حنطاي حسن	نيجيريا	97.60	شهادة لتقدير + المنتخب + موسوعة الثقافة الإسلامية
السادس	بشير امام عثمان	نيجيريا	97.10	شهادة لتقدير + المنتخب + موسوعة الثقافة الإسلامية
السابع	نفسية بوسو	السنغال	96.05	شهادة لتقدير + المنتخب + موسوعة الثقافة الإسلامية
الثامن	سعيد ايمري	مقدونيا	95.85	شهادة لتقدير + المنتخب + موسوعة الثقافة الإسلامية
التاسع	كايابا أبو بكر	غينيا	95.25	شهادة لتقدير + المنتخب + موسوعة الثقافة الإسلامية
العاشر	دايو سيدي	الكونغو برازافيل	95.05	شهادة لتقدير + المنتخب + موسوعة الثقافة الإسلامية
الحادي عشر	رضوان أبو الفتل	بلجيكا	94.70	شهادة لتقدير + المنتخب + موسوعة الثقافة الإسلامية

sëmarrjen e suksesshme të hfz. Seid ef. Imeri në Garat botërore në Kajro, që paraqet një vlerë të veçantë të BFI të RMV, thuhet në njoftimin e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. (5.02.2023)

PËRFAQËSIM ME DINJITET I BFI-SË

Uroj hafëz Seid ef. Imerin për suksesin e madh, të arritur në Garat botërore të hifdhit të Kuranit famëlartë në Kajro, ka njoftuar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. Hafëz Seidi dëshmoi lart sukseset e tij dhe përfaqësoi me dinjitet BFI të RMV, duke e regjistruar atë, vendin dhe popullin tonë në analet ndërkombëtare islame dhe vërtetoi se myslimanët e Ballkanit me sukses e prezantojnë Islamin në këtë nënqiel. Jemi krenarë me hafidhin tonë të nderuar dhe BFI e RMV do të jetë në përkrahje maksimale në rrugëtimin e tij fetar-shkencor në të ardhmen. Zoti e bekoftë, thuhet në njoftimin e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. (9.02.2023)

PËR UT-në, NGA HAFËZ ELMAZI

Hafëz Elmaz ef. Qamili, hoxha i Porroj, i cili dha kontribut të madh për themelimin e Universitetit të Tetovës (UT), tregon:

-Më 17 shkurt të vitit 1995, në mejtepin e xhamisë së fshatit Porroj u mbajtën ligjëratat e para të studentëve të Universitetit të Tetovës. Ajo ditë ishte ditë e xhuma.

Para se të fillojë ligjëratat e ditës së xhuma, hafëz Elmaz ef. Qamili, si Imam në xhaminë e fshatit Porroj, iu drejtua popullatës së tubuar me fjalët:

-Sot namazin e xhumasë do ta falim jashtë xhamisë, në mbrojtje të shkollimit, të Universitetit dhe të studentëve.

Pas këtij mesazhi drejtuar xhematit të tubuar në xhami, të gjithë dolën jashtë, në përkrahje të popullatës së tubuar për të mbrojtur studentët, të cilët porsa kishin filluar ligjëratën e parë në UT.

Ky është ai burrë, ai Imam që e ka bërë këtë gjest historik.

("Gazeta Tetova", Personalitete nga Tetova, F.1.12.2023/në bashkëpunim)

NË VENDIN E TETË

Më 8 shkurt, 2023, u mbajt ceremonia përmbyllëse e Garave Botërore të Kuranit Famëlartë dhe përfaqësuesi i BFI të RMV, hfz. Seid Imeri, u rangua i teti në listën e përgjithshme, me 95.85 pikë, thuhet në njoftimin e BFI.

Ishte një garë shumë e fortë, me hafëzllarë të nivelit shumë të lartë nga e gjithë bota, në të cilën me një diferencë shumë të vogël të pikëve, hfz. Seid Imeri mori atë që e meritoi.

Qëllimi i tij final është që ta perfeksionojë edhe më shumë Hifzin e Kuranit. Allahu Fuqiptotë ia mundësoftë dhe e bëftë të këndojë rrjedhshëm para Tij. Pas garës, hfz. Seidi falënderoi të gjithë për mbështetjen, sidomos familjen, miqtë, mësuesin e tij profesorët, si dhe institucionin fetar BFI, thuhet në njoftimin e BFI.



Hafëz Elmaz ef. Qamili, Porroj, Tetovë. (FotoArkiv)

NË 15-VJETORIN E PAVARËSISË SË KOSOVËS

Me ftesë të Ambasadorit të Republikës së Kosovës në Shkup, z. Florian Qehaja, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu më 16 shkurt, 2023, mori pjesë në manifestimin e 15-vjetorit të Pavarësisë, thuhet në njoftimin e BFI.

Kryetari i BFI-së ishte bashkë me mr. Salim ef. Sulejmanin, Myfti i Myftinisë së Strugës; z. Mustafë ef. Dautin, Drejtor për Marrëdhënie me Jashtë; z. Miqail ef. Osmanin, ish-Koordinator i Myftinisë së Strugës; z. Shefit Hajredinin, Referent në Myftininë e Strugës.

Të pranishmit me këtë rast i përshëndeti Ambasadori i Republikës së Kosovës në Shkup, z. Florian Qehaja, i cili në fjalimin e tij të rastit mes tjerash tha:

“Marrëdhëniet e shkëlqyera dypalëshe me Kosovën, kanë për qëllim realizimin e interesave të përbashkëta të Ballkanit Perëndimor - një rajon stabil, i sigurt dhe ekonomikisht i begatë. Si dy vende mike, kemi bashkëpunim të shkëlqyer në të gjitha nivelet, me mundësi për



thellimin e marrëdhënieve tona të ndërsjella, në drejtim të realizimit të prioritetve të Qeverisë, por edhe të Ministrisë së Brendshme, për shkëmbim aktiv të informacionit, për bashkëpunim të forcuar ndërmjet shërbimeve kufitare dhe, në përgjithësi, ndërmjet Policive të të dy vendeve.”

Me këtë rast, Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë së Veriut të gjithë qytetarëve të Kosovës, Presidentes Vjosa Osmani dhe Kryeministrit Albin Kurti u dërgon urime të përzierme me rastin e Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, 17 Shkurtit (2008), thuhet në njoftimin e BFI.

MYFTIU I KOSOVËS NË SHKUP



Më 15 shkurt, 2023, Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, qëndroi në Shkup, në Rijaset, ku u prit nga Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, thuhet në njoftimin e BFI.

Reis'ul-Ulemaja falënderoi Kryetarin

e BIK-ut për këtë vizitë vëllazërore, që dëshmon bashkëpunimin e ngushtë të të dy Bashkësisë Islame në projekte të përbashkëta, me qëllim të ngritjes së vetëdijes së prezantimit të Islamit, zgjidhjes së çështjeve të ndryshme, pastaj të përpjekjes për formimin e kushteve dhe për zhvillim të suksesshëm të vlerave fetare.

Nga ana e tij, Myftiu Tërnavë falënderoi Reis'ul-Ulemanë për pritjen vëllazërore dhe theksoi se takimet e këtilla dëshmojnë bashkëpunimin e thukët të të dy Bashkësisë, vazhdimin e projekteve të përbashkëta, vazhdimin e veprimit për të zbutur migrimin e popullatës, që paraqet një plagë të rëndë të kombit dhe shumë çështje të tjera.

Njëherësh, u shpreh dhimbje dhe shqetësim i madh për situatën në Turqi dhe në Siri me rastin e tërmetit shkatërrues.

Të dy krerët e Bashkësisë Islame edhe një herë vendosën që ky bashkëpunim të vazhdojë në nivele të ndryshme për të mirën e besimtarëve dhe të vendeve tona në përgjithësi, thuhet në njoftimin e BFI.

Më pas, në platformat elektronike të BFI-së është dhënë dhe raporti i TV Globit (Gostivar) nga kjo ngjarje.

DJEGIA E KURANIT - AKT ANTINJERËZOR

Më 21 janar, 2023, në Stokholm (Suedi), para Ambasadës Turke, Rasmus Paludan, kryetar i partisë Stran Kurs, ka djegur një tekst të shtypur të Kuranit famëlartë, ka raportuar media botërore.

Kurani famëlartë është libër hyjnor dhe i shenjtë dhe, si i tillë, është bazë e ngritjes shpirtërore dhe jetësore për të gjithë myslimanët e botës, thuhet në reagimin e Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të Kryetarit të saj, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Andaj, me indinjatë të thellë e pranuar lajmin e djegies dhe të nëpërkëmbjes së Kuranit famëlartë nga ekstremistë politikë të Suedisë, me çka thellë kanë prekur në ndjenjat e pjesëtarëve të Islamit dhe të botës së qytetëruar.

Ky gjest i egër dhe i shëmtuar më tepër prek në harmoninë ndërfaqetare, në dialogun mes besimeve, si dhe ndikon negativisht në marrëdhëniet ndërnjerëzore dhe në prishjen e paqes dhe të tolerancës mes popujve.

Bashkësia Fetare Islame e RMV thellë e dënon këtë ngjarje të shëmtuar dhe të errët, duke theksuar që gjestet e këtilla janë antinjerëzore dhe aspak nuk u kontribuojnë vlerave dhe zhvillimeve pozitive në Evropë dhe në botë. BFI dhe myslimanët gjithmonë i kanë dënuar dhe gjykuar aktet e këtilla nga kushdo që vijnë ato, thuhet në reagimin e Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të Kryetarit të saj, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Kreu i Diyanetit të Republikës së Turqisë, Ali Erbaş, e dënon dhënieën e lejes për djegien e Kuranit në Suedi para Ambasadës së Turqisë në Stokholm, transmeton Anadolu Agency (AA).

Në një deklaratë nga llogaria e tij në median sociale, z. Erbaş (Erbash) deklaroi: "Dënoj dhe mallkoj fuqimisht dhënieën e lejes nga autoritetet suedeze ndaj një veprimi i cili synon djegien para Ambasadës së Turqisë në Stokholm të librit tonë famëlartë,



Kuranit, që është dërguar për të ndriçuar njerëzit nga injoranca.

Autoritetet suedeze me qëndrimin e tyre që kanë paraqitur janë bërë bashkautorë në krimin e urrejtjes së kryer kundër Islamit, kundër myslimanëve dhe Turqisë dhe, gjithashtu, kjo e ka vënë në objektiv paqen shoqërore. Do të vazhdojmë deri në fund luftën tonë kundër këtyre mentaliteteve të pista", tha Erbaş, përfundon Anadolu Agency (AA).

Njohës të mirë të Islamit kanë theksuar se në Stokholm u dogj mus'hafi, jo Kurani. Domethënë, mus'hafi është një libër në të cilin Kurani është shkruar nga dora e njeriut dhe Kurani, si i tillë, nuk mund të vihet në zjarr dhe as ndonjë krijesë nuk mund ta dëmtojë atë, sepse Kurani është fjalë e Zotit, e cila, ashtu si Allahu i Lartësuar, nuk është krijuar, por thjesht ËSHTË.

Agjencia turke Anadolu në shqip ka raportuar se më 22 janar në Turqi (Turkiye), në 90 mijë xhami të vendit, është lexuar Kuran dhe është bërë lutje në reagim ndaj ngjarjes në Suedi.

Edhe një sulm tjetër ndaj librit tonë të shenjtë, Kuranit: Edwin Wagensveld, udhëheqës i organizatës anti-islamike Pegida, grisi faqet e Kuranit nën mbikëqyrjen e policisë në Hagë, Holandë, thuhet në një raport të publikuar në Facebook nga Latif Berisha më 23 janar 2023.

DJEGIA E KURANIT, "LIRIA E SHPREHJES" QË VJEN NGA RUSIA

Nga Shaban Murati

Kur një ekstremist i djathtë, shtetas suedez, në 21 janar 2023 dogji librin e shenjtë të Kuranit në mes të Stokholmit, levantinët tinzarë nga Stokholmi në Tiranë nxituan ta marrin në mbrojtje, duke deklaruar se kjo është "liri e shprehjes".

Nuk i bënë fare pyetjen vetes përse ekstremisti i djathtë në emër të "lirisë së shprehjes" po digjte vetëm Kuranin dhe nuk digjte as Biblën dhe as Torahun.

Shpjegimin e kësaj "lirie të shprehjes" e dha shpejt në 28 janar ministri i jashtëm i Finlandës, Pekka Haavisto, i cili deklaroi se hetimet për ngjarjen çuan në lidhjet e atij ekstremisti me Rusinë. Në një intervistë në televizionin finlandez ministri i jashtëm i Finlandës deklaroi: "Ngjarja ngren pikëpyetjen nëse një palë e tretë, për shembull Rusia, e cila kundërshton anëtarësimin në NATO, po provokon që t'ia arrijë kësaj. Kjo është e pafalshme."

Rusia ka organizuar aksionet e djegies së Kuranit për të penguar hyrjen e Suedisë në NATO nëpërmjet acarimit të marrëdhënieve midis Suedisë dhe Turqisë me një provokacion fetar antimysliman në Stokholm.

Edhe kryeministri i Suedisë, Ulf Kristersson, deklaroi në 28 janar se ka forca brenda dhe jashtë Suedisë që duan ta mbajnë vendin jashtë NATO-s.

E vërteta, që zbuloi ministri i jashtëm finlandez, i dogji shumë Moskës. Në 29 janar 2023 zëdhënësja e MPJ të Rusisë, Maria Zaharova, me deklaratë të posaçme u përpoq ta përgënjeshtronte ministrin e jashtëm të Finlandës, që "vendosi lidhje të Rusisë me djegien e Kuranit, dhe se Rusia është e përfshirë në aksionin e djegies së Kuranit".

Jo rastësisht ndodhi provokacioni tani, kur nga shtetet anëtare të NATO-s ka mbetur vetëm Turqia që duhet të japë konsensusin e saj për hyrjen e Suedisë në NATO.

Pas këtij provokacioni fetar në Stokholm, u bë e ditur nga Ankaraja se Turqia do ta veçojë Finlandën nga kërkesa e përbashkët me Suedinë për anëtarësim atlantik dhe do të miratojë vetëm hyrjen e Finlandës.

E ashtuquajtura "liri e shprehjes", që vjen nga Rusia në disa kryeqytete perëndimore, është vepër dhe nxitje e shërbimeve sekrete ruse për të bllokuar zgjerimin e NATO-s në veri të Evropës. Në plan afatshkurtër, Rusia me këtë provokacion fetar synon të ndalojë anëtarësimin e Suedisë në NATO. Në plan afatgjatë, synon të shkaktojë trazira sociale në shtetet perëndimore dhe një nxitje të konflikteve dhe të luftërave fetare në shkallë ndërkombëtare.

Edhe apologjia e levantinëve për provokacionet fetare antimyslimane si "liri e shprehjes", që vjen nga Rusia (në Shqipëri-shënim HeR), sponsorizohet nga Rusia.

Burimi/në bashkëpunim (30.01.2023): <https://gazetadita.al/shenim-djegia-e-kuranit-nemes-te-stokholmit-liria-e-shprehjes>

KONFERENCË ONLINE ME DIJANETIN

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu më 25 janar, 2023, mori pjesë në Konferencën online të liderëve botërorë myslimanë, të organizuar nga Dijaneti (Diyane) i Republikës së Turqisë, thuhet në njoftimin e BFI.

Në një njoftim që ka bërë të njëjtën ditë Kryetari i BFI të RMV thuhet: Konferenca u mbajt me rastin e djegies së Kuranit famëlartë nga ekstremi i djathtë suedez-danez Rasmus Paludan.

Kryetari i Dijanetit të Turqisë, dr. Ali Erbash, në fjalën e tij hyrëse theksoi se të gjitha mendjet e ndritura në botë fuqimisht duhet t'u kundërvihen akteve të kërtilla që prekin thellë në ndjenjat e besimtarëve islamë.

Reis'ul-Ulemaja i BFI në fjalën e tij, pasi që përshëndeti organizimin e kësaj konference, mes tjerash theksoi se Kurani famëlartë është libër hyjnor dhe i shenjtë dhe, si i tillë, është bazë e ngritjes shpirtërore dhe jetësore për të gjithë myslimanët e botës, të myslimanëve të Evropës, ku janë pjesë përbërëse, dhe të myslimanëve të vendit tonë.

Andaj, me indinjatë të thellë pranuan lajmin e djegies dhe të nëpërkëmbjes së



Prof. dr. Ali Erbaş (Erbash)

Kurani famëlartë nga ekstremistët politikë, veprim ky që thellë ka prekur në ndjenjat e pjesëtarëve të Islamit dhe të botës së qytetëruar. Ky gjest i egër dhe i shëmtuar më tepër prek në harmoninë ndërfaqetare, në dialogun mes besimeve, si dhe ndikon negativisht në marrëdhëniet ndërnjerëzore, si dhe në prishjen e paqes dhe të tolerancës mes popujve.

Bashkësia Fetare Islame e RMV thellë e dënon këtë ngjarje të shëmtuar

dhe të errët dhe u bën apel të gjithëve që gjestet e kërtilla janë antinjerëzore dhe aspak nuk u kontribuojnë vlerave dhe zhvillimeve pozitive në Evropë e në botë dhe se BFI dhe myslimanët gjithmonë i kanë dënuar dhe gjykuar aktet e kërtilla nga kushdo që vijnë.

Në këtë kohë të problemeve në sfera të ndryshme, botës i duhet paqja dhe respekti mes popujve, që janë vlera më të shtrenjta për mbarë njerëzimin.

Nga ky samit u vlerësua se këto veprime janë të ulëta dhe fyejnë vlerat tona të shenjta dhe përmbajnë krim të urrejtjes, janë një shpallje e hapur se islamofobia, diskriminimi dhe ksenofobia nuk njohin kufij. Duhet theksuar se politikani danez-suedez i ekstremit të djathtë, Rasmus Paludan, dogji një kopje të Kuranit gjatë një proteste më 21 janar para Ambasadës Turke në Stokholm dhe ky akt nxiti valën e reagimit në botën islame.

Njëherësh, u gjykua edhe grisja e kopjes së Kuranit të madhërishtëm në Holandë dhe kjo nën përkujdesjen e forcave të rendit, thuhet në njoftimin e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, publikuar në faqen e vet në Facebook.

AMBASADORJA AGGELER VIZITOI BFI-në

Më 15 shkurt, 2023, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu priti Ambasadorën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shkup, Shkëlqesinë e Saj, zonjën Angela Aggeler, thuhet në njoftimin e BFI.

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame i shprehu falënderime të sinqerta Ambasadores për vizitën dhe i dëshiroi mirëseardhje në BFI të RMV. Ai këtë vizitë e vlerësoi lart, duke e konsideruar si një forcim të bashkëpunimit dhe dhënies përkrahje në synimet e saj në ngritjen e vetëdijes mbi besimin, paqen, tolerancën, si dhe ndikimin e BFI në zbutjen e anomalive të ndryshme që e pengojnë rrugën drejt vlerave euroatlantike.

Gjatë takimit u bisedua edhe për shumë çështje dhe sfida të kohës si: agresioni rus në Ukrainë, radikalizmi i çfarëdo lloji qoftë, forcimi i bashkëjetesës dhe tolerancës në përgjithësi. Po ashtu, u cek edhe akreditimi i Medresesë si një çështje shumë me rëndësi për të ardhmen e shkollimit të kuadrove të reja.

Reis'ul-Ulemaja edhe një herë dëshmoi se BFI e RMV është e paluhatshme në rrugën drejt vlerave euroatlantike dhe anëtarësisë në BE.



Ambasadorja e SHBA, zonja Aggeler, falënderoi Reis'ul-Ulemanë për pritjen e lartë që iu bë dhe më pas shprehu bindjen e saj të thellë për ndikimin konstruktiv që ka BFI në shoqëri. BFI-në e konsiderojmë partner të ngushtë, me të cilin ndajmë prioritetet e përbashkëta në zhvillimet e vlerave të kohës, në veçanti në shoqërinë ku vepron, si dhe në luftën kundër anomalive të kohës, si korrupsioni dhe shumë të tjera, u tha me këtë rast.

Në fund, në shenjë respekti, Ambasadores Aggeler iu dorëzua Mirënjohje nga BFI për kontributin e saj në vendin tonë

dhe më gjerë, thuhet në njoftimin e BFI.

Një njoftim ka bërë dhe Ambasada e SHBA-ve në Shkup. Në të thuhet: "Ambasadorja Aggeler është takuar sot me Kryetarin e Bashkësisë Fetare Islame, Reis Shaqir Fetahu. Ata diskutuan respektin dhe bashkëpunimin ndërfetar, rolin vendimtar të udhëheqësve fetarë në luftimin e ekstremizmit dhe të korrupsionit dhe partneritetin tonë të vazhdueshëm mbi vlerat dhe prioritetet e përbashkëta."

Më pas, në platformat elektronike të BFI-së është dhënë dhe raporti i TV Globit (Gostivar) nga kjo ngjarje.

BFI NË PËRKUJTIMIN E HOLOKAUSTIT

Me ftesë të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, Bashkësia Fetare Islame e RMV mori pjesë në shënimin e Ditës ndërkombëtare të përkujtimit të Holokaustit, që u mbajt në hapësirat e ITSHKSH më 27 janar, 2023, thuhet në njoftimin e BFI.

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu e përfaqësoi Drejtori për Shkencë dhe Kulturë Musanif ef. Rufati, i shoqëruar nga Drejtori i Vakëfit Driton Dikena.

Kjo tragjedi emrin e kishte Holokaust, kurse hebrenjtë ishin ata të cilët kaluan nëpër rrathët e këtij ferri. Në secilin rreth sfidohej fati dhe e ardhmja e hebrenjve, por pati edhe purgator ku njerëzit vullnetmirë, edhe këtu në Shkup, në Prishtinë, në Shkodër e gjetiu, tregonin mëshirë e solidaritet për këtë popull, tha Drejtori i ITSHKSH prof. dr. Skender Asani para të pranishmëve.


Ajo çka na intereson neve sot është pyetja: A mundet solidariteti dhe sakri-



fica për tjetrin të krijojë sërish fole në zemrat e njerëzve humanë? Nëse gjatë LDB patëm heronj të heshtur që ua shpëtuan jetën hebrenjve, sot kemi nevojë për disa heronj të tjerë, të cilët duke tejkalar vetveten, arrijnë të ruajnë harmoninë fqinjësore e shoqërore, nënvizoi Drejtori Skender Asani, thuhet në njoftimin e ITSHKSH.

Në përkujtim në kësaj dite, në Insti-

tutin e Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturë të Shqiptarëve në Shkup u organizua edhe një ekspozitë retrospektive me fotografi autentike të një grupi diplomatësh që vepruan në Zvicër në periudhën 1941-1945, të cilët i ndihmuan hebrenjtë që me dokumente të falsifikuara të strehohen në shtetet e Amerikës Latine, përfundon njoftimi i ITSHKSH.



Imami i Xhamisë Hajdar Kadi, Manastir, mr. Xhavit Ramadan, i ka dhënë një intervistë Televizionit shtetëror të Turqisë TRT Türk, thuhet në njoftimin e BFI. Njoftimi është shoqëruar me një video në kohëzgjatje prej 3:05 minutash. (1.02.2023)

NË KONFERENCËN PËR BALLAFAQIM ME ANTISEMITIZMIN

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 6 shkurt, 2023, mori pjesë në Konferencën e parë në kuadër të kryesimit të OSBE-së nga Maqedonia e Veriut me temë "Konferencë për ballafaqim me antisemitizmin", thuhet në njoftimin e BFI.

Konferenca dyditore në Shkup synon të nënvizojë se të qenët i bashkuar në diversitet është e vetmja rrugë e sigurt për stabilitet afatgjatë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Konferenca udhëhiqej nga Ministri i Jashtëm, z. Bujar Osmani, dhe në të merrnin pjesë personalitete të larta të OSBE-së dhe përfaqësues të diplomacive të shteteve evropiane e më gjerë.

Njëherësh, Reis'ul-Ulemaja shprehu falënderimet e tij për ftesën që të marrë



pjesë në këtë konferencë shumë të rëndësishme për të zbutur tendencat negative antisemite, si moment për të kuptuar se paqja dhe toleranca janë vlerat më të shenjta të të gjitha kohëve.

Pjesëmarrja në këtë konferencë edhe një herë tregoi se BFI është subjekt pjesmarrës në shumë konferenca të vendit dhe jashtë vendit, thuhet në njoftimin e BFI.

VIZITË E MYFTIUT TË MËPARSHËM TË ANKARASË



Më 4 shkurt, 2023, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu priti në kabinetin e tij mysafirin e lartë nga Turqia prof. dr. Mefail Hëzllë (Mefail Hızlı), Myfti i mëparshëm i Ankarasë dhe aktualisht mësimdhënës në Fakultetin Teologjik të

Bursës, Turqi, thuhet në njoftimin e BFI. Mysafiri shoqërohej nga z. Betim Truçi, ish-sekretar i KMSH.

U bisedua gjerë e gjatë për rrjedhat shkencore dhe për punën e madhe akademike që bën mysafiri në Turqi dhe më

gjerë. Po ashtu, u ndërruan mendime për shumë sfera të angazhimeve të secilës palë në jetën fetare islame, si dhe për sfidat e kohës.

Nga BFI pati falënderime të shumta për, siç u tha, pritjen vëllazërore që u janë bërë delegacioneve tona në Bursa, në veçanti nxënësve tanë gjatë ekskursioneve të ndryshme.

Në pritje, Kryetari i BFI të RMV shoqërohej nga dr. Qenan ef. Ismaili, Myfti i Myftinisë së Shkupit; h. Sabahudin ef. Zendeli, Myfti i Myftinisë së Gostivarit; dhe mr. Eljesa ef. Hasani, Drejtor i Institutit të Hifzit në Gostivar.

Në fund, nga BFI u falënderuan për vizitën, me urimet më të mira për sukses dhe shëndet në jetë.

Prof. dr. Mefail Hëzllë është me rrënjë nga Prilepi, thuhet në njoftimin e BFI.

LIGJËRATA NË MYFTININË E OHRIT

Më 29 janar, 2023, pas namazit të jacisë, në Xhaminë Kul Oglu u realizua ligjërrata e parë javore, e organizuar nga Myftinia e BFI-Ohër në nderim të Tre Muajve të Bekuar. Ligjërues ishte imami i Xhamisë Hajdar Pasha, Astrit ef.

Lumani, i cili foli me temë "Vlehtësia dhe rëndësia e xhamive dhe namazi me xhemat".

Ligjërata të ngjashme do të ketë në të gjitha xhamitë, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Ohrit.

PRITJE PËR AMBASADORIN GEER

Më 3 shkurt, 2023, Ambasadori i Bashkimit Evropian në Shkup, z. David Geer, qëndroi në Rijaset, ku u prit nga Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, thuhet në njoftimin e BFI.

Kryetari i BFI të RMV falënderoi Ambasadorin për vizitën dhe, njëherësh, e njoftoi me rrjedhat dhe aktivitetet e BFI, si dhe për stabilitetin e saj në kohë dhe në vend. Më pastaj bashkëbiseduan për shumë çështje, si: agresioni rus në Ukrainë, pasojat e kësaj lufte, zhvillimet në dialogun ndërfaqësor, përpjekjet kundër ekstremizmit, kontributi i BFI-së në kultivimin e paqes, në ngritjen e vetëdijes drejt rrjedhave euroatlantike, konsolidimi i shoqërisë sonë në të gjitha sferat, kontributi i bartësve të Islamit në tejkalimin sfidave dhe zhvillimin e BFI, si dhe sfidave me të cilat ballafaqohet BFI në kohë dhe vend.

Ambasadori i BE, z. David Geer, për-



shëndeti punën e BFI në të gjitha instancat, duke shprehur mirënjohje për kontributin e përgjithshëm në zhvillimet pozitive të shoqërisë dhe më gjerë.

Në fund, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu i dhuroi Shkëlqesisë së Tij publikimin-letërnjoftim për BFI-në dhe një vepër artistike: Xhaminë e Larme në Tetovë.

Reis'ul-Ulemanë gjatë takimit e shoqëruan z. Irsal ef. Jakupi, Sekretar i Për-

gjithshëm i BFI; z. Mustafa Dauti, Drejtor për Marrëdhënie me BE; dhe dr. Abdulkerim Iseni, Shef i Kabinetit të Kryetarit të BFI të RMV, thuhet në njoftimin e BFI.

Në faqen zyrtare në Facebook, nga ky takim, BFI ka nxjerrë dy video: e para, prej 38 sekondave dhe e dyta, raporti gazetaresk, në kohëzgjatje prej 4:01 minutave, transmetuar nga TV "Globi", Gostivar.

NË AMBASADËN E SHQIPËRISË NË SHKUP



Më 8 shkurt, 2023, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu vizitoi Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Shkup, thuhet në njoftimin e BFI.

Aty u prit në mënyrën më të mirë nga Ambasadori z.

Fatos Reka.

Shkëlqesia e Tij, Ambasadori Reka, falënderoi Reis'ul-Ulemanë për vizitën, duke i dëshiruar mirëseardhje në Ambasadën e Shqipërisë në Shkup.


Në këtë takim u bisedua gjerë e gjatë për rrjedhat e kohës, për fenomenin fe, për harmoninë fetare te shqiptarët si vlerë unike, për anomali të kohës dhe për zhvillimet më të reja në rajon. Me këtë rast u shpreh shqetësim dhe keqardhje për viktimat dhe për pasojat e tërmetit në Turqi dhe në Siri.

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame falënderoi për pritjen, si dhe për prezencën e përfaqësuesve të Ambasadës së Shqipërisë në Shkup në takimet dhe në solemnitetet që i organizon BFI e RMV.



Më 31 janar, 2023, Myftiu i Myftinisë së Tetovës, prof. dr. Qani ef. Nesimi, priti në Xhaminë e Larme Ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar, z. Matthew Lawson. Në takim ishin hoqxhallarë të Xhamisë dhe të Myftinisë. Njoftimin në Facebook e ka publikuar Myftiu i BFI-Tetovë, prof. dr. Qani ef. Nesimi.

SKENDER ASANI VIZITOI BFI-në



Më 23 janar, 2023, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu priti Drejtorin e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, dr. Skender Asani, thuhet në njoftimin e BFI.

Reis'ul-Ulemaja falënderoi Drejtorin e ITSHKSH, dr. Skender Asani, e shoqëronin dr. Zeqirija Ibrahimimi dhe prof. Sabahatin Nuhiju, thuhet në njoftimin e BFI.

shme të ngritjes kulturore dhe shpirtërore në trojet shqiptare.

Në takim u ra dakord për një bashkëpunim të ngushtë mes dy institucioneve në sfera të ndryshme.

Drejtorin e ITSHKSH, dr. Skender Asani, e shoqëronin dr. Zeqirija Ibrahimimi dhe prof. Sabahatin Nuhiju, thuhet në njoftimin e BFI.

Në komunikatën që ka nxjerrë

ITSHKSH pas takimit thuhet: “Në këtë takim miqësor u bisedua për mundësitë e shumta të bashkëpunimit mes Institutit dhe BFI-së, duke vënë theksin në aspektet e trashëgimisë shpirtërore islame në botën tonë shqiptare, por edhe në aspektet e projekteve të përbashkëta shkencore.

Duke qenë një institut i hapur dhe i orientuar kah promovimi i vlerave të përgjithshme shpirtërore, përtej dallimeve sipërfaqësore, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve mund të jetë një shtyllë e rëndësishme e mirë që edhe trashëgimia islame në vendin tonë të promovohet si vlerë e përbashkët identitare në vendin tonë.

Drejtori Asani dhe Reis'ul-Ulemaja ranë dakord që në të ardhmen të ketë bashkëpunim konkret dhe ky të synohet të jetë tradicional, gjithnjë duke qenë të bindur se kultura shpirtërore e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut ka shumë për të folur edhe për relacionet ndërreligjioze dhe ndëretnike në botën e re të integritimit evropian.”

NË PROMOVIMIN E LIBRIT "TRASHËGIMIA KULTURORE ISLAME NË SHKUP"



Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu më 26 janar, 2023, mori pjesë në promovimin e librit të ri me titull "Trashëgimia kulturore islame në Shkup" të autorëve prof. dr. Skender Asani dhe dr. Nora Maliqi-Zylali. Promovimi u bë në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, ndërsa botimin e librit e mundësoi Myftinia e Shkupit, thuhet në njoftimin e BFI.

Vlerësues dhe referues të veprës ishin dr. Qenan ef. Ismaili, Myftiu i Shkupit dhe prof. dr. Zeqirija Ibrahimimi.

Tubimin e hapi prof. dr. Skender Asani, Drejtor i ITSHKSH, i cili në fjalën e tij përshëndeti të pranishmit dhe foli mbi vlerën shkencore të veprës në fjalë dhe në veçanti mbi shkatërrimin dhe masakrimin e trishtueshëm që u është bërë monumenteve të kulturës islame vetëm me një qëllim: asimilimin apo dëbimin e shqiptarëve nga trojet e tyre shumëshekullore.

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në fjalën e tij përshëndeti botimin e kësaj vepre me vlerë të jashtëzakonshme dhe foli mbi qëllimet shoviniste pansllaviste në të kaluarën për të shkatërruar dhe asimiluar shqiptarët duke zhdukur kulturën dhe traditat e tyre.

Po ashtu, panelistët dr. Qenan Ismaili dhe prof. dr. Zeqirija Ibrahimimi dhanë një

vlerësim të lartë për veprën në fjalë.

Pjesëmarrës nga të gjitha sferat shkencore: ish-Myftiu i Strugës h. Miqail ef. Osmani; z. Izmit Nura, ish-ushtar dhe komandant i UÇK nga Struga; h. Abdusamed ef. Zeqiri, imam i mirënjohur i Xhamisë Mustafa Pasha, Shkup; hafëzi i mirënjohur Xhemali Nuhiu dhe shumë të tjerë, thuhet në njoftimin e BFI.

Libri “Trashëgimia kulturore islame në Shkup (dokumente, fotografi dhe dëshmi)”, i autorëve Skender Asani dhe Nora M. Zylali, është prurja e radhës e veprimtarisë botuese të ITSHKSH, ka shkruar Skender Asani në faqen e vet në Facebook pas promovimit.

Në këtë vepër ndriçohet një pjesë e kujtesës sonë historike përmes dokumentimit të trashëgimisë materiale e kulturore me proveniencë islame. Ky libër është faktografi autentike e një realiteti historik, ku politikën pushtuese-kolonizuese kishin në fokus çrrënjësues e kësaj kujtese, duke instaluar një areal të ri urbanistik në qytetin e Shkupit.

Autorët kanë arritur që përmes dokumenteve arkivore të dëshmojnë vitalitetin e popullatës vendore në ruajtjen e elementeve të autoktonisë, që kësaj radhe identifikohen përmes monumenteve fetare islame.

Libri është i ndarë në dy kapituj. Në kapitullin e parë janë vendosur dokumentet që dëshmojnë historikun e objekteve arkitektonike islame në qytetin e Shkupit, kurse në kapitullin e dytë janë përfshirë fotografitë e xhamive gjatë dy luftërave botërore.

Një dimension i veçantë përmbajtësor i librit ka të bëjë edhe me çështjen e pronës, ose vakëfet, të cilat kanë qenë të administruara nga Bashkësia Fetare Islame, me një traditë të gjatë, qysh nga shek. XV. Roli bazë i këtyre pronave ka qenë ngushtë i lidhur me nevojat arsimore, fetare e kulturore të popullatës vendore dhe si të tilla ato kanë qenë edhe një motor lëvizës i mirëqenies sociale e ekonomike të komunitetit mysliman në territorin e Shkupit dhe më gjerë.

Libri “Trashëgimia kulturore islame në Shkup (dokumente, fotografi dhe dëshmi)” është edhe një referencë e vlefshme bibliografike për të gjithë studiuesit që do të merreshin me trajtimin e periudhave të ndryshme historike të popullatës sonë, kurse për lexuesin e thjeshtë është edhe një freskim i kujtesës mbi të kaluarën, që është e lidhur ngushtë me mbijetesën shekullore të popullatës vendore, ka shkruar prof. dr. Skender Asani pas promovimit.

FRYMA DHE SHPIRTI I SHKUPIT

Gjithçka është krijuar nga fryma. Ai që jep frymën është vetë Krijuesi, ndërsa ata që frymojnë janë krijesat, të cilat marrin frymë jo vetëm me trup, por dhe me shpirt.

Në arabisht fjala *rûh*, shpirt, është gati e njëjtë me fjalën *rih*, erë, dhe fjala *nefs*, ego, e përafërt me fjalën nefes, frymëmarrje.

E, në Shkup, trupi dhe shpirti frymojnë së bashku:

Hapa mbi kalldrëm,

Që trokasin në gurë...

E çdo gur në zemër,

Pa fjalë e pa emër...

Rrugëtim i gjallë,

Një hap, shumë mall...

N'çarshi koha ndal,

Zemra bëhet mal...

Me nostalgji për Shkupin.

(Nga Enris Qinami, Tiranë-Francë/në bashkëpunim)



KEQARDHJE PËR VËRSHIMET

Më 19 janar, 2023, ka pasur vërshime të mëdha në disa qytete të Kosovës e më gjerë, është raportuar nga media të ndryshme.

Në lidhje me këtë, shqetësim ka shprehur Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së

Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Në letrën që ka publikuar BFI thuhet: “Me keqardhje dhe shqetësim ndiejmë vërshimet e bujshme dhe të rrezikshme që po e kaplojnë Skenderajn, Mitrovicën dhe gjetiu në Kosovë. Soli-

darizohemi me bashkombasit tanë, me lutjet drejtuar të Madhit Zot, që sa më shpejtë ta tejkalojnë këtë vështirësi pa pasoja të mëdha dhe pa viktime.”

Sipas organeve zyrtare të Komunitetit të Skenderajt, dëmi ka shkuar në mbi 10 milionë euro.

NJË LIBËR QË FRESKON KUJTESËN DHE MBRON IDENTITETIN

Nga Zeqirija Ibrahim

Secila vepër shkencore e ka peshën e saj dhe vendin saj, por janë disa vepra që janë të domosdoshme, pa të cilat një komb nuk bëhet dot. Ato janë veprat që e regjistrojnë të kaluarën dhe e mobilizojnë kujtesën e brezave me rëndësinë e njohjes së saj. E tillë është edhe vepra “Trashëgimia kulturore islame në Shkup ndërmjet dy luftërave botërore (dokumente, fotografi dhe dëshmi)” e autorëve Skender Asani dhe Nora Maliqi - Zylali, që vjen si botim i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup.

Historia e monumenteve islame në Shkup fillon pasi që Jigit Beu e shtiu në dorë këtë qytet më 1392. Në të vërtetë, përkundër monumenteve të pakta të kohës paraosmane, që ekzistojnë në Shkup, siç është kalaja e qytetit, kisha “Shën Spas” etj., është e vërtetë e pamohueshme se Shkupi u bë qytet në plotkuptimin e fjalës vetëm pas etablimit të pushtetit osman aty, kur filloi të funksionojë jeta e njëmendtë urbane.

Çarshia e Shkupit, që u bë epiqendra e qytetit, do të jetë bërthama rreth së cilës do të shtrihen lagjet e qytetit, ndërsa kalldrëmet, çezmat publike, hanet, hamamet, e veçmas objektet sakrale, siç janë xhamitë e teqetë, për pesë shekuj me radhë do ta krijojnë një qytet tipik oriental, njësoj si Selaniku i asaj kohe, që deri në ditët tona do ta ruajë me xhelozë këtë identitet, si edhe diversitetin etnik e religjioz.

Por, pas humbjes së osmanëve në Be-tejën e Kumanovës dhe tërheqjes së tyre nga këto troje, në Shkup fillon një epokë e re, që do të jetë shumë agresive për ta rru-dhur identitetin oriental të qytetit; kjo në favor të krijimit të identitetit të ri sllavo-ortodoks. Kështu, në këto 110 vjet pushtet janë ndërruar disa herë, por intenca që të përjashtohet identiteti oriental ose mysliman i qytetit ka mbetur aktiv gjithnjë, madje deri në ditët tona.

Meqë periudha më e vështirë për identitetin e Shkupit ishin pikërisht vitet nga 1912 deri në përfundim të Luftës së Dytë Botërore (vitet e mëvonshme sjellin shtresën socialiste të qytetit), autorët e këtij libri – duke sjellë një mori dokumentesh, fotografish e dëshmi – janë përpjekur të na e paraqesin në mënyrë sa më autentike gjendjen e trashëgimisë islame në Shkup në atë periudhë.

Pas Hyrjes, që përveçse në gjuhën shqipe është përkthyer edhe në gjuhën maqedonase dhe turke, libri shpaloset me një punim të një nxënisi të Medresesë së Madhe të Mbretit Aleksandar në Shkup (Državna velika medresa kralja Aleksandra), një shkollë e mesme që ka funksionuar në vitet 1924-1941. Autori i punimit, Nasuf Gaçoviq, duke punuar në temën “Trashëgimia islame në Shkup” (Muslimanske starine u Skoplju), sjell të dhëna të përgjithshme për monumentet osmane-islame në Shkup, që kishin mbetur akoma në këmbë në atë kohë. Ai flet për xhamitë, teqetë, hanet, hamamet, tyrbet, urat etj., një pjesë e të cilave sot më nuk ekzistojnë (bie fjala, Xhamia Ibni Pajko etj.), ndërsa mes tjerash thotë: “Përveç këtyre xhamive, në Shkup ka edhe rreth 20 mesxhide, të cilat janë në gjendje mjaft të dobët. Këto mesxhide në disa raste janë rrënuar për shkak të vjetërsisë, e në disa raste dhe për shkak të arsyeve të tjera, për të cilat tani nuk është vendi të flitet.”

Ndonëse nxënësit e kësaj shkolle ishin nën presion të indoktrinimit serb (edhe pse shumica e tyre përfunduan si komunistë), autori lë të nënkuptohet se ka edhe “arsye të tjera” se pse janë rrënuar ato xhami/mesxhide. Dhe, ata që e dinë historinë tjetër të asaj periudhe, siç janë edhe autorët e këtij libri, i dinë mirëfilli se cilat ishin “arsyet tjera”.

Sidoqoftë, punimi i nxënësit Gaçoviq është mjaft i pasur me të dhëna. Ai, përveç informacioneve të përgjithshme për praninë osmane në Shkup, ka ofruar edhe data të rëndësishme të ndërtimit të të ob-

jekteve të kulturës osmane-islame, duke i transkriptuar dhe përkthyer ato nga osmanishtja, ndërsa secili që e lexon këtë tekst, përfiton një tablo të përgjithshme se cila ka qenë gjendja e këtyre monumenteve në Shkup në periudhën mes dy luftërave botërore. Se punimi i Gaçoviqit është vlerësuar seriozisht në kohën e tij, flet edhe fakti se Qyteti i Shkupit e ka shpërblyer si tema më e mirë në këtë fushë.

Pjesa tjetër e librit të autorëve Asani dhe Maliqi-Zylali ka fotografi të këtyre objekteve, raporte të shtetit me vakëfin dhe këshillat e xhamive, është prezantuar i plotë “Statuti i Shoqatës Mbrojtja Juridike e Islamit”, që ishte një organizatë e themeluar pikërisht për ta mbrojtur trashëgiminë islame të Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene, janë prezantuar disa vendime për shkarkimet e mytevelinjve, kemi një ankesë drejtuar Bashkisë së Shkupit, që e kishte marrë pronësinë mbi varrezat islame, aty është vendimi për rrënimin e Xhamisë Ibni Pajko më 1937, ndërsa vlen të përmenden disa momente se si ushtarakët serbë i drejtoheshin pushtetit në Beograd përkthazi me ankesat e komunitetit mysliman në Shkup.

Kështu, në një letër të vitit 1920 që një gjeneral i ushtrisë serbe ia dërgon ministrit të Fesë thuhet: “Zotëri ministër, në Shkup ka rreth 40 xhami, [prej të cilave] disa janë përdorur si tempuj, disa si magazina ushtarake dhe disa nuk funksionojnë. Turqit (serbët i quanin “turq” të gjithë myslimanët – Z.I.) kërkojnë që ato xhami që përdoren për magazina t’u jepen atyre. Kjo nuk mund të bëhet, sepse të njëjtat nevojiten për magazina.”

Siç del sheshazi, serbët nuk e kishin fare problem në atë kohë që xhamitë t’i shndërrojnë në magazina dhe ato të përdoren si të tilla. Madje, në një letër tjetër (po ashtu më 1920), që një ushtarak tjetër (komandanti i Qarku të Tretë) ia dërgon ministrit të Luftës dhe Marinës, duke u ankuar për deklaratat e një deputeti mysliman, shprehet prerazi: “Dhe, ku ishin ai z.

deputet Bajram dhe paraardhësit e tij të ngrihen për tempujt dhe priftërinjtë e krishterë, kur serbët ishin nën turqit? Kur nuk lejohej të binte kambana e kishës, kur kisha nuk lejohej të hapej, kur të krishterët duhej të mblidheshin fshehurazi nëpër luginë si bisha të egra për t’iu lutur Zotit. Ne po i tolerojmë shumë turqit dhe ata e konsiderojnë tolerancën tonë dobësi dhe prandaj kanë guxim që në këtë vendim të kërkojnë më shumë se sa kanë pasur nën turqit.” Diskurs tipik hakmarrës, që u reflektua edhe praktikisht. Kjo ishte gjendja reale e qëndrimit të pushtetit serb ndaj kulturës islame në Shkup.

E, që tabloja të jetë më e trishtë, realiteti më i hidhur, i këtij tregimi, që në vepër e autorëve Asani dhe Maliqi-Zylali zë vend të rëndësishëm, është rrënimi i Xhamisë Burmalit, e cila ishte në sheshin e qytetit. Për këtë ngjarje ata kanë sjellë disa dokumente. Në fakt, rrënimi i kësaj xhamie nuk ka qenë në shiritin e njëjtë të rrënimin të objekteve të kulturës islame ose shndërrimit të tyre në magazina. Rrënimi i Xhamisë Burmalit ka pasur simbolikë të veçantë. Në stilin e betejave mesjetare, serbët e përjetonin pushtimin e Shkupit si rikthim të perandorisë mesjetare serbe në Shkup, andaj – në trajtën e betejave tipike mesjetare – objektin më të rëndësishëm të qytetit duhej ta kthenin në identitetin e ri të qytetit. Prandaj, ata do ta rrënojnë Xhaminë Burmalit, për ta ndërtuar në themelet e saj “Pallatin e Oficerëve”, që të jetë simbol i ngadhënjimit të ushtrisë serbe mbi ushtrinë osmane.

Në këtë vepër janë dhënë procesverbalet e vendimeve për rrënimin e Xhamisë dhe për ndërtimin e objektit të ri. Në këtë mënyrë, më 1925 Xhamia Burmalit do të rrënohet dhe, kështu, praktikisht, sheshi i Shkupit do ta humb identitetin oriental, për të mos e kthyer kurrë më; madje as në

ditët tona. (“Pallati i Oficerëve”, i rrënuar nga tërmeti më 1963, është rikthyer në shesh me projektin “Shkupi 2014”).

Nëse e shikojmë Shkupin nga perspektiva e shpendit, duke i pasur në mendje pikat e këtyre monumenteve të kulturës islame në qytet, do të vërejmë se këto objekte janë rrënuar në mënyrë sistematike dhe identiteti islam i Shkupit është rruhur mjaft, sa për të mbetur në një hapësirë të ngushtë, që sot përbën një përqindje shumë të vogël të qytetit.

Goditjen e fundit këtij identiteti ia dha qeveria e viteve 2006-2016, e cila me projektin “Shkupi 2014” praktikisht e ka zhvendosur qendrën urbane të Shkupit, ashtu që identiteti oriental-islam i Shkupit tashmë është shndërruar në periferi.

Krejt kjo historia e betejës identitare në Shkup është pasqyruar në dokumentet e kësaj veprë dhe prandaj kujtoj se veprat e këtuja janë të domosdoshme për secilin shqiptar që jeton në Shkup, por jo vetëm.

Edhe pse trashëgimia islame del përtej kornizave kombëtare, shqiptarët – si shumica myslimane e Shkupit – do të mbeten edhe trashëgimtarët e kësaj kulture në qytetin që deri para tërmetit të vitit 1963 ishin popullata më e madhe këtu.

Autorët duhet të përgëzohen për punën e vyeshme që kanë bërë në vjeljen e materialit arkivor, si dhe për mënyrën e sistemit të lëndës, duke e sjellë në mënyrë të sintetizuar një pasqyrë koncize të gjendjes së xhamive dhe teqeve në Shkupin e mes dy luftërave botërore.

Vepra ka vlerë edhe për një arsye tjetër. Meqë shqiptarët e Shkupit gati e kanë humbur lidhjen e tyre me mesjetën, kjo më shumë për faj të tyre sesa të të tjerëve, ndërsa rilidhja kërkon shumë punë e shumë investime, ka mbetur shtresa islame si dëshmi e autoktonisë dhe pranisë historike shqiptare në këtë qytet. Kjo është

edhe arsyeja që Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup e boton këtë vepër, për t’i dhënë peshë institucionale shkencore kësaj trashëgimie dhe për t’i dalë zot asaj si pronë e jona shpirtërore e kulturore. Ja, edhe një arsye më shumë që e bën këtë vepër kaq të rëndësishme për bibliotekën tonë.

Më 1392 Jigit beu e shtiu në dorë Shkupin, për ta futur në kolonën e qyteveve osmane, ndërsa kur ky qytet do të dalë nga sundimi osman (më 1912), ai do të jetë qytet i njëmendtë urban dhe, veç kësaj, do të jetë qyteti me më shumë shqiptarë në gjeografinë tonë etnike.

Më 1912 në Shkup hynë kryengritësit shqiptarë, të cilët, duke e parë përfundimin e shtetit osman, për herë të parë kërkuar njohjen e kufijve etnikë të Shqipërisë në kuadër të shtetit osman. Sado që kërkesat e tyre mbetën të porealizuara, shqiptarët për herë të parë në histori dolën me konceptin për shtet të pavarur shqiptar, me çka i hodhën në ujë planet e fqinjëve ballkanikë për copëtimin e tokave shqiptare, por edhe e aktualizuan veten me një ide e cila as sot nuk është vjetruar.

Shqiptarët kanë në Shkup tani institutin e tyre hulumtuës shkencor, i cili edhe me këtë vepër ua mban gjallë kujtesën historike të këtij qyteti (dhe më gjerë), ndërsa e projekton identitetin e ri të Shkupit, ku elementi shqiptar ka rol të rëndësishëm, ku kultura islame është e lidhur si mishi me thoin me identitetin etnik dhe ku shqiptarët – si askund tjetër në trojet e tyre, por edhe si askund tjetër në Maqedoninë e Veriut – dëshmojnë se, duke e fuqizuar identitetin e tyre, arrijnë ta artikulojnë dhe afirmojnë edhe bashkëjetesën ndëretnike e ndërftare në Shkupin e pasur të diversiteteve. (26.01.2023)

LLOGARITJE TË GABUARA

Kujdes kur të shohësh një këngëtar popullor, ose një artist, ose një lojtar futbollit dhe të thuash: ata marrin miliona; ndërsa unë, inxhinier, mjek, marr një rrogë të vogël pas mundit dhe arsimimit.

Kjo llogaritje është e gabuar...

Allahu i Lartësuar ka thënë: “Për sa i përket shkumës (së ujit apo të metaleve), ajo hidhet si mbeturinë, ndërsa ajo që ju sjell dobi njerëzve mbetet në tokë.” (Er Rad: 17)

E ka thënë të vërtetën Allahu i Madhërisëm.

Mësimi nuk është se ky merr kaq,

ndërsa ti sa merr: mësimi është se cili është duke e kryer misionin për të cilin është krijuar; cili i bëri dobi vetes dhe fesë së tij; cili e kënaqi Zotin tonë me veprat e veta; cili u solli dobi njerëzve dhe la gjurmë dhe cili u bë shkak për argëtimin dhe humbjen e njerëzve; cili e fiton furnizimin e tij në mënyrë të lejuar (hallall).

Edukoni fëmijët tuaj se dituria, feja dhe morali janë shpëtim.

Kujdes, të mos harroni se e gjithë kjo botë nuk është asgjë në krahasim me botën tjetër (ahiretin).

Kujdes, mos të harroni se ka llogari-



dhënie për çdo gjë që e keni bërë në jetën e kësaj bote.

Çështja nuk është vetëm paraja dhe - u krye gjithçka; tema është pak më ndryshe.

(Nga Shejh dr. Ahmed Et-Tajjib; nga arabishtja në shqip: Muhamed Sadiku/në bashkëpunim)

MEDRESEJA MIRËPRITI MYSAFIRË NGA BOSNJA

Më 21-22 janar, 2023, në Medresenë Isa Beu në Shkup ishin mysafir nxënës nga medresetë e Bosnjës dhe Hercegovinës, thuhet në njoftimin e BFI.

Drejtorja për Arsim dhe Shkencë pranë Rijasetit të Bashkësisë Islame të Bosnjës dhe Hercegovinës ka organizuar projektin "Nën qiellin e pastër të besimit - Islami dhe Evropa në përvojën e Bosnjës", që paraqet një prezantim specifik të aspekteve socio-politike, fetare, kulturore-historike, shkencore-arsimore dhe artistike të jetës dhe të traditës në BeH, të cilat ishin dhe ende janë në ndikimin e Islamit.

Projekti përfshin segmentin ndërfetar të jetës në BeH, elemente të jetës kulturore dhe artistike, si: traditën, artin, arkitekturën, krijimtarinë muzikore e pamore, mjeshtëritë, zakonet etj. Konkurrentët më të suksesshëm dhe mentorët e tyre si shpërblim të parë fituan një udhëtim studimor në Stamboll.

Ndalesa e parë e tyre ishte në Medresenë Isa Beu në Shkup. Përveç akomodimit në Medrese, Drejtorja e Medresesë



përgatiti darkë dhe mëngjes për mysafirët.

Në emër të Drejtorit, prof. Ibrahim Idrizi, mysafirët u pritën nga Sekretari i Medresesë, Lutfi Nexhipi, i cili falënderoi për vizitën në Medrese, ndërsa në pika të shkurtra i njoftoi mysafirët me rrugëtimin e Medresesë sonë ndër vite -

që nga koha e themelimit e deri në ditët e sotme; me sfidat dhe problemet me të cilat po ballafaqohet etj., thuhet në njoftimin e BFI.

Nga Medreseja Isa Beu në rrjetet sociale janë shprehur: "Në fund, u ndamë me shpresë që vizita të këtilla të kemi edhe në të ardhmen." (22.01.2023)

MEDRESEJA ME DERË TË RE

Medreseja Isa Beu (Qendër) më 20 janar, 2023, vuri derë të re, metalike, elektronike, në hyrje të oborrit të vet, thuhet në njoftimin e Drejtorit të saj, prof. Ibrahim ef. Idrizi.

Drejtorja e Medresesë falënderon kompaninë Eftinia Rols - Shkup dhe

pronarin e saj, Bejtullah Imeri, për realizimin e këtij donacioni, duke e lutur të madhin Allah që ta shpërblejë me mirësitë e Tij në këtë botë dhe në botën tjetër (Ahiret).

Gjithashtu, falënderojmë Mjeshtrin e Shtëpisë së Medresesë, Zuri Rama-

dani. dhe ndihmësin e tij Ylli Ali për mundin dhe punën e bërë, me lutje që i madhi Zot t'u japë shëndetin dhe mirësitë. Shëndeti dhe mirësitë e Tij i përcjellshin në jetë, thuhet në njoftimin e Drejtorit të Medresesë Isa Beu në Shkup. .

VIZITOHET XHAMIA E RE E LLASKARCËS

Më 3 shkurt, 2023, Sekretari i Myftinisë së BFI-Shkup, mr. Nexhmi ef. Ferati, i shoqëruar nga Referenti Armend Halimi, vizitoi xhamatin e fshatit Llaskarcë me rastin e dorëzimit të autorizimit për emërimin e Resul ef. Jakupit në detyrën imam, hatib dhe mualim në xhaminë e re të këtij fshati, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Shkupit.

Sekretari mr. Nexhmi Ferati në faljen e tij i bëri një prezantim

Resul ef. Jakupit para xhemit dhe në emër të Myftiut e uroi Imamin e ri, duke i dëshiruar suksese e mbarësi në detyrën e tij. Me këtë rast, ai përmendi obligimet dhe të drejtat e nëpunësit fetar të autorizuar, bazuar në Rregulloren e punës së Myftinisë së BFI - Shkup.

Me këtë rast, Nexhmi efendiu realizoi hytben e xhumasë dhe udhëhoqi xhamatin në faljen e namazit, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Shkupit.



MBLEDHJE E RREGULLT E MYFTINISË SË KËRÇOVËS

Më 2 shkurt, 2023, Myftinia e BFI-Kërçovës mbajti mbledhjen e saj të rregullt, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Kërçovës.

Në mbledhje ishin të pranishëm Sekretari i Përgjithshëm i Bashkësisë Fetare Islame, h. Irsal ef. Jakupi, Myftiu i Kërçovës Qamil ef. Rushiti, anëtarë të Myftinisë. Mbledhja i zhvilloi punimet në ambientet e Myftinisë.

Hapjen e bëri Myftiu i Kërçovës, Qamil ef. Rushiti, i cili falënderoi Sekretarin e Përgjithshëm të BFI-së për prezencën e tij, bashkë me anëtarët e Këshillit të Myftinisë, duke uruar mbarësi në punimet e Mbledhjes.

Sekretari i Përgjithshëm, Irsal ef. Jakupi, përshëndeti punimet e mbledhjes në emër të Reis'ul Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu dhe uroi që Myftinia e Kërçovës të vazhdojë me këtë ritëm të prosperimit dhe organizimit të jetës fetare islame.

Në mbledhje u miratuan: raporti i punës për vitin 2022; raporti i aktiviteteve për vitin 2022;

Ilogaria përfundimtare për vitin 2022; dhe propozimbuxheti për vitin aktual.

Gjithashtu, në Mbledhje mori dritë jeshile nevoja e xhemit për themelimin e një drejtorie, apo sektori të veçantë për shërbimet e varrimit. Shërbimi për varrim do ta fillojë funksionimin në vitin aktual, për shkak se është obligim, dhe e nevojshme, që xhamati ynë të shërbehet në mënyrë sa më efikase dhe sa më të organizuar gjatë rasteve të ceremonive mortore.

Duke marrë parasysh edhe nevojën që deri më tani nuk kemi pasur ndonjë siste-



mim për mirëmbajtjen e varrezave dhe çdo gjë është kryer në mënyrë vullnetare, tashmë drejtorja në fjalë do të marrë përgjegjësi që të kryejë mirëmbajtjen dhe pastrimin e rregullt të varrezave të qytetit, të cilat realisht janë pronë e BFI-së, përkatësisht e besimtarëve myslimanë.

Përveç kësaj, drejtorja në fjalë do të kryejë edhe këto shërbime: mirëmbajtja e rregullt e varrezave, pastrim i tyre me rregullshmëri (5-6 prona të varrezave të qytetit), hapja e varrit gjatë rasteve të vdekjes, sigurimi i qefinëve, sigurimi i dërrasave, apo siç njihen te ne, i pllaticave, dhe transporti i kufomave brenda qytetit.

E gjithë kjo, përballë një takse simbolike vjetore prej 1800 denarëve në familje, ose në kundërvlerë 30 euro - taksë me të cilën do të mbulohej harxhimet dhe pagat e punëtorëve që kryejnë shërbimin.

Drejtorja do të udhëhiqet nga drejtori dhe anëtarë të tjerë, të cilët do të raportojnë para Këshillit të Myftinisë dhe Myftiut të Kërçovës.

Gjithashtu, unanimisht u votua ven-

dimi që imamët që marrin pjesë në ceremonitë mortore- varrime, të mos kompensohen financiarisht, përveç imamit gjegjësi që merret me përgatitjen e kufomës.

Në interes të xhemit tonë është të bëjmë dallimin mes taksës së anëtarësisë së rregullt dhe taksës për shërbimet mortore:

- Taksa e anëtarësisë nënkupton realizimin e shërbimeve fetare-edukative brenda dhe jashtë xhamisë, kurse

- Taksa për shërbime mortore nënkupton të drejtën vetëm për ceremonitë e varrimit dhe mirëmbajtjen e vakëfeve – përkatësisht, të varrezave

Për këtë shpresojmë që trajtimi i pronës së BFI-së, përfshi vendpërjetet e të parëve tanë, tashmë do të jetë me një kujdes dhe angazhim të sistemuar.

Në planin tonë strategjik është edhe zgjerimi i veprimtarisë së kësaj drejtorie edhe në ish-komunat e Zajazit dhe të Oslloresë dhe në komunën e Pllasnicës, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Kërçovës.

XHAMIA E RINISË: PATËM IMAMIN E THERANDËS...

Më 3 shkurt, 2023, në namazin e xhumasë patëm Imamin e Therandës, mr. Driton ef. Salija, thuhet në njoftimin e Xhamisë së Rinisë - Tetovës.

Përveç hoxhës nga Republika e Kosovës, mysafir ishte dhe hoxhë mr. Nashit ef. Ferati nga fshati Zherovjan, rrethina e Tetovës.

Imami në qytetin e Therandës na frekoi me këshillat e tij të arta para namazit të xhumasë, ndërsa hoxha nga Zherovjani ligjëroi në hytbe.

Xhamati i Xhamisë mbeti tepër i kënaqur nga të dy ligjëruerit.



I bëjmë lutje Allahut (f. p.) që t'i shpërblejë hoxhallarët për vizitën që na

bënë, thuhet në njoftimin e Xhamisë së Rinisë – Tetovës.

MYFTINIA E GOSTIVARIT VLERËSOI PUNËN

Më 16 shkurt, 2023, Myftinia e BFI-Gostivar, në krye me Myftiun h. Sabahudin ef. Zendeli, mbajti mbledhjen e fundvitit për 2022. Këtë mbledhje e ndëroi prezenca e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, thuhet në njoftimin e BFI.

Kryetari i BFI të RMV shoqërohej nga h. Irsal ef. Jakupi, Sekretar i Përgjithshëm i BFI.

Mbledhja u hap me lexim Kurani nga h. Etem ef. Haliti, Imam në xhaminë e fshatit Negotinë.

Myftiu h. Sabahudin ef. Zendeli në mënyrë të hollësishme i njoftoi anëtarët e Myftinisë me të gjitha rezultatet dhe aktivitetet e vitit 2022, me shpresë që vitin që kemi nisur të jetë edhe më i begatshëm dhe më i suksesshëm.

Me këtë rast, Reis'ul-Ulemaja mbajti fjalën e rastit në fund të mbledhjes, duke e vlerësuar tejmasë punën e Myftinisë së Gostivarit, me të gjithë nëpunësit e saj dhe besimtarët në përgjithësi. Ai poten-



coi se "uniteti i përhershëm dhe angazhimi permanent, çdoherë sjellin rezultate të mirëfillta, për çka ju jemi mirënjohës".

Të gjithë anëtarët e Myftinisë i elaboruan dhe i diskutuan në detaje të gjitha punët e bëra përmes raporteve brenda vitit 2022, nga të gjithë sektorët e Myftinisë, me materiale të shkruara dhe me

planet e paraqitura për vitin 2023.

Me këtë edhe u mbyllën raportet finale, për çka u jemi mirënjohës anëtarëve të Myftinisë, imamëve, mualimëve, myderrizëve, myezinëve, këshillave të xhamive, xhematit, si dhe të gjitha strukturave të tjera organizative në nivel lokal dhe qendror, thuhet në njoftimin e BFI.

MBLIDHET KËSHILLI NDËRFETAR I SHQIPËRISË



Më 23 janar, 2023, në selinë e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë u mbajt mbledhja e parë e këtij viti e Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë, thuhet në njoftimin e KMSH.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin: Kryetari i Komuniteti Mysliman të Shqipërisë, Shkëlqesia e Tij h. Bujar

Spahiu, mikpritës i takimit. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, Kryepeshkopi i Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë, Fortlumturia e Tij Anastas Janullatos u përfaqësua në këtë mbledhje nga Hirësi Asti Bakallbashi. Kisha Katolike e Shqipërisë, Presidenti i Konferencës Ipeshkvnore, mons. Angelo

Massafra. Kryegjyshata Botërore Bekdashiane, Kryegjyshi h. Dede Edmond Brahimaj. Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë, Kryetari pastor Ergest Biti. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë, z. Genti Kruja. Sheldiana Jano, Përgjegjëse e Financës në KNFSH.

Agjenda kryesore e mbledhjes së Këshillit të Presidencës të KNFSH-së ishte kalimi i detyrës së kreut të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë për vitin 2023 nga pastor Ylli Doçi tek Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, h. Bujar Spahiu, në bazë të statutit dhe të rotacionit të miratuar në mbledhjen e Këshillit të Presidencës së KNFSH-së.

Më tej mbledhja ka vijuar me paraqitjen e raporteve financiare të vitit 2022, miratimin e anëtarëve të rinj të Bordit Ekzekutiv. Gjithashtu, është ndarë një informacion i përgjithshëm në lidhje me delegatët në Asamblenë e Këshillave Ndërfetarë të Evropës, është diskutuar agjenda e vitit 2023 etj.

Presidenca e Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë që do të mbajë Kryetari Spahiu gjatë vitit 2023 përkon edhe me 100-vjetorin e pavarësisë dhe themelimit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, thuhet në njoftimin e KMSH.

REISI PRITI DR. MEVLUD ALIUN

Më 24 janar, 2023, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu priti dr. Mevlud Aliun, mësimdhënë në SHMI "Medreseja Isa Beu" në Shkup dhe aktivist i mirënjohur në sferën fetare dhe kombëtare, i kalitur në familjen Aliu (është vëllai i Harun Aliut-shën.), familje kjo me një vetëdije të lartë të sakrificës në shërbim të kombit dhe të vatanit, thuhet në njoftimin e BFI.

U bisedua për rrjedhat fetare, në veçanti për botimin e veprës së tij me titull "Bashkësia Fetare Islame e RMV - historiku dhe funksionimi". Vepra shqyrton në mënyrë të argumentuar historikun e Isla-



mit dhe organizimin e myslimanëve në Ballkan, me theks të veçantë në RMV.

U vendos që vepra të botohet nga Ri-

jaseti i BFI të RMV, si një dokument i rëndësishëm i Islamit dhe i BFI-së në këtë nënqiell, thuhet në njoftimin e BFI.

MIRËNJOHJE NGA "ABC-POETIKE"



Rei'sul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu më 27 janar, 2023, priti Kryetarin e shoqatës së shkrimtarëve "ABC-poetike"

(Shkup), z. Vullnet Sadiku, me bashkëpunëtorët: z. Tahir Seferi, rapsod i mirënjohur dhe z. Ramadan Sadiku,

arsimtar dhe aktivist i dalluar, thuhet në njoftimin e BFI.

Kjo shoqatë qëllim kryesor ka rigjallërimin e Shtëpisë së Alfabetit Shqip në Manastir, si dhe shumë aktivitete në nivel kombëtar.

Në shenjë falënderimi dhe respekti për përkrahjen e dhënë nga BFI e RMV dhe Myftinia e Manastirit, Kryetari të BFI të RMV iu nda mirënjohje nga kjo shoqatë.

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu falënderoi për vizitën dhe kontributin që jep "ABC-poetike" në rrafshin kombëtar dhe fetar.

ÇMOHET PUNA E IMAMIT TË GËRNÇARIT

Me ftesë të veçantë të Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 14 shkurt, 2023, Imami i fshatit Gërncar, Myftinia e Resnjës, z. Sadik ef. Sadiku, erdhi në Shkup për t'u takuar me Kryetarin e BFI të RMV, thuhet në njoftimin e BFI.

Reis'ul-Ulemaja shprehu falënderimin dhe respektin ndaj Imamit për punën e palodhshme si Imam, në veçanti për suksesin që arriti gjatë muajit të Ramazanit, ku në një fshat prej 40 shtëpish arriti të tubojë 90.000 denarë Sadekatul-fitër për fondin e SHMI "Medreseja Isa Beu" në Shkup, që është një sukses i jashtëzakonshëm. Andaj, dëshira e kamotshme e Reis'ul-Ulemasë ishte që t'i ndajë mirënjohje për kontributin e dhënë në sferën e organizimit të jetës fetare islame.

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu falënderoi Imamin e nderuar për këtë sukses dhe tha se kjo dëshmon përkushtimin e hoxhës ndaj obligimeve, por dhe të institucioneve fetare islame ndaj tyre. Zoti e bekoftë me të mirat e tij.

Imami i nderuar falënderoi Reis'ul-Ulemanë për këtë respekt dhe në të njëjtën kohë konstatoi se në këtë rezultat, dhe



në punën e tij në përgjithësi, merita të mëdha ka edhe Myftiu Xhunejd Jashar, i cili në organizimin e jetës fetare inspiron të gjithë, në veçanti vetë Imamin Sadik ef. Sadiku nga Gërncari, thuhet në njoftimin e BFI.

TAKIM ME KOORDINATORIN E DENACIONALIZIMIT

Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 1 shkurt, 2023, priti në kabinetin e tij Koordinatorin e komisioneve të denacionalizimit në nivel të Ministrisë së Financave, z. Daut Hajrullahu, thuhet në njoftimin e BFI.

Me këtë rast, u zhvillua një bisedë e frytshme.

Drejtori i Sektorit për Çështje të Vakëfit, z. Driton Dikena, e njoftoi mysafirin me të gjitha kërkesat në nivel të RMV për denacionalizim të vakëfeve, ende të pakthyera.

Zotëri Daut Hajrullahu premtoi se do të jetë në funksion të mirëvajtjes së këtij procesi kudo në vend, thuhet në njoftimin e BFI.



ZV/MINISTRI ABEDINI NË RIJASET



Më 2 shkurt, 2023, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu priti Zv/Ministrin Abdylshyqyr Abedini (Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Mbarëshimit të Ujërrave) me bashkëpunëtorët: z. Shukri Osmani, z. Shaban Demiri dhe z. Musa Osmani, thuhet në njoftimin e BFI.

Reis'ul-Ulemaja shprehu falënderimet

e tij për vizitën dhe për menaxhimin e mirëfilltë të punëve në Ministri. Njëherësh, mysafirët i njoftoi me angazhimet e BFI dhe me projektet e saj. Zv/Ministri po ashtu u falënderua për takimin dhe foli për punën e Ministrisë, për mundësinë e bashkëpunimit në sfera të ndryshme dhe për kontributin që mund të japin ndërsjell

në shërbim të qytetarëve të RMV.

Zv/Ministri Abdylshyqyr Abedini njihet si një intelektual i mirëfilltë, aktivist i njohur në sfera të ndryshme të jetës politike-shoqërore, shkencore e kulturore. Është kuadër i partisë Alternativa dhe pjesë e rëndësishme e koalicionit qeveritar të RMV, thuhet në njoftimin e BFI.

KMSHZ MBAJTI KUVENDIN VJETOR

Më 22 janar, 2023, në lokalet e xhamisë "Ebu Bekr es-Sidiku" në qytetin Biel/Bienne, në kantonin e Bernës, Komuniteti Mysliman Shqiptar në Zvicër (KMSHZ/DAIGS) i zhvilloi punimet e Kuvendit të rregullt vjetor, ku ishin të parapara 8 pikë të rendit të ditës, thuhet në njoftimin e KMSHZ.

Mbledhjen e shpalli të hapur Kryetari i Kuvendit të KMSHZ, Azir Jusufi, i cili i përshëndeti kuvendarët e pranishëm dhe u dëshiroi mirëseardhje, kërkoi që hapja e punimeve të Kuvendit të bëhet me lexim të një pjese nga Kurani.

Pas leximit të asheres nga Kurani, Kryetari i Kuvendit vazhdoi me konstatimin e kuorumit, duke i lexuar xhamitë-anëtare me radhë, sipas renditjes së alfabetit. Nga 54 xhami-anëtare, në këtë kuvend morën pjesë kuvendarë nga 54 xhami.

Më pas, u kalua në miratimin e rendit të ditës, të protokollit të mbledhjes së fundit të Kuvendit të mbajtur në vitin 2022, si dhe në pikat e rendit të ditës.

Në pikën e parë të rendit të ditës Kryetari i KMSHZ, hafëz Mehas Alija, paraqiti raport të detajuar për aktivitetet e Kryesisë gjatë vitit 2022 dhe nënvizoi se puna e Kryesisë, si dhe e atij si Kryetar, ka qenë intensive dhe është shtrirë në disa rrafsh, duke theksuar në veçanti organizimin e seminareve për imamët e KMSHZ-së, përfaqësimin e KMSHZ-së në evente të ndryshme të xhamive-anëtare, dialogun interreligjioz, si dhe komunikimin me institucione relevante në Zvicër dhe në vendlindje.

Kryetari Mehas Alija në veçanti apostofoi bashkëpunimin me përfaqësuesit e organizatave islame të mërgatës shqiptare në Evropën perëndimore. Në fund të ekspozesë së tij për aktivitetet e Kryesisë, ai paraqiti edhe disa nga aktivitetet më të rën-



dësishme, të cilat Kryesia planifikon t'i realizojë gjatë këtij viti, duke i veçuar aktivitetet për Festat e Nëntorit dhe Ditët e mërgatës shqiptare në Zvicër. Ai e mbylli raportimin e tij me fjalët: "Puna intensive dhe kualitative e udhëheqjes së KMSHZ-së, imamëve dhe e drejtuesve të xhamive-anëtare, e ka ngritur reputacionin e KMSHZ-së, si dhe e ka bërë një emër me respekt në shoqëri."

Vend të rëndësishëm në punimet e Kuvendit zuri edhe raportimi për finalizimin e projekteve të financuara nga KMSHZ pas tërmetit në Shqipëri, si dhe ndihmat për renovimin e konviktit të nxënësve në Medresenë Alaiddin në Prishtinë, që u prezantua nga Sekretari dhe Përgjegjësi për këto projekte, Ismail Ademi.

Punimet e Kuvendit kaluan në atmosferë konstruktive dhe kooperative, pasi delegatët treguan interesim dhe participuan me diskutimet dhe sugjerimet e tyre për çdo pikë të rendit të ditës.

Në veçanti, për këtë kuvend, duhet theksuar miratimin e disa vendimeve që kanë të bëjnë me mbështetjen financiare të KMSHZ-së, si dhe angazhimin e kuvendarëve që Kryesia e KMSHZ-së të punojë në drejtim të sigurimit të burimeve financiare të vazhdueshme për KMSHZ-në.

Posaçërisht, fokusimi i kuvendarëve

ishte në nevojën e formimit të bazës së sigurt financiare në Zvicër, nga kontributet e ndryshme të pjesëtarëve të mërgatës sonë në Zvicër, si dhe realizimin e projekteve të ndryshme në interes të komunitetit mysli-man shqiptar dhe të shoqërisë në përgjithësi, këtu në Zvicër.

Nga ana e kuvendareve femra u dha një vërejtje në lidhje me përfaqësimin e vogël të numrit të femrave në Kuvend, edhe krahas rekomandimit që nga tre kuvendarë të xhamive-anëtare, njëri të jetë femër. U kërkua që kryesia e KMSHZ-së të angazhohet më tepër në aktivitetet me gjininë femërore, aktivizimin e Sektorit të femrës, si dhe senzibilizimin e xhamive për nevojën e përfaqësimit të femrave në strukturat udhëheqëse të xhamive dhe në KMSHZ.

Në këtë kuvend u miratuan edhe aplikimet e tre xhamive të reja për anëtarësim në KMSHZ, me çka numri i xhamive-anëtare të KMSHZ arrin në 57 xhami.

Punimet e Kuvendit i shpalli të mbyllura Kryetari i Kuvendit të KMSHZ-së, Azir Jusufi, i cili i falënderoi kuvendarët për pjesëmarrje në një numër kaq të madh në këtë kuvend, si dhe nikoqirin, Imamin dhe Kryesinë e Xhamisë Shqiptare në Biel/Bienne, për mikpritjen dhe organizimin e shkëlqyer të hapësirës së mbajtjes së Kuvendit, thuhet në njoftimin e KMSHZ.

FESTË NË ROMANSHORN

Ditë festive: më 22 janar, 2023, ditë e diel, në xhaminë tonë patëm ceremoninë e hapjes së mejtepit (klasës) për nxënësit e gjinisë femërore që ndjekin mësimbesimin pranë mualimes, thuhet në njoftimin e Xhamisë Shqiptare në Salmsach/Romanshorn (Zvicër).

Prezenca masive e xhematit si nga gjinia mashkullore, ashtu dhe nga gjinia femërore, ishte pjesa më e këndshme e programit.

Qershia mbi tortë, ndërkaq, ishin tablelet, që u gëzuan tejmase kur u ulën në

bankat e klasës së tyre të re.

Prej këtu shfrytëzojmë rastin që ta falënderojmë xhematin, Kryesinë, pjesëmarrësit, si dhe gjithë ata që kanë kontribuar për hapjen e kësaj foleje të arsimit.

Allahu ju shpërbleftë dhe ju bekoftë në dynja dhe në ahiret, thuhet në njoftimin e Xhamisë Shqiptare në Salmsach/Romanshorn.

Imam në Xhaminë Shqiptare në Salmsach/Romanshorn është Mixhit ef. Osmani nga Tetova.



IMAMI I HAMBURGUT TAKOI REISIN

Më 8 shkurt, 2023, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu priti Imamin e Hamburgut, h. Zulhajrat ef. Fejzullahu, thuhet në njoftimin e BFI.

Në pritje ishte dhe dr. Selver Xhemaili, Drejtor i Sektorit të Mërgatës në Rijasetin e BFI-së.

Zulhajrat ef. Fejzullahu më parë ka qenë Koordinator i Unionit të Bashkësive Islame të Gjermanisë.

Reis'ul-Ulemaja u falënderua për vi-

zitën dhe me mysafirin bisedoi për organizimin e jetës fetare në Gjermani, me theks të veçantë në qendrën e madhe, Hamburg. U bisedua edhe për shumë çështje - në veçanti, për organizimin e jetës fetare, si dhe për aktivitetet gjatë muajit të shenjtë të Ramazanit.

Haxhi Zulhajrat ef. Fejzullahu tërë jetën ia kushtoi Islamit, organizimit të jetës fetare dhe ngritjes së vetëdijes islame dhe kombëtare të popullit tonë në

Gjermani e më gjerë. Ai është themelues i Qendrës Islame më të madhe në Gjermani dhe në mesin e mërgatës dhe tani ajo paraqet vatrën e besimit, të edukimit, të dijës dhe të kontributit universal në jetën e bashkatdhetarëve tanë atje, si dhe inspirim për të gjitha Qendrat dhe xhematet në Gjermani.

Zoti e bekoftë me të mirat e Tij, thuhet në njoftimin e BFI.

URTËSITË MJEKËSORE TË AGJËRIMIT

Asnjë fe, qoftë qiellore ose joqiellore, në asnjë kohë nuk mbeti pa ndonjë formë të agjërimit. Kjo vetvetiu flet për rëndësinë dhe lidhshmërinë e përhershme të këtij imperativi të madh kuranor (agjërimit) me vetë njeriun. Agjërimi është mjeku më i dashur dhe më i lirë në botë, por me kusht që agjërimit tonë ta shoqërojë normaliteti në ngrënien e ushqimit, e jo teprimi, sepse në atë rast mund që të ketë ndikim negativ.

Shkruan: prof. Rexhep ef. Ziberi

Hulumtimi mbi vlerat, rëndësitë dhe ligjet islame në çdo kohë, në çdo vend dhe në çdo popull ka qenë cak i debateve të ndryshme në opinion. Një nga këto vlera, që kohëve të fundit ka filluar të hulumtohet me të madhe nga studiuesit dhe shkencëtarët, është edhe agjërimi. Jo vetëm institucionet fetare, por edhe ato laike, po i japin një rëndësi të madhe këtij imperativi të madh kuranor.

Nga Kurani famëlartë mësojmë se agjërimi ka qenë i obligueshëm edhe në shpalljet e mëparshme religjioze. Madje, disa autorë vërtetojnë se agjërimi ka qenë prezent edhe në kohët pagane, ndërsa ekzistojnë fakte se ai ka qenë prezent edhe në civilizimin e vjetër egjiptian.

Ajo që duhet kuptuar nga kjo është se asnjë fe, qoftë qiellore ose joqiellore, në asnjë kohë nuk mbeti pa ndonjë formë të agjërimit. Kjo vetvetiu flet për rëndësinë dhe lidhshmërinë e përhershme të këtij imperativi të madh kuranor (agjërimit) me vetë njeriun.

Sipas asaj që përshkruan juristi i famshëm Muhamed Hamidullah, agjërimi është pjesë e përgjithshme e ligjeve natyrore që krijoi Krijuesi i gjithë krijesave, sepse si në botën bimore, ashtu dhe në botën shtazore ndërprerja e kohëpaskohshme e ushqimit ekziston si akt i domosdoshëm, pa të cilin ata mund të jetojnë një kohë të gjatë. Shembuj të gjallë dhe konkret në botën shtazore kemi ariun e bardhë të Polit të Veriut, i cili është në gjendje të mbijetojë gjashtë muaj pa ushqim!

VLERA TË MËDHA

Ata që i mohojnë kuptimet dhe vlerat e mëdha të agjërimit, gabimin e tyre në këtë fushë së paku mund ta përmirësojnë në hulumtimet e shumta medicinale mbi dobitë e agjërimit, si dhe në botimet e librave të ndryshëm nga vetë autorë të Pe-



rëndimit mbi dobitë e agjërimit për njeriun.

Hulumtimet shkencore kanë vërtetuar se agjërimi nën tridhjetë ditë është pa efekt, ndërsa ai mbi dyzet ditë është agjërimit i tepruar. Nga e gjithë kjo, është logjike që mjekësia moderne shërimin e shumë sëmundjeve të ndryshme ta bëjë me ndërprerjen e ushqimit, ose me agjërimit periodik.

Para një mijë e pesëqind viteve Mësuesi i njerëzisë tha: *“Agjëroni, që të shëroheni.”* Tani, ndërkaq, erdhi koha kur shkencë bashkëkohore e mjekësisë, ashtu siç vërtetoi shumë thënie të tjera të Muhamedit (a. s.), të vërtetojë edhe këtë thënie të Mësuesit të njerëzisë, duke luajtur rolin kyç në mbrojtjen e sëmundjeve të ndryshme nëpërmjet agjërimit, si dhe shërimin e shumë sëmundjeve me vetë agjërimit, ndër të cilat veçojmë vetëm disa nga dobitë dhe shërimin e sëmundjeve të mëposhtme:

Agjërimi forcon sistemin imunitar tek agjëruesi;

Agjërimi kryen funksionin e kirurgut, duke bërë eliminimin e qelizave të shkatërruara prej trupit të njeriut;

Agjërimi shëron lëkurën e njeriut, pasi që ai e pakëson përqindjen e ujit në gjak;

Agjërimi ndihmon në shërimin e tensionit të lartë të gjakut, sepse ulja e peshës së agjëruesit dukshëm e ul edhe

tensionin e gjakut;

Agjërimi shëron mbi tetëdhjetë përqind të sëmundjeve të zemrës. Studiuesit shkencorë në mjekësi kanë vërtetuar se agjërimit e ul përqindjen e kolesterolit;

Agjërimit e zvogëlon përqindjen e sheqerit në gjak;

Agjërimit ndihmon në shërimin e organeve të tretjes, siç janë infeksioni i organeve të tretjes, vështirësitë e tretjes, trazimi i zorrëve etj.

Agjërimit është mjeku më i dashur dhe më i lirë në botë, por me kusht që agjërimit tonë ta shoqërojë normaliteti në ngrënien e ushqimit, e jo teprimi, sepse në atë rast mund që të ketë ndikim negativ.

Lidhur me këtë, Allahu fuqiplotë në Kurandin famëlartë thotë: *“...hani dhe pini e mos e teproni, sepse Ai (Allahu) nuk i do ata që e teprojnë.”* (A'raf: 31)

Muhamedit (a. s.) ia dërguan mjekun dhuratë nga Persia. Mjeku qëndroi në Medinë gjashtë muaj. Pas gjashtë muajve u zgjua një mëngjes dhe, pa e informuar Pejgamberin (a. s.), mori rrugën për t'u kthyer në Persi. Në pyetjen që ua bëri Muhamedi (a. s.) as'habëve lidhur me kthimin e mjekut në Persi, as'habët i thanë se mjeku para se të shkonte kishte thënë: *“Gjashtë muaj qëndrova në mesin tuaj, por akoma s'më erdhi njeri për t'u shëruar!”* Atëherë, Mësuesi i njerëzisë tha: *“Ne jemi një popull (ummet) që*

kurrë nuk hamë pa u uritur, ndërsa kur na merr uria, hamë, por nuk ngihemi asnjëherë.”

Në hadithin tjetër ai tha: *“Enën më të dëmshme që i biri i Ademit e mbush është barku i tij. Birit të Ademit i mjaftojnë disa kafshata që të jetojë drejt (ta mbajë trupin drejt). E nëse është patjetër (merret me punë të rënda fizike), atëherë le ta mbush një të tretën e barkut me ushqim, një të tretën me ujë, kurse një të tretën tjetër le ta ruajë për frymëmarrje.”* (Transmeton Ebu Isa Tirmidhiu)

NGOPJA PENGON TRETJEN E USHQIMIT

Një njeri i urtë kishte thënë: *“Dije se ngopja sjell në dobësim në tretjen e ushqimit, dobësimi i tretjes së ushqimit sjell sëmundje, kurse sëmundja sjell vdekjen. Kush vdes në këtë mënyrë, ai ka vdekur me vdekje të mjeruar. Ai që e mbytet vetveten është më i urryer te Zoti sesa ai që ka mbytur tjetërkënd.”*

E kanë pyetur mjekun e madh arab, El-Harith ibn Haldin, se ç'është thelbi i mjekësisë? Ai është përgjigjur: *“Përmbajtja nga ushqimi.”*

Sipas shkencës së etiologjisë, shkak i paraqitjes së sëmundjeve të shumta është konsumimi i tepruar i ushqimeve, ndërsa qëllimi i Islamit nëpërmjet agjërimit dhe mostepimit në konsumimin e ushqimeve është ruajtja e gjendjes fizike ose e vetë shëndetit të njeriut.

Shëndeti është dhurata më e madhe të cilën na e ka dhuruar Krijuesi Absolut dhe pa dyshim se duhet të jemi falënderues ndaj Krijuesit tonë për shëndetin që Ai na dhuroi.

Mësuesi i njerëzisë thotë: *“Nuk ka lutje më të dashur tek Allahu fuqiplotë sesa lutja për shëndet të mirë.”* (Transmeton Ebu Isa Tirmidhiu)

Davudi (a. s.) kishte thënë: *“Shëndeti është pasuri që nuk duket; shëndeti është mbretëri e fshehtë; shëndeti është kurorë në kokat e njerëzve të shëndoshë, të cilën dinë ta vlerësojnë vetëm të sëmurët!”*

(Autori është Kryetar i Shoqatës së Ulemave të BFI të RMV)

PËRFITIMET SOCIALE TË AGJËRIMIT

- të përmbahesh nga diçka, ndër vite-



Nga prof. dr. Faredin Ebibi (Enkas për Her)

Agjërimit konsiderohet ndër institucionet që e rikthen rendin dhe unitetin, dashurinë për drejtësi dhe barazin, krijimin e emocioneve të mëshirës, nxitjen drejt dashamirësisë, garën për të mirë dhe ruajtjen e shoqërisë nga çdo e keqe dhe situatë korruptive.

Kur agjëruesi përmbahet nga dëshirat epshore dhe nevojat e jetës, e kupton se nga çfarë vuajnë të varfrit dhe të ngratët nga uria dhe privimi. Në këtë mënyrë, shpirti i agjëruesit ngrihet dhe vërshohet nga butësia, mirësia dhe bujaria.

Kur hynte muaji i Ramazanit, i dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi vese-l-em] ishte shumë human, solidar dhe bujar, i lironte shërbëtorët, jepte bamirësi, ashtu që bujaria e tij bashkonte të gjitha llojet e bujarive; i këshillonte njerëzit dhe i përkushtojte fort Krijuesit të vet.

Enes b. Maliku ka treguar që i dërguari i Allahut ishte më i miri i njerëzve, më trimi i njerëzve dhe më bujari i njerëzve.ⁱⁱ

Në aspektin gjuhësor *agjërimit* do të thotë *të përmbahesh nga diçka*. Sa i përket kon-

ceptit të agjërimit, në mënyrë idiomatike do të thotë: abstenim i një personi nga të gjitha gjërat që e prishin agjërimit nga agimi deri në përfundim të diellit dhe qëllimi i tij është i kushtëzuar (me nijet), me qëllim që përmes agjërimit të bëhet afrimi te Krijuesi i gjithësisë, pasi që myslimani i respekton kushtet që Krijuesi i gjithësisë ia ka caktuar. Rreth këtij koncepti janë unike të katër shkollat juridike islame.

Agjërimit është bërë obligim për myslimanët në muajin e Ramazanit në vitin e dytë pas hixhretit. Një konstatim të këtillë e konfirmojnë Kurani dhe Sunneti. Në Kurandin finisnik është theksuar: **“O ju që keni besuar, ju është shkruar (ju është bërë obligim) agjërimit, ashtu siç ishte shkruar (siç ishte bërë obligim) edhe për ata që ishin para jush.”**ⁱⁱ

Dispozita e llojeve vullnetare të agjërimit është sunnet. Është transmetuar nga i dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi vese-l-em] se ai ka agjëruar të hënave dhe të enjeteve. Edhe gjashtë ditët e muajit Sheval i ka kaluar me agjërimit.

Agjërimit i zotimit: Është detyrim kur myslimani zotohet të agjërojë një ose disa ditë. Ndërkaq, agjërimit i detyrueshëm për

myslimanët është agjërimit i muajit të Ramazanit.

Sistemi i agjërimit myslimanit i mëson rendin, drejtësinë dhe barazinë. Veç tjerash, ia rrit ndjenjën e dhembshurisë ndaj të tjerëve, për faktin se ata këtë muaj garojnë në vepra të mira bamirësie, në mënyrë që shoqëria të mbrohet dhe të kursehet nga tundimet dhe të këqijat.

Myslimani i pasur kur ndjen për vël-lain e tij të uritur dhe të varfër, shpirti i tij ngrihet dhe bëhet zemërbutë. Bëhet më zemërbutë dhe më bujar ndaj të varfërve se çdoherë tjetër, i frymëzuar nga i dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi vese-l-em] që sadakaja në muajin e Ramazanit është prej lëmoshave më të mira që jep myslimani.

Gjatë muajit të agjërimit myslimani mëson, kalitet dhe duhet të përshtatet me ndryshimet. Ramazani është muaji i ndryshimeve edhe në ato çështje që nuk shihen. Xheneti ndryshon për atë se dyert e tij hapen, ndërsa dyert e xhehenemit mbyllen si dhe djajtë (shejtanët) prangosen me pranga. Prandaj, myslimani duhet të ndryshojë duke e rritur besimin dhe duke e ndryshuar sjelljen e tij.

Adhurimet kërkojnë durim. Përveç durimit, kërkohen edhe përkushtimi edhe dashamirësia. Pasi të ketë përfunduar muaji i Ramazanit, njeriu duhet të ketë ndryshuar moralin, sjelljet dhe karakteristikat e tij. Nëse një gjë e këtitllë nuk ndodh, kjo do të thotë se agjërimit ka qenë jo i suksesshëm; nuk ka lënë gjurmë, nuk ka ndikuar dhe si i tillë, ka përfunduar pa efekte.

Toleranca në muajin e Ramazanit motivon zvogëlimin e grindjeve, të mo-

smarrëveshjeve dhe të mospajtimeve midis njerëzve, sepse është muaj i tolerancës, muaj i intimitetit dhe u dashurisë. I dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi vese-l-em] ka kërkuar që shoqëria të jetë simbiotike dhe bashkëpunuese, si një familje. Edukata e mirë e ngre agjërimit në shpirtin e myslimanit.

I dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi vese-l-em] është shprehur: “...**nëse dikush e shan ose e lufton (agjëruesin), le të shprehet: Unë jam agjërueshëm.**”ⁱⁱⁱ

Në ditët normale, ushqimi dhe pijet janë në çdo kohë nevojë e njeriut, por në muajin e Ramazanit ngrënia dhe pirja organizohen në çdo vend të botës, kështu që askush nuk konsumon ushqim ose pije para ezanit të akshamit. Të gjithë myslimanët heqin dorë nga çdo gjë që e prish agjërimitin - nga agimi e deri në perëndim të diellit, pavarësisht kushteve atmosferike, përkatësisht pavarësisht motit - a është i nxehtë, a është i ftohtë. Te myslimani shfaqet forca dhe energjia e fesë dhe kjo e mposht etjen dhe urinë. Në atë gjendje ai e pret fundin e ditës. Jehona e ezanit është ajo që buçet nga minaret, për ta përfunduar agjërimitin e ditës - për të bërë iftar.

Agjërimiti është i barabartë për të gjithë; s’ka rëndësi nëse agjëruesi është i pasur, apo i varfër. Të gjithë njëjtë janë të përmbajtur nga konsumimi i ushqimit, nga pijet dhe marrëdhëniet intime nga agimi - syfiri deri në perëndim të diellit, në iftar. Kur i pasuri heq dorë nga ushqimi dhe pijet gjatë të ditës, ka ndjesinë e njëjtë si i varfri. Në mënyrë të pashmangshme, do të ndiejë vuajtjen e të varfërve, të atyre që vazhdimisht nuk


kanë ushqim. Për këtë arsye, agjërimiti është shkak për rritjen e ndjenjës së dhurimit të lëmoshës, të bamirësisë dhe të zëqatit tek i pasuri për shtresat e varfra. Kështu, pra, të pasurit do t’u ndihmojnë të varfërve, duke ua zbutur sadopak barrën e ekzistencës. Kjo i ndihmon të varfërit, duke ua ngritur sadopak standardin e jetesës. Kjo i bashkon individët dhe në një farë forme ua zgjidh mosmarrëveshjet.

Si përfundim, mund të thuhet që agjërimiti i bashkon të gjithë anëtarët e familjes në iftar, ndryshe nga ditët tjera. Në Ramazan individët mblidhen dhe familjet gjithashtu takohen. Tubimet komunikimi midis vete i largojnë inatet ose urrejtjet nga shpirtat e myslimanëve. Myslimanët për çdo ditë takohen mes vete pas darkës - pas iftarit për të falur namazin e teravive, kështu që ata qëndrojnë krah për krah në një rresht. Nëse ka midis tyre ndonjë ftohje të raporteve, ftohja gradualisht evitohet si rezultat i asaj se ata shihen për çdo ditë dhe e falin namazin bashkërisht, të rreshtuar në një rresht, kështu që marrëdhëniet përmirësohen. Në këtë mënyrë Ramazani i bashkon individët, grupet dhe familjet, duke i nxitur dhe motivuar në bashkëpunim.

ⁱ Ahmed, *Musnedu imam Ahmed*, Mues-setu-r-isale, botimi i parë, 1421 / 2001, Bejrut, 19, 477.

ⁱⁱ Kuran, 2 : 183.

ⁱⁱⁱ Muslim, *el-Musnedu-s-ahihu-l-muhtesar bi naksi-l-adli ani-l-adli ila resulilahi [sal-lallahu alejhi vese-l-em]*, Daru ihjali-t-urathe-l-arebi, Bejrut, 2, 806.



ZEQATI NË RRUGËN E ALLAHUT (XH. SH.)

Medreseja Isa Beu, si dhe Fakulteti i Shkencave Islame, si dy institucione shkencore dhe edukativo-arsimore që funksionojnë në vendin tonë, e që janë të dëshmuara jo vetëm në vend, por edhe në Ballkan, Evropë e më gjerë për kontributin e dhënë në shërbim dhe mbrojtje të Islamit, janë themeluar dhe funksionojnë pikërisht duke iu falënderuar institucionit të zeqatit, të sadekatul-fitrit dhe ndihmave të tjera vullnetare, të cilat besimtarët tanë i dhurojnë me paracaktim për këto institucione.

Shkruan: mr. Muzemil Osmani (Enkas për HeR)

Dijetarët islamë bashkëkohorë janë të mendimit se pasuria e zeqatit duhet të destinohet në të gjitha ato vende dhe institucione të cilat janë garanci e zhvillimit, e ruajtjes dhe e ngritjes së Islamit institucional te myslimanët, për një jetë sa më progresive. Kjo bëhet me kuadro të mobilizuara, të cilat do të jenë të gatshme që të sfidojnë të gjitha pengesat në zhvillimin e Islamit dhe të myslimanëve.

S’do mend se për t’i poseduar këto kuadro dhe për të qenë të gatshëm t’u përgjigjemi nevojave të kohës, detyrimisht duhet të theme-lojmë institucione të larta shkencore dhe stabile për nxjerrjen e kuadrove të nevojshme. Për këtë arsye, për myslimanët bashkëkohorë, përfshi edhe neve në vendin tonë, imperativ islam dhe kohor janë themelimi, ngritja dhe mirëmbajtja e këtyre institucioneve dhe shkollave me karakter fetar-shkencor dhe me karakter edukativo-arsimor, ngritjen e institucioneve organizative për çështje islame, ndarjen e bursave për arsimim, themelimin e enteve, akademive dhe institucioneve të tjera siç janë shtypi, kanalet televizive, rrjetet sociale për predikimin e Islamit dhe mjeteve të tjera të sofistikuara bashkëkohore.

Veprohet dhe gjykohet kështu ngase vetëm përmes kësaj forme mund të përballohen dhe të hidhen poshtë të gjitha tendencat e errëta që po zhvillohen sot për etiketimin, njollosjen dhe minimizimin e Islamit dhe të myslimanëve. Andaj, edhe funksionimi i institucioneve tona edukativo-arsimore islame që u ngritën me kontributet e myslimanëve tanë, siç është Medreseja Isa Beu me qendër në Shkup, me Paralelet e Shtrira në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe Fakulteti i Shkencave Islame, është pikërisht në shërbim të këtij qëllimi.

Këto dy institucione shkencore dhe edukativo-arsimore që funksionojnë në vendin tonë, e që janë të dëshmuara jo vetëm në vend, por edhe në Ballkan, Evropë dhe më gjerë për kontributin e dhënë në shërbim dhe mbrojtje të Islamit, janë themeluar dhe funksionojnë pikërisht



duke i falënderuar institucionit të zeqatit, sadekatul-fitrit dhe ndihmave të tjera vullnetare që besimtarët tanë i dhurojnë duke ua dedikuar këtyre institucioneve.

Andaj, duke marrë parasysh këto shpjegime që na i bënë dijetarët eminentë islamë bashkëkohorë mbi ajetin kuranor që e përcakton destinimin e zeqatit dhe sadekatul-fitrit, si kategori “në rrugën e Allahut”, mendojmë se dhënia e zeqatit në këtë kategori është nevojë permanente, me prioritet të veçantë për besimtarët tanë, veçanërisht në kohën që po jetojmë, sepse interpretimi ndryshe jo vetëm që nuk është në frymën e parimeve islame, por do të ishte edhe një gabim historik i pafalshëm.

Nëse me vëmendje e kundrojmë ajetin kuranor që i përcakton kategoritë e destinimit të zeqatit, me lehtësi mund të vërejmë se institucioni i zeqatit nuk është çështje individuale, por është çështje shoqërore dhe institucionale. Nëse destinimin e zeqatit e trajtojmë si e drejtë individuale, atëherë çfarë vlere do të kishte urdhri i Allahut (xh. sh.) që i dha Pejgamberit (a. s.) për grumbullimin e zeqatit? Apo, çfarë vlere do të kishte kategoria e destinimit të zeqatit “grumbulluesit e zeqatit”?

Kjo nënkupton qartë se grumbullimi i zeqatit, regjistrimi i tij, administrimi etj., nuk është thjesht dëshirë, por është detyrim islam. Kështu e kishte kuptuar edhe Ebu Bekri (r. a.) kur u shpalli luftë fizike atyre që refuzuan të japin zeqatin dhe u shpreh se do t’i luftojë ata edhe nëse pengojnë qoftë edhe një kërpesh të devesë. Këtë mendim dhe praktikë të Ebu Bekrit e përkrahën të gjithë sahabët, pa përjashtim.

Prandaj, ky gjykim i Ebu Bekrit jep të kuptojmë disa çështje shumë të rëndësishme për ne, e në mesin e tyre janë:
-Grumbullimi i zeqatit në Bejtul Mal

(arkën shtetërore) - është detyrim i myslimanëve;

-Fshehja e zeqatit dhe mosdhënia e tij - shkakton veprim penal, që pas vete bart përgjegjësi penale.

Meqë kategoritë e destinimit të zeqatit i ka përcaktuar Allahu fuqiplotë, e drejta e interpretimit të gjendjes dhe përcaktimit të prioritetit se ku duhet destinuar zeqati është e udhëheqjes islame dhe e institucioneve të tyre, dhe jo e individëve.

Këto parime të përgjithshme islame i ngarkojnë institucionet e Bashkësisë Fetare Islame me përgjegjësi juridike dhe islame si para myslimanëve, ashtu edhe para Allahut fuqiplotë që fillimisht të japin shpjegim dhe interpretim të sakta shkencore rreth këtij obligimi islam, e më pas edhe të menaxhojnë dhe të administrojnë me këtë përgjegjësi të ngarkuar.

Përmes këtij veprimi, detyrimisht duhet t’u ndalen rrugët disa shoqatave, organizatave dhe grupeve të ndryshme, të cilat, kinse në emër të humanizmit të Islamit, i japin vetes të drejtën që të grumbullojnë zeqatin dhe sadekatul-fitrin dhe ato të përfundojnë atje ku nuk dihet.

Prandaj, e kemi obligim islam që maksimalisht të përkujdesemi për obligimet tona që i kryejmë.

Kështu, jo vetëm që shpresojmë, por jemi të bindur se vetëdija e myslimanëve tanë do të jetë në nivelin që e kërkon Islami dhe me pasurinë e tyre obligative do të jenë në shërbim të Islamit dhe të myslimanëve në përgjithësi, duke mos i lënë kohës hapësirë që këto institucione të amortizohen në funksionim për shkak të mosdhënies së zeqatit dhe të sadekatul-fitrit.

(Autori është Përgjegjës i Bibliotekës Isa Beu në Shkup)

TË DY JEMI ROBËR TË ALLAHUT...

Edhe pse historianët e përmendin atë si ahmak dhe të çmendur, ai ishte jashtëzakonisht i mençur dhe i zgjuar. E quanin Behlul, por emri i tij i plotë ishte Vehb ibn Amr.

Behluli hynte te kalifi Harun Reshidi pa ndonjë frikë dhe turp, kur të donte, dhe fliste atë që dëshironte. *(Besimtari lufton me shpatën dhe gjuhën e tij.)*

Behluli, në fakt, bëhej sikur ishte i çmendur sa për të pasur justifikim dhe pastaj tallej dhe bënte shaka në llogari të pushtetit, pa pasur frikë se do të përgjigjej për të. Sepse, si do të thirrje në përgjegjësi njeriu i çmendur?! Ndërkaq, fjalët e Behlulit ishin të mprehta si shpata, bindëse si prova të qarta dhe si fakte të pakundërshtueshme.

Në një rast, midis Behlulit dhe Harun Reshidit u zhvillua biseda në vazhdim.

Harun Reshidi: U përmalova shumë për ty, o Behlul.

Behluli: Kurse unë për ty jo.

Harun Reshidi: Më këshillo, o Behlul.

Behluli: Pse duhet të të këshilloj?

Harun Reshidi: Fjalët tua janë të bukura dhe të dobishme, andaj dua ta dëgjoj këshillën tënde.

Behluli: Di je, o udhëheqësi i besimtarëve, cilitdo njeri që Allahu i dhuron pasuri dhe bukuria dhe ai pasurinë e tij e shpenzon në rrugën e Allahut, e ruan dëlirësinë dhe pafajësinë e tij, dhe sundon me drejtësi, ai do të shkruhet tek Allahu si bamirës i vërtetë dhe i zgjedhur.

Harun Reshidi: Sa bukur që e ke thënë këtë, o Behlul! Po cili është qëndrimi yt ndaj shpërblimeve dhe dhuratave?

Behluli: Dhuratat ua kthej



atyre që m'i kanë dhënë dhe nuk kam nevojë për to.

Harun Reshidi: A mos ke ndonjë borxh, që të të ndihmoj për ta larë?

Behluli: Dijetarët e Kufës janë unanimitë në mendimin se nuk është e lejueshme që borxhi të lahet me borxh.

Harun Reshidi: O Behlul, por unë po dua të të jap diçka që të ndihmoresh për ta bërë jetën tënde më të lehtë.

Behluli: O udhëheqës i besimtarëve, ne të dy jemi robër të Allahut - është e pamundur që Allahu ty të të kujtojë, kurse mua të më harrojë!

Pas kësaj, kalifi Harun Reshidi uli kokën dhe u largua.

Behluli, ndërkaq, u shpreh në vargje:

Tek Allahu mbështetem dhe tek askush tjetër nuk i var shpresat përveç Tij.

Sepse, furnizimi nuk vjen nga njerëzit,

por nga Allahu, Furnizuesi, i Vetmi.

(Burimi/13.02.2023: Saff.ba. Përktheu: Miftar Ajdini/Islampress/në bashkëpunim)

PRITJE PËR BAMIRËSIT E MBRETIT SAUDIT



Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti delegacionin e Organizatës Saudite për Bamirësi të Mbretit Selman bin Abdulaziz, z. Abdurrahman ez-Zebn dhe z. Sulltan el-Xherbu, thuhet në njoftimin e BFI.

Delegacioni do të qëndrojë në RMV si mysafir i BFI për pesë ditë.

Me këtë rast, Reis'ul-Ulemaja falënderoi mysafirët për vizitën e tyre dhe u shprehu mirëseardhjen.

Njëherësh, të dyja palët biseduan për aktivitetin e tyre në sferën e bamirësisë në vendin tonë.

Vizita e mysafirëve menaxhohet nga h. Ismet ef. Ademi, Drejtor për Marrëdhënie me Lindjen e Mesme, thuhet në njoftimin e BFI. (8.02.2023)




Një takim i rëndësishëm me mjeshtrin e fotografisë, z. Alush Vejseli, nga Shkupi. Tërë jetën ia ka kushtuar këtij profesioni dhe ka bërë një rrugëtim të jashtëzakonshëm, me gjurmë të pashlyeshme në këtë sferë, në veçanti në fotografimin dhe incizimin e monumenteve dhe të objekteve fetare. I urova shëndet dhe suksese të reja. Ishte kënaqësi. Zoti e bekoftë, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook. (24.01.2023)

PËR NJË BASHKËPUNIM AMS - "HALLALL"

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu më 14 shkurt, 2023, priti Drejtorin e Agjencisë për Mbështetje të Sipërmarrësisë në RMV, z. Hajrulla Misini, i cili shoqërohej nga bashkëpunëtori z. Gafur Zharku, thuhet në njoftimin e BFI.

U bisedua gjerë e gjatë, në veçanti, mbi agjencinë që udhëheq mysafiri, për rolin dhe rëndësinë e saj në sferën e ndihmës për punësim dhe shërbime të tjera me ndërmarrje të sferave të ndryshme.

Gjithashtu, u bisedua edhe për një bashkëpunim të mirëfilltë të Agjencisë për Mbështetje të Sipërmarrësisë (AMS) me Agjencinë e Standardit Hallall, e cila vepron në kuadër të Bashkësisë Fetare



Islame.

Reis'ul-Ulemaja falënderoi drejtorin e kësaj agjencie për këtë takim shumë të

rëndësishëm, me idenë e një bashkëpunimi të afërt dhe të vazhdueshëm, thuhet në njoftimin e BFI.

PRITET AKTIVISTI I MIRËNJOHUR NGA SARAJEVA



Më 14 shkurt, 2023, z. Mitat Fidani, i cili për më shumë dekada është me punë në Bashqarshinë e Sarajevës, njëherësh dhe aktivisti i mirënjohur dhe aktualisht

Kryetar i Shoqatës Kulturore Shqiptare në Bosnjë e Hercegovinë, u prit në Rijaset nga Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, thuhet në njoftimin e BFI.

Z. Mitati është nga Balindolli i Gostivarit, i biri i rahmetli haxhi Neimit, një afarist i njohur i Sarajevës dhe Gostivarit.

Me këtë rast, mysafiri e informoi Reis'ul-Ulemanë për aktivitetet e tij në Sarajevë dhe për motivet e formimit të Shoqatës së re kulturore shqiptare në Sarajevë dhe synimet e saj në ngritjen e vlerave kulturore shqiptare në Sarajevë e më gjerë.

Reis'ul-Ulemaja e uroi për detyrën, duke i dëshiruar suksese në punë. Duke marrë parasysh dhe anëtarët tjerë të Kryesisë, si z. Abi dhe z. Bicaj, kjo shoqatë premtom punë të mbarë dhe suksese të reja.

Kryetari i BFI të RMV i ndau mirënjohje z. Mitat Fidani për aktivitetin e deritanishëm në sfera të ndryshme.

TAKOHET INSPEKTORI ILJAZ LESKOVICA

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu më 6 shkurt, 2023, priti në Kabinetin e tij z. Iljaz Leskovica, Inspektor i lartë në Qeverinë e RMV, thuhet në njoftimin e BFI.

Atë e shoqëronin bashkëpunëtorët e tij dhe hoxha i mirënjohur, donator i dalluar, Muharrem ef. Ismaili.

Në këtë takim u bisedua për shumë çështje, për shumë aktivitete dhe projekte të ndryshme.

Zotëri Iljaz Leskovica shprehu gatishmërinë që të japë kontribut konform kompetencave dhe Ligjit.

Reis'ul-Ulemaja i falënderoi shumë për vizitën e bërë dhe për njoftimin rreth institucionit dhe aktiviteteve të BFI të RMV, thotë komunikata nga BFI.



MIQAIL EF. OSMANI, INSPIRIM PËR GJENERATAT E REJA

Më 16 shkurt, 2023, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu priti në Kabinetin e tij teologun e mirënjohur h. Miqail ef. Osmani, Myfti i mëparshëm i Myftinisë së Strugës dhe Imam i fshatit Ladorisht në të kaluarën, thuhet në njoftimin e BFI.

Vizitës i priti Myftiu i Strugës, mr. Salim ef. Sulejmani me bashkëpunëtorin e tij z. Shefit Hajredini.

H. Miqail ef. Osmani është një personalitet të cilin gjithmonë e ka karakterizuar urtësia, mençuria, paluhatshmëria, drejtësia dhe menaxhimi i nivelit të lartë i detyrave që i janë dhënë në kohë dhe në vend.

Ai tërë jetën ia kushtoi organizimit të jetës fetare islame, shpjegimit të vlerave të tij dhe, në të njëjtën kohë, dha kontribut edhe në shërbim të kauzës kombëtare, duke mishëruar fetaren me kombëtarin, i gatshëm që të rreshtohet në çdo moment aty ku e kërkon feja dhe kombi.

Andaj, lirisht mund të konstatojmë se personaliteti i z. Miqail ef. Osmani, me shërbimet në veprat madhore, është dhe



ngel inspirim i gjallë për kohën dhe gjeneratat e reja.

Reis'ul-Ulemaja, në shenjë respekti për veprimtarinë e zhvilluar, h. Miqail ef. Osmanin e dekoroi me dekoratën e BFI të RMV, në shenjë respekti dhe mirënjohjeje, duke i dëshiruar shëndet, jetë të gjatë dhe suksese të reja.

Njëherësh, ai falënderoi Myftiun mr.

Salim ef. Sulejmani për organizimin e kësaj vizite dhe për punën që bën si Myfti i Myftinisë së Strugës, të cilën e udhëheq në mënyrë dinjitoze.

Në shoqëri të Myftiut Sulejmani ishte edhe z. Eglon Murtezai, një student i mirëfilltë i FSHI dhe e ardhmja e BFI dhe e Myftinisë. Zoti i bekoftë me të mirat e Tij, thuhet në njoftimin e BFI.

TAKIM ME KOMANDANTIN POLICOR TË GALLATËS



Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu priti në Kabinetin e tij Komandantin e rajonit të Policisë në Gallatë, komuna e Vrapçishtit, z. Ekrem Bajrami, thuhet në njoftimin e BFI.

Mysafiri shoqërohej nga bashkëpunë-

torët z. Xhevahir Demiri dhe z. Nasuf Iljazi.

Kryetari i BFI të RMV i falënderoi shumë mysafirët për dëshirën e tyre që të vizitohet Bashkësinë Fetare Islame, Rijasetin e saj, për të njoftuar punën e madhe

që bëjnë në mirëmbajtjen e rendit dhe të qetësisë publike, në veçanti në mbrojtjen e xhamive në rastet kur kjo ka qenë e nevojshme, thuhet në njoftimin e BFI. (27.01.2023)

KRYETARI I BFI-së PRITI DY GAZETARËT E MIRËNJOHUR



Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu më 6 shkurt, 2023, priti gazetarët dhe opinionistët e mirënjohur, udhëheqës programesh politike në televizione të famshme, drejtues në Institutin Balkanik për Bashkëpunim Rajonal (BIRN) me seli në Tetovë, z. Seladin Xhezairi dhe z. Xhelal Neziri, thuhet në njoftimin e BFI.

Si personalitete me famë dhe me

përvojë mediale, me ta u bisedua për shumë çështje aktuale të rrjedhave të kohës në sfera të ndryshme, në veçanti për rolin dhe rëndësinë e mjeteve të informimit në ngritjen e vetëdijes në kultivimin e vlerave fetare, morale, shpirtërore, kulturore, etj.

Njëherësh, u bisedua edhe për një bashkëpunim të mirëfilltë në sferat e aktiviteteve të nduarnduarta. Në të njëjtën

kohë, bashkërisht shprehën pikëllimin dhe dhimbjen për viktimat dhe dëmet që u shkaktuan me rastin e tërmetit të trishtueshëm që kaploi popullin turk dhe sirian.

Me këtë rast, Reis'ul-Ulemaja u shprehu mysafirëve falënderime të thella për këtë vizitë të rëndësishme dhe me vlerë, thuhet në njoftimin e BFI.

MYFTINIA E KUMANOVËS ME SEKRETAR TË RI

Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti më 1 shkurt, 2023, Myftiun e Kumanovës h. Abedin ef. Imeri me bashkëpunëtorët e tij të ngushtë h. Enver ef. Zeqiri dhe Umej ef. Fejzuli, thuhet në njoftimin e BFI.

Me Myftiun u bisedua rreth punëve të Myftinisë, për projektet e saj dhe për aktivitetet e BFI në përgjithësi.

Me këtë rast, Reis'ul-Ulemaja u njoftua me nëpunësin e ri - Sekretarin e Myftinisë së Kumanovës, z. Umej ef. Fejzuli, të cilit i uroi detyrën e re të Sekretarit të Myftinisë. Njëherësh, punonjësit të ri i dëshiroi shëndet dhe suksese në punë. Urime për nëpunësin e ri pati edhe për Myftiun, h. Abedin ef. Imeri, thuhet në njoftimin e BFI.



FILLOI NDËRTIMI I XHAMISË NË BANJICË



Më 13 shkurt, 2023, në fshatin Banjicë, komuna e Çashkës (Veles), filloi ndërtimi i xhamisë, thuhet në njoftimin e BFI.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast mori pjesë dhe Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga Drejtori i Mërgatës dr. Selver Xhemaili dhe Drejtori i Vakëfit z. Driton Dikena.

Ndërtimi i xhamisë së parë në këtë vendbanim ka shkuar në koordinim me Myftininë e Velesit, përkatësisht me Myftiun z. Nejaz ef. Murati.

Banjica është një fshat i vogël, me 16 familje.

Pjesëmarrës në vënien e gurit të themelit ishin Kryetari i Komunës së Ça-

shkës, z. Goran Stojanovski, z. Enver Bejluri, Mustafa dhe Rexhep Beqiri, z. Xhafer Xhaferi-Kryetar i Këshillit iniciativ dhe anëtarët e Këshillit, imamë të territorit të Myftinisë, xhematlinj të fshatit e më gjerë.

Manifestim filloi me lexim të Kuranit famëlartë nga Mustafa ef. Beqiri, Imam në Jabollçisht të Epërm. Më pas tubimit iu drejtua z. Nejaz ef. Murati, i cili përshëndeti Reis'ul-Ulemanë dhe të pranishmit dhe foli mbi qëllimin dhe vlerën e ndërtimit të Xhamisë.

Z. Enver Bejluri mbajti fjalë përshëndetëse në emër të Komunës, ku ftoi të pranishmit për unitet në ndërtimin e Xhamisë.

Në fund, fjalën e rastit e mbajti Rei-

s'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i cili foli për vlerën e xhamisë si vatër e besimit, e dijës, moralit, paqes, tolerancës, solidaritetit, bashkëjetesës, mirëkuptimit dhe adhurimit. Njëherësh, mirënjohje të veçantë i shprehu Kryetarit të Komunës për kontributin e dhënë në nxjerrjen e lejes për ndërtim. Pastaj falënderoi Kryetarin e Këshillit iniciativ, z. Xhafer Xhaferri dhe bashkëpunëtorët e tij. Në veçanti, i shprehu falënderime të thella donatorit të madh z. Samet Beqiri, i cili bleu tokën dhe ia fali fshatit për vendin e ndërtimit të Xhamisë. Në fund, pas leximit të Kuranit famëlartë nga Rexhep Beqiri, duanë e bëri dr. Selver Xhemaili, thuhet në njoftimin e BFI.

HATME NË JABOLLÇISHT TË EPËRM



Më 10 shkurt, 2023, tridhjetë nxënëse e nxënës të Jabollçishtit të Epërm kanë përfunduar mësimbesimin dhe për ta Myftinia e Velesit bëri hatme, thuhet në njoftimin e BFI.

Me ftesë të Myftiut të Myftinisë së BFI-Veles, z. Nejaz ef. Murati dhe të z. Mustafë Beqiri, Imam në Jabollçisht të Epërm, në solemnitetin e organizuar me këtë rast morën pjesë Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët dr. Abdulkërim Iseni dhe z. Musanif Rufati.

Ishte një program i mrekullueshëm dhe i përgatitur në mënyrë profesionale, që la mbresa të mëdha te të pranishmit.

Me një prezencë masive besimtarësh, së pari të pranishmit i përshëndeti Imami i Xhamisë, Mustafë ef. Beqiri, duke dëshiruar mirëseardhje, ndërsa më pas fjalë përshëndetëse mbajti Myftiu Nejaz ef. Murati, i cili përshëndeti Reis'ul-Ulemanë dhe të pranishmit, duke u dëshiruar mirëseardhje dhe suksese në jetë.

Fjalë rasti mbajti Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i cili falënderoi për ftesën dhe pritjen dhe në mes tjerash foli për vlerën e mësimbesimit islam dhe realizimin e tij.

Në fund u ndanë diploma për nxënësit dhe mirënjohje për Imamin e Xhamisë dhe Myftiun Nejaz ef. Murati.

Duanë e hatmeve e bëri z. Musanif ef. Rufati, Drejtor i Sektorit për Kulturë në Rijasetin e BFI.

Ishte kënaqësi të vizitosh Jabollçishtin e Epërm dhe të Poshtëm - fshatra këta të njohur në territorin e Velesit, thuhet në njoftimin e BFI.

Mbi 17 minuta ka qenë transmetimi i drejtpërdrejtë, në kohë reale, i hatmes së organizuar nga Myftinia e Velesit në Jabollçisht të Epërm në platformat elektronike të Bashkësisë Fetare Islame të RMV. Të njëjtën ditë, përmes tyre është shpërndarë edhe një video-incizim në kohëzgjatje prej 3:19 minutave nga manifestimi në Jabollçisht të Epërm.

REISI FALI XHUMANË NË BUZALLKOVË



Qëkur erdhi në krye të Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu premtoi se "xhamitë do të jenë zyrat e punonjësve të BFI të RMV", thuhet në njoftimin e BFI.

Në këtë kontekst, ai bashkë me punonjësit e BFI vazhdimisht është në vizita nëpër të gjitha xhamitë e vendit.

Më 10 shkurt, 2023, Reis'ul-Ulema vizitoi Xhaminë e Buzallkovës në shoqërim të Myftiut të Velesit, h. Nijazi

ef. Murati dhe të bashkëpunëtorëve të tij. Aty, bashkë me xhematin e kësaj xhamie, falën namazin e xhomasë. Më pas Kryetari i BFI të RMV vizitoi edhe Myftininë e BFI-Veles.

ME BESIMTARËT BOSHNJAKË TË ORIZARES



Më 10 shkurt, 2023, në kuadër të programit në Jabollçisht të Epërm, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu vizitoi fshatin fqinj boshnjak Orizare, ku edhe e fali namazin e jacisë, thuhet në njoftimin e BFI.

Në fshat u prit në mënyrë vëllazërore nga ish-nxënësi i tij dhe aktualisht Krye-

tar i Këshillit të Xhamisë, z. Zenun Daciç dhe nga aktivisti i mirënjohur Z. Enveri.

Qëllimi i vizitës ishte takimi me këshillin iniciativ për ndërtimin e xhamisë së re, e cila edhe mbas shumë vitesh po ballafaqohet me pengesa në marrjen e lejes. Këshilli iniciativ e informoi Reis'ul-Ulemanë me problemet me të cilat

ballafaqohen, ndërsa Reis'ul-Ulema mori obligime konkrete për tejkalimin e pengesave dhe marrjen sa më të shpejtë të lejes.

Pastaj u bë një ndejë e qetë në konak, ku u bisedua edhe për shumë çështje të tjera me rëndësi, thuhet në njoftimin e BFI.

XHAMIA HËNA E RE SHËNOI 30-VJETORIN



Më 28 janar, 2023, xhamia "Hëna e Re" në Kreuzlingen - Zvicër shënoi 30-vjetorin e themelimit, thuhet në njoftimin e BFI.

Në prani të një numri të madh besimtarësh, u prezantua një program i begatë me lexim të pjesëve nga Kurani fisnik, me këndim ilahish dhe kasidesh, krahas pjesëve artistike. Një pikë e veçantë, pa dyshim, ishte paraqitja e Korit të nxënëseve të xhamisë "Hëna e Re".

Në pika të shkurtra, u prezantua ecuria e kësaj xhamie nga themelimi deri më sot.

Në këtë manifestim merrnin pjesë autoritete të ndryshme të institucioneve të qytetit të Kreuzlingenit, imamë dhe veprimtarë nga Zvicra e nga rajoni, Drejtori i Sektorit për Çështje të Mërgatës në BIK mr. Ekrem Simnica, mysafirë nga vendlindja etj. BFI-në e RMV-së e përfaqësoi dr. Selver Xhemaili, i cili i përshëndeti të pranishmit duke përcjellë urimet e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Dr. Selver Xhemaili mes tjerash tha: "Kam nderin që në emër të Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht në emër të Kryetarit të saj, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në emër të gjithë besimtarëve myslimanë të RMV-së, si dhe në emrin tim personal, t'ju përshëndes me përshëndetjen islame: Es-selamu

alejku ve rahmetullahi ve berekatuhu/ Gjithnjë paqja dhe begatitë e Allahut Madhëriplotë qofshin me ju.

Pa dyshim që Xhamia është një vatrë që shpirtërisht na bashkon, na afron, na pajton, madje edhe na ushqen shpirtin dhe zemrën tonë. Ndërsa me çka është e mbushur zemra, ajo derdhet dhe shfaqet në të folur, në art, në lëvizje dhe veprim.

Është bukuri e veçantë kur mësimi i xhamisë reflektohet kudo në jetën e përditshme. Xhamia është vendi ku adhurimi i kushtohet vetëm Allahut Madhëriplotë, është vendi i paqes, i dashurisë, i mirëkuptimit dhe respektit të ndërsjellë. Andaj, kur ne shënojmë një përvjetor të këtillë, do të thotë përkujtojmë një histori të bujshme të aktiviteteve të shumëllojshme të Shtëpisë së Zotit.

Nëpërmjet kulturës së përfituar nga edukimi në xhami, besimtarët edhe më tej vazhdojnë të ngrenë lart ndërgjegjshmërinë dhe vetëdijen e përgjegjësisë. Adhurimi, që është kryefjala e xhamisë, është një thesar që ndërton dhe forcon lidhjen tonë me Allahun (xh. sh.), ndërsa mirësjellja, vepërmirësia që është fryt i ibadetit/adhurimit, është një thesar që ndërton lidhjet tona me njerëzit dhe me krijesat e tjera.

Pa dyshim që për këtë histori suksesesh të kësaj qendre, për të gjitha këto punë të mëdha, ka shumë njerëz e shumë faktorë që janë meritore. E gjithë kjo është

vështirë të realizohet pa pasur një promotor që do t'i udhëheqë këto punë të mbara. Në rastin konkret, është veprimtari i shquar, miku ynë, i nderuari mr. Rejhan ef. Neziri, të cilit në emër të BFI-së dhe në emrin tim personal i shprehim mirënjohjet tona më të thella dhe i dëshirojmë jetë të gjatë e shëndet, që edhe më tej shoqërisë sonë besimtare t'i sjellë suksese e beqet. Gjithashtu, falënderojmë edhe anëtarët Këshillit të Xhamisë, të cilët japin një kontribut të çmueshëm në mbarëvajtjen e jetës fetare. Në mënyrë të veçantë shprehim falënderimet dhe mirënjohjet tona për autoritetet e shtetit zviceran për këto mundësi të ofruara ndaj besimtarëve myslimanë dhe shqiptarëve në përgjithësi.

Vëllezër të dashur, dhëntë Zoti që xhamia "Hëna e Re" në Kreuzlingen, si dhe të gjitha xhamitë tjera kudo që janë, të vazhdojnë t'i kultivojnë vlerat dhe urtësitë islame në mënyrën më të denjë, më të kulturuar, duke mbjellë paqe, mirëkuptim dhe tolerancë në mesin e besimtarëve myslimanë, si dhe në mesin e njerëzve në përgjithësi.

Gjithnjë qofshi në shërbim të paqes, të mirësisë dhe të respektit ndaj krijesave për hir të Krijuesit. Zoti i bekoftë xhamitë dhe xhematet tona. Ve selamu alejkum ve rahmetullahi ve berekatuhu, ka thënë dr. Selver Xhemaili, Drejtor i Sektorit për Çështje të Mërgatës në BFI të RMV.

Në raportin që ka publikuar portali

pointegra.ch (Rexhep Rifati etj.) thuhet: "Në sallën e madhe të Qendrës Draispitz të qytetit të Kreuzlingenit në Zvicër, të stolisur me flamuj shqiptarë e zviceranë, xhamia shqiptare 'Hëna e Re' shënoi 30-vjetorin e themelimit, në prani të mysafirëve të shumtë, përfaqësues të institucioneve fetare e drejtuese të vetë këtij qyteti e më gjerë, të prirë nga Krye-

tari i Komunës së Kreuzlingenit, z. Thomas Niederberger.

Me këtë rast Imami Rejhan Neziri, në cilësinë e nikoqirit, tha se angazhohet që 'Islami të mos shihet këtu si një trup i huaj, porse si një element dhe faktor i fuqishëm në ngritjen dhe zhvillimin e jetës së përbashkët me të gjithë në këtë shtet liberal e demokratik'.

Kryetari i Komunës së Kreuzlingenit, Thomas Niederberger dhe përfaqësuesit e Tryezës së Rrumbullakët të Feve në Kreuzlingen, të Kishës së Reformuar Evangjeliste e të Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër, vlerësuan lart rolin e Imamit dhe të kësaj xhamie - pos si mision fetar, edhe si institucion integruar bashkëpunues me mjedisin ku vepron."



Imazhe nga tribuna enkas për gjininë femërore në Xhaminë e Bardhë, Aarburg. Këto imazhe flasin për interesimin e jashtëzakonshëm të femrës shqiptare në Zvicër dhe çdo koment tjetër është i tepërt. - Falënderim i veçantë për teologët e nderuar; falënderim për Sektorin e femrës shqiptare në kuadër të Xhamisë së Bardhë, Aarburg; falënderim për të gjitha motrat që kontribuojnë në kontinuitet. Allahu jua shpërbleftë! (Nga Nehat Ismaili/23.01.2023/në bashkëpunim)

VIZITË XHAMISË SË FLAWILIT

Drejtori i Sektorit për Çështje të Mërgatës në BFI, dr. Selver Xhemaili, më 29 janar, 2023, vizitoi Xhaminë e Flawilit, Zvicër, thuhet në njoftimin e BFI.

Me këtë rast, ai përshëndeti të pranishmit dhe çmoi lart mënyrën e organizimit të besimtarëve në mërgim.

Gjithashtu, përcolli edhe përshëndetjet e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, duke u falënderuar për bashkëpunimin institucional. Në të njëjtën kohë, Xhamisë së Flawilit i dëshiroi suksese në vazhdimësi, thuhet në njoftimin e BFI.

"New York Times" ka shkruar një artikull pas hapjes së Xhamisë Shqiptare në Nju-Jork, SHBA. Xhamia është përruar më 12 nëntor 1972, në Brooklyn, New York. Në foto: Salih efendiu, Myfti nga Shkodra; duke bërë duanë në fotografi janë: Haxhi Koçi nga Dibra, Muslim Mulosmani nga Malësia e Gjakovës, Halit Demlush nga Gjakova. (Nga Mexhid Vvejsi/1950-2021. Shpërndarë në Facebook më 22.01.2023 nga Duka Erjon/në bashkëpunim)

EDUKIMI FETAR TE FËMIJËT

Prindërit duhet të krijojnë lidhjen mes fëmijëve të tyre dhe Allahut në kuadrin e dashurisë. Fëmija duhet ta dojë Allahun dhe të besojë se edhe Allahu e do atë. Kështu që, fëmija do t'i besojë Atij dhe do të strehohet tek Ai kur të jetë e nevojshme. Nëse po, fëmija duhet ta njohë Zotin si një qenie falëse.



Shkruan: Besim Barbullushi
(Enkas për Her)

Ndjenja e fesë është një ndjenjë e lindur, që është midis ndjenjave sublimë dhe gjenetike.ⁱ Kjo do të thotë se këto ndjenja janë të përbashkëta dhe janë pjesë e natyrshmërisë për të gjithë njerëzit, pa dallim race apo besimi.ⁱⁱ Njeriu është krijuar natyrshëm, i aftë për të besuar në Zot dhe i përshtatshëm për të pranuar besimin fetar.ⁱⁱⁱ Ky përfundim është arritur nga shumë të dhëna e kërkime psikologjike dhe pedagogjike.^{iv} Përveç kësaj, hulumtimi në veçanti mbi psikologjinë e fëmijëve ka zbuluar se fëmija nuk është i huaj me fenë shpirtërisht.^v

Megjithatë, mjedisi është një faktor kryesor në formimin dhe zhvillimin e ndjenjës fetare, që është potencialisht e pranishme te fëmija që nga lindja. Karakteristikat e mjedisit ku jeton fëmija janë aspekti kryesor për ndikimin e ndjenjës fetare në moshë të hershme apo

të vonë.^{vi}

ZGJIMI I NDJENJËS FETARE

Në përgjithësi, zgjimi i ndjenjës fetare te fëmijët që rriten në një mjedis fetar ndodh në moshë më të hershme.

Faza e foshnjërisë është një periudhë në të cilën nuk ka shenja të dukshme të fesë dhe manifestimet fetare nuk hasen shpesh. Mund të themi se zhvillimi fetar në foshnjëri është i kufizuar në emocione. Bazat si feja, besimi, dashuria, lidhja me Krijuesin, janë ndjenja që ngrihen mbi emocione universale, që mbartin përmbajtjen e arritjes së një mendimi që ka një Krijues.^{vii}

Kërkimet shkencore mbi lindjen dhe zhvillimin e ndjenjës dhe besimit fetar tregojnë se fëmija është i prirur dhe se është gati shpirtërisht e i aftë për ndikime dhe përvoja të jashtme fetare.^{viii} Në këtë fazë, fëmija mund të thotë konceptet fetare që i mësohen me fjali në një ose dy fjalë. Megjithatë, këto koncepte mund të mos kenë shumë kuptim për fëmijën.^{ix}

Në fazën e hershme të fëmijërisë manifestimet fetare bëhen më të theksuara. Fëmija me ose pa vetëdije imiton dhe përsërit të gjitha llojet e lëvizjeve të atyre që e rrethojnë. Ai u drejtohet lutjeve dhe sjelljeve të motivuara nga feja që sheh te familjarët e tij me ndjenja të sinqerta dhe dëshiron të praktikojë të njëjtat sjellje duke marrë shembuj nga jeta e tyre fetare. Kjo prirje, e cila e merr burimin nga psikologjia e imitimit të personit të dashur, është shumë e rëndësishme në formimin e jetës fetare të fëmijës.^x Të gjitha llojet e sjelljeve fetare të anëtarëve të familjes, fjalët fetare që përdorin dhe lutjet që bëjnë lënë gjurmë të thella në personalitetin e fëmijës.^{xi}

Mendërisht, fëmija pranon pikërisht atë që i paraqitet, pasi ende nuk e ka arritur cilësinë e kritikës. Ai prirë të besojë gjithçka që i thuhet dhe i tregohet. Fëmija në këtë fazë bën pyetje të ndryshme rreth koncepteve fetare dhe përgjigjeve që merr u beson pa menduar, pa dyshim apo pa kundërshtuar. Kjo është për shkak të

veçorisë së besueshmërisë së lehtë të fëmijës.

Tipari më dallues i fesë që shihet te fëmijët në këtë moshë është të besosh pothuajse gjithçka që thuhet. Gjatë kësaj periudhe fëmija nuk kërkon arsyen e besimit të tij. Emocionet e fëmijës janë më të zakonshme dhe më specifike se mendimet e tyre. Në këtë drejtim, fëmija pranon besimin pa arsytim. Fëmija, i cili është i gatshëm të besojë, i beson sinqerisht ato që thuhet pa u menduar, pa dyshuar dhe kundërshtuar dhe përipiqet të hyjë në jetën fetare me pyetje të ndryshme.

Në këtë fazë fëmija bën një sërë pyetjesh në çështjet fetare, si dhe në të gjitha aspektet e tjera. Ai përipiqet të fitojë njohuri duke bërë pyetje rreth koncepteve fetare si Allahu, engjëlli, xhindët, shejtani, jeta e përtejme, namazi, agjërimi, mëkati, shpërblimi, parajsa dhe ferri.^{xii}

Në këtë rast, është detyrë e të rriturve dhe edukatorëve t'u përgjigjen pyetjeve që bëjnë për të kënaqur urinë e tyre për dije në një mënyrë të përshtatshme për zhvillimin e tyre mendor dhe që ata të kuptojnë.^{xiii}

Përsëri, tipari dallues i ndjenjës fetare që shihet te fëmijët në këtë fazë është harmonia e fëmijës me një botë të mbinatyrshme. Në sferën shpirtërore të fëmijës ai shpesh e përshkruan Zotin si antropomorfik, domethënë me cilësi njerëzore dhe e përfytyron Zotin në formën e një njeriu.^{xiv} Për këtë, fëmija në këtë fazë nuk ka asnjë vështirësi në perceptimin e Zotit.

NË PERIUdhËN KONKRETE TË TË MENDUARIT

Duke e imagjinuar Zotin si një qenie njerëzore të madhe^{xv}, ai e mendon këtë në linja njerëzore. Sepse, fëmija është në periudhën konkrete të të menduarit në këtë fazë. Meqenëse aftësia për të kuptuar konceptet abstrakte nuk është e zhvilluar, ajo mishëron abstraktin, duke kaluar nga niveli konkret i të menduarit, në nivelin e të menduarit abstrakt në të ardhmen, kur fëmija fiton një kuptim transcendent të Zotit.^{xvi}

Në fazën e fundit të fëmijërisë mjedisi i fëmijës zgjerohet, konceptet që më parë ishin të pakuptueshme, gradualisht fillojnë të bëhen të qarta.^{xvii} Një kuptim i ndërgjegjshëm dhe real i fesë fillon të formohet te fëmija në këtë fazë. Sidomos mosha 7-9 vjeç është një periudhë kur zgjohet dhe zhvillohet besimi fetar. Paralelisht me zhvillimin mendor dhe shpirtëror të fëmijës, ka zhvillime edhe në interesin e tij për fenë. Ndërsa fëmija zhvillon aftësinë e tij konceptuale të të

menduarit, ndryshon edhe mënyra e parë egocentrike e të menduarit.^{xviii}

Ky mendim antropomorfik te fëmija, i cili mendon për Allahun në modele dhe linja njerëzore në fazën e parë të fëmijërisë, gradualisht ia lë vendin një kuptimi simbolik dhe abstrakt në këtë periudhë.^{xix} Sepse, duke filluar nga mesi i fazës së fundit të fëmijërisë, ka një kalim nga faza konkrete e të menduarit, në konceptet dhe lëndët deri diku më fleksibël dhe madje abstrakte. Në fund të kësaj periudhe, ndërsa përfundon faza konkrete e të menduarit, fillon faza e të menduarit abstrakt.^{xx}

Në fazën e fundit të fëmijërisë fëmija fillon të kuptojë dhe të mësojë më lehtë disa nga çështjet e fesë dhe të vlerësojë çështjet morale sipas vetes. Përveç kësaj, mendimet që zhvillohen paralelisht me zhvillimin mendor të fëmijëve në këtë periudhë bëhen kritike dhe pyetëse. Ata pranojnë ose refuzojnë sjelljet që marrin dhe imitojnë pa dyshim dhe kundërshtime në periudhën e parë të fëmijërisë, pasi kanë kaluar nëpër një filtër mendor në periudhën e fundit të fëmijërisë. Në këtë fazë, faktori më i rëndësishëm që ndikon në zhvillimin fetar të fëmijës është familja. Veçanërisht qëndrimet dhe sjelljet fetare të anëtarëve të familjes ndikojnë jashtëzakonisht te fëmija.

Megjithatë, ndërsa mjedisi i fëmijës zgjerohet, lidhja e tij me prindërit zvogëlohet. Fëmija, i cili i merr prindërit si model dhe i imiton ata para se të fillojë shkollën, fillon të marrë shembull mësuës dhe të pas fillimit të shkollës. Ai e pranon atë si autoritet dhe përipiqet të përputhet me atë që thotë. Për këtë arsye, sjellja dhe fjalët e mësuës për fenë janë shumë të rëndësishme për zhvillimin fetar të fëmijës.^{xxi} Përveç kësaj, informacioni që ka marrë nga librat që ka lexuar dhe zhvillimi i tij mendor kontribuojnë në formimin e ndërgjegjes së tij fetare.^{xxii} Zgjimi dhe zhvillimi i ndërgjegjes që ek-

ziston te fëmija si talent është ndoshta një çështje thjesht edukative.^{xxiii}

Në fazën e fundit të fëmijërisë interesi për praktikën fetare, që zhvillohet paralelisht me ndjenjën e përgjegjësisë, mund të shndërrohet në praktika fetare në raport me njohuritë fetare të fëmijës.^{xxiv} Duke bërë përpjekje për të përmbushur praktikën fetare, fëmija mund të tregojë interes për agjërimin në Ramazan, për namazin e xhumasë, të taravive dhe Bajramit.

Nëse do flasim për edukimin fetar, fëmijëria është faza e përgatitjes për edukimin fetar dhe faza e ndikimit të pavetëdijshëm për periudhën e foshnjërisë.^{xxv} Në këtë fazë, veprimtaritë e edukimit fetar mund të fillojnë me disa aktivitete.^{xxvi}

Motoja e parë e Islamit mund të futet te fëmija duke iu lexuar ezanin në veshin e tij menjëherë pas lindjes. Me këtë veprim fillon trajnimi i besimit në Allah. Një nga gjërat e para që duhet bërë është t'i vendosni fëmijës një emër të bukur dhe me kuptim të mirë. Aqsa, për shkak të emrit të fëmijës, është e nevojshme të shmangen emrat që do të shkaktojnë tallje dhe argëtim dhe që mund të shprehin shëmti dhe vrazhdësi. Të thirrurit me emra të tillë mund të dëmtojnë personalitetin e fëmijës, ose të shkaktojnë konflikte të brendshme.^{xxvii}

Thënia e fjalëve të tilla si "mashallah, Allahu të faltë, Allahu të dashhtë", në të cilat përmenden fjalët e Allahut dhe dëgjimi i vazhdueshëm i këtyre fjalëve, mund të jetë i dobishëm në aspektin e edukimit fetar.^{xxviii} Në këtë fazë, fëmijët mund të ndikohen nga të gjitha llojet e koncepteve fetare,^{xxix} të përdorura nga prindërit e tyre dhe në fund të kësaj faze ata mund të thonë një ose dy fjalë fetare që u mësohen.

Veç kësaj, në aspektin e edukimit fetar bien në sy ninullat që këndon nëna duke e vënë në gjumë fëmijën. Ninullat



dhe fjalitë me motive fetare mund të kenë rezultate pozitive në aspektin e edukimit fetar në të ardhmen e fëmijës.^{xxx}

Faza e parë e fëmijërisë është faza e njohjes me fenë dhe edukimin fetar. Ndërsa fëmija interesohet për besimet fetare dhe sjelljet fetare që në moshën trevjeçare, besimi fetar fillon të fitojë vitalitet. Në mendjen e fëmijës formohet një vizion i Zotit, të cilin ai e identifikon me attribute të forta dhe të mëdha dhe të cilin ai e mishëron me njerëzit përreth tij që i mbajnë këto attribute.^{xxxi}

QENIE QË DUHET TË STREHOHET

Është e qartë se nëse fëmijës i thuhet për besimin në Allahun siç duhet, ai gjithashtu do të përgjigjet pozitivisht. Megjithatë, kjo përgjigje mund të mos jetë e mjaftueshme. Sepse të kuptuarit dhe perceptimi i fëmijës në fëmijërinë e parë nuk mund të përmbushë konceptet abstrakte si *Allahu, besimi dhe imani*.^{xxxii} Në këtë pikë, detyra e edukatorit është që ta prezantojë fëmijën me Zotin si një qenie që duhet të strehohet.

Prandaj, prindërit duhet të krijojnë lidhjen mes fëmijëve të tyre dhe Allahut në kuadrin e dashurisë. Fëmija duhet ta dojë Allahun dhe të besojë se edhe Allahu e do atë.^{xxxiii} Kështu që, fëmija do t'i besojë Atij dhe do të strehohet tek Ai kur të jetë e nevojshme. Nëse po, fëmija duhet ta njohë Zotin si një qenie falëse.

Gabimi më i madh që mund të bëhet në njohjen e Allahut nga fëmija është ta prezantosh Allahun se duhet pasur vazhdimisht frikë. Edhe pse duket si një mënyrë e lehtë dhe e shpejtë për prindërit që të zbulojnë Allahun si ndëshkues të sjelljes së gabuar të fëmijës, ky qëndrim mund të çojë në formimin e një mendimi shumë negativ për Allahun në mendjen e fëmijës.^{xxxiv} Përveç kësaj, fëmijës në fazën e parë të fëmijërisë mund t'i mësohen emrat dhe cilësitë e tij të bukura në lidhje me besimin në Allahun në përputhje me besimin islam.^{xxxv} Njohja e Allahut nga fëmija me emrat dhe cilësitë e tij të imazh të Allahut të bazuar në dashuri.

Përsëri, faza e parë e fëmijërisë duhet parë si një fazë përgatitore për besimin në Allah.^{xxxvi} Disa fjalë duhet t'i mësohen fëmijës me fjalë të thjeshta dhe fëmija nuk duhet të detyrohet në aktivitetet fetare. Fëmija duhet të njihet me aktivitetet fetare duke ia lehtësuar, në një mënyrë të lojës. Edukimi modern i kushton shumë rëndësi rolit të lojës në nxënie. Pa dyshim, interesimi i parë i fëmijës për lutjen mund të shfaqet në formën e lojës. Situata të tilla si kërcimi në shpinë gjatë namazit ose

shtrirja anash në sexhde, kalërimi në shpinë mund të konsiderohen si tregues se fëmija ka zhvilluar një zonë të interesit. Pejgamberi ynë, Muhamedi (s.a.v.s.), e prantikonte shumë shpesh këtë mënyrë. Ai u afrohej fëmijëve që hipnin në shpinë apo edhe në kokë gjatë namazit me tolerancë, e zgjaste sexhden për të mos i mërzhitur ata dhe i lejonte të luanin me të gjatë namazit.^{xxxvii}

Përveç kësaj, fëmijës në këtë fazë mund t'i mësohen disa fjalë dhe melodi fetare dhe mund të luhen lojëra fetare. Sérish, në këtë fazë, një mënyrë tjetër e edukimit fetar është përfitimi nga anekdotat, tregimet dhe përrallat.^{xxxviii} Prania e motiveve fetare në përrallat që i tregohen fëmijës, mund të sjellë rezultate të frytshme në aspektin e edukimit fetar. Mund të përfitonin nga filmat vizatimorë dhe filma për fëmijë me vlera fetare dhe kombëtare. Përveç kësaj, prania e motiveve fetare në lojërat dhe lodrat e fëmijës, prania e objekteve fetare dhe pikturave në shtëpi, tingulli i ezanit në shtëpi, mund të jenë aspekte të dobishme në edukimin fetar.^{xxxix} Mund të mësohen edhe lutjet që do ta drejtojnë fëmijën tek Allahu dhe do t'i mundësojnë fëmijës të komunikojë me Krijuesin e tij.

Mirëpo, fëmija i cili i drejtohet Allahut dhe bën kërkesa gjatë faljes së namazit duhet të paralajmërohet për të bërë kërkesa të arsyeshme dhe veçanërisht fëmija duhet të ndërgjegjësohet për kërkesat që nuk mund të realizohen.^{xl} /Kryhet në numrin tjetër/

(Autori është Imam në Myftininë e Shkodrës-Komuniteti Mysliman i Shqipërisë)

ⁱ Nurettin Topçu, *Değerler Psikolojisi*, Stamboll, 1959, fq. 52, 81.

ⁱⁱ Muhammed Kutup, *İnsan Psikolojisi Üzerine Etütler*, çev. Bekir Karlığa, Stamboll, 1987, fq. 289-290; Hayati Hökelekli, *Din Psikolojisi*, Ankara, 1993, fq. 124-125.

ⁱⁱⁱ Mehmet Emin Ay, *Çocuk ve Din Eğitimi*, Yeni Dünya Dergisi, Y. I, S.2, Nëntor 1993, fq. 71.

^{iv} Antoine Vergote, *Çocukta Din*, Çev. Erdoğan Fırat, Ankara Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi, C.XXII, 1978, fq. 315.

^v Pierre Bovet, *Din Duygusu ve Çocuk Psikolojisi*, Çev. S. Odabaş, Ankara, 1958, fq. 18-19.

^{vi} Kerim Yavuz, *Çocukta Dini Duygu ve Düşüncenin Gelişmesi*, Ankara, 1987, fq. 44.

^{vii} Yurdagül Mehmetoğlu, *Erken Çocuklukta Din ve Ahlak Gelişimi*, Stamboll, 2003, fq. 350

^{viii} Hüseyin Peker, *Din Psikolojisi*, Samsun, 1993, fq. 102.

^{ix} Paul Guillaume, *Ruhbilim*, Çev. Refia Şemin, Stamboll, 1945, fq. 271.

^x Neda Armaner, *Din Psikolojisine Giriş I*, Ankara, 1980, fq. 83.

^{xi} Hüseyin Peker, *Din Psikolojisi*, Samsun, 1993, fq. 103.

^{xii} Hayati Hökelekli, *Din Psikolojisi*, Ankara, 1993, fq. 254-256.

^{xiii} Mualla Selçuk, *Çocuğun Eğitiminde Dini Motifler*, Ankara, 1991, fq. 76, 85.

^{xiv} Antoine Vergote, *Çocukta Din*, Çev. Erdoğan Fırat, Ankara Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi, C.XXII, 1978, fq. 320; Yurdagül Konuk, *Okul Öncesi Çocuklarda Dini Duygunun Gelişimi ve Eğitimi*, Ankara, 1994, fq. 43; M. Emin Ay, *Çocuklarımızı Allah'ı Nasıl Anlatalım*, Stamboll, 1995, fq.74-75.

^{xv} Neda Armaner, *Din Psikolojisine Giriş I*, Ankara, 1980, fq. 84; Yurdagül Konuk, *Okul Öncesi Çocuklarda Dini Duygunun Gelişimi ve Eğitimi*, Ankara, 1994, fq. 18.

^{xvi} Beyza Bilgin, *Eğitim Bilimi ve Din Eğitimi*, Ankara, 1995, fq. 122-123; Mustafa Öcal, *Din Eğitimi ve Öğretiminde Metotları*, Ankara, 1991, fq. 72-73.

^{xvii} Kerim Yavuz, *Çocuğun Dünyası ve Gelişimi*, Stamboll, 1992, fq. 23.

^{xviii} Arthur T. Jersild, *Çocuk Psikolojisi*, çev. Gülseren Günce, Ankara, 1979, fq. 91.

^{xix} Neda Armaner, *Din Psikolojisine Giriş I*, Ankara, 1980, fq. 86-87.

^{xx} Betül Aydın, *Gelişimin Doğası, Gelişim ve Öğrenme Psikolojisi*, Editör Binnur Yeşilyaprak, Ankara, 2002, fq. 40; Habil Şentürk, *Çocukta Din Gelişim Psikolojisi*, Yeni Ümit Dergisi, Y.8, S.30, tetor-dhjetor, 1996, fq. 21.

^{xxi} Hüseyin Peker, *Din Psikolojisi*, Samsun, 1993, fq. 104.

^{xxii} Hüseyin Peker, *Din Psikolojisi*, Samsun, 1993, fq. 105.

^{xxiii} Hans Zulliger, *Çocuk Vicdanı ve Biz*, çev. Kamuran Şipal, Stamboll, 1996, fq. 17.

^{xxiv} Habil Şentürk, *Din Psikolojisi*, Konja, 1997, fq. 102-103.

^{xxv} Beyza Bilgin-Mualla Selçuk, *Din Öğretimi Özel Öğretim Yöntemleri*, Ankara, 1995, fq. 66.

^{xxvi} Abdurrahman Dodurgalı, *Ailede Çocuğun Din Eğitimi*, Stamboll, 1996, fq.194.

^{xxvii} Atalay Yörükoğlu, *Çocuk Ruh Sağlığı*, Stamboll, 1991, fq. 182.

^{xxviii} Abdurrahman Dodurgalı, *Ailede Çocuğun Din Eğitimi*, Stamboll, 1996, fq. 195.

^{xxix} Beyza Bilgin-Mualla Selçuk, *Din Öğretimi Özel Öğretim Yöntemleri*, Ankara, 1995, fq. 68-69.

^{xxx} Abdurrahman Dodurgalı, *Ailede Çocuğun Din Eğitimi*, Stamboll, 1996, fq. 196.

^{xxxi} Neda Armaner, *Din Psikolojisine Giriş I*, Ankara 1980, fq. 84; Yurdagül Konuk, *Okul Öncesi Çocuklarda Dini Duygunun Gelişimi ve Eğitimi*, Ankara, 1994, fq. 18.

^{xxxii} Abdurrahman Dodurgalı, *Ailede Çocuğun Din Eğitimi*, Stamboll, 1996, fq. 218.

^{xxxiii} M.Emin Ay, *Çocuk ve Din Eğitimi*, Yeni Dünya Dergisi, Y. I, S.2, nëntor 1993, fq. 110-116.

^{xxxiv} M.Emin Ay, *Çocuk ve Din Eğitimi*, Yeni Dünya Dergisi, Y. I, S.2, nëntor 1993, fq. 107.

^{xxxv} İbrahim Canan, *Kur'an'da Çocuk*, Stamboll, 1984, fq. 95.

^{xxxvi} Abdurrahman Dodurgalı, *Ailede Çocuğun Din Eğitimi*, Stamboll, 1996, fq. 218.

^{xxxvii} Buhari, *Salat* 106; Muslim, *Mesaxhid* 42; Ahmet b. Hanbel, V,296; Nesai, *Imame*,37.

^{xxxviii} Abdurrahman Dodurgalı, *Ailede Çocuğun Din Eğitimi*, Stamboll, 1996, fq. 218.

^{xxxix} Abbas Çelik, *Din Eğitimimize Tarihsel Yaklaşım*, Erzurum, 2001, fq. 96.

^{xl} Abdurrahman Dodurgalı, *Ailede Çocuğun Din Eğitimi*, Stamboll, 1996, fq. 223.

ZANAFILLA E VEPRAVE ENCİKLOPEDIKE OSMANE

"Historianët (joosmanë) kanë regjistruar biografite e personaliteteve shkencore dhe virtytet e tyre, mirëpo askush nuk i kushtoi rëndësi që të merret me përmbledhjen e biografive të dijetarëve të këtij vendi, që realisht gjasat do të ishin të mëdha që me kalimin e kohës këto figura mbase edhe të harrohen tërësisht", ka thënë Ahmet bin Mustafa bin Halil, i njohur ndryshe si Tashqypri Zade (v. 968), autori i enciklopedisë së parë.


Shkruan: dr. Mevlud Aliu

Vepra "Eshshekaiku'numanijje fi ulemai'd-devleti' uthmanijje", e autorit Ahmet bin Mustafa bin Halil, i njohur ndryshe si Tashqypri Zade (v. 968), është enciklopedia e parë e cila përmbledh biografite e ulemave apo personaliteteve më të shquara fetare në literaturën osmane.

Përpilimin e kësaj veprë autori e arsyeton me atë se deri atëherë askush nuk i ishte përkushtuar denjësisht kësaj fushe. Pra, ekzistonte një boshllëk i madh në këtë drejtim.

Ai pasion e kishte grumbullimin e të dhënave dhe biografite e dijetarëve islamë, saqë kishte mundësi të shkruajë volume të tëra në këtë drejtim.ⁱ Ai më tej shton: "Historianët (joosmanë) kanë regjistruar biografite e personaliteteve shkencore dhe virtytet e tyre, mirëpo askush nuk i kushtoi rëndësi që të merret me përmbledhjen e biografive të dijetarëve të këtij vendi, që realisht gjasat do të ishin të mëdha që me kalimin e kohës këto figura mbase edhe të harrohen tërësisht."ⁱⁱ

Kjo veprë është shkruar në gjuhën arabe sipas metodës kronologjike, edhe atë duke filluar nga Osman Gaziu (v.



1326). Autori thekson datën e saktë të ngjitjes së tij në fron me fjalët: "Iu besua qeverisja vitin 699 H (1300)ⁱⁱⁱ, dhe më pas vazhdon me paraqitjen e biografive të personaliteteve më të shquara fetare të periudhës përkatëse.

Me këtë stil ai vazhdon deri te qeverisja e Sulejman Kanunit (1495-1566), periudhë kjo kur jetoi dhe veproi Tashqypri Zadeja.

Në këtë veprë autori regjistroi gjithsej 522 biografi të ndryshme, duke e përfunduar veprën me shënimin e biografisë së tij, edhe atë më 30 Ramazan 965 (16 korrik 1558).^{iv}

VAZHDIMËSIA E ENCİKLOPEDIKËS

Enciklopedia "Eshshekaiku'numanijje" ishte frymëzim i vërtetë dhe pikënisje për studiuesit e rinj të asaj kohe.

Nxënësit e tij ishin të parët që u morën me këtë veprë të rëndësishme mbi biografite e dijetarëve osmanë qysh duke qenë gjallë vetë autori i saj, duke e përkthyer origjinalin, duke e paraqitur atë me version të shkurtuar, apo duke shkruar

për periudha të reja si shtojca të saj, madje hasim në vepra të tilla të cilat kanë ngelur akoma dorëshkrime ose nuk është konfirmuar autorësia saktësisht e autorit, siç kemi rastin me veprën e Husein Sadri Çelebiut nga Shtipi, për të cilën nuk ka shumë të dhëna.

A - Përkthimet e origjinalit

Kopja "Hadaikurr'rrejhan fi terxhemeti shekaiunnuman" e Mehmet Haki efendiut, i njohur si Muhtesib Zade Beligradli (v. 1567) është përkthimi i parë i veprës së Tashqypri Zadesë.

Autori në disa kopje shprehet se e përfundoi veprën e tij në muajin Rexheh (mars-prill) të vitit 968-1561, duke shtuar se këtë veprë ai e kreu me lejen e autorit të veprës *Esh'shekaiku'numanijje*.^v

Ndër përkthimet më të suksesshme të veprës *Esh'shekaiku'numanijje* llogaritet përkthimi i Mehmet Mexhdi Edirneliut (v. 995/1587), titulluar si: "Hadaikush'shekaik fi tekmeletish'shekaik".^{vi} Vlera e kësaj veprë është e madhe,

GAZIU I JAZHINCËS, JONUZ MUSTAFA

(Ka aq shumë heronj të Çanakkalasë dhe fëmijët tanë duhet ta njohin shumë mirë jetën e tyre dhe të mësojnë mbi sakrificat e tyre. Të panjohur, të harruar dhe të mbajtur larg librave e teksteve shkollorë që mbi njëqind vjet, ata duhet të jenë 'lënda kryesore'...)

Shkruan: Ertuğrul Karakuş

Nga një fshat në rrugën Tetovë-Pri-
zren, një nga trojet më të bukura
të Perandorisë Osmane, shtetit që
hapi një sipërfaqe prej 22 milionë kilome-
tra katrorë nga lindja deri në skajin më të
fundit të sundimit të Islamit, nga një fshat
në këtë rrugë rrëzë malit Sharr, ai për herë
të parë ka udhëtuar me mijëra kilometra
larg, me një mision të bekuar, duke lënë
në shtëpi fëmijën e vet të parë. A është e
vështirë të besohet se ka heronj që udhë-
tojnë mijëra kilometra larg me një mision
të bekuar dhe e shohin fëmijën e tyre për
herë të parë në moshën 14-vjeçare?

Për në Jemen, që është larg 6300 km...
Për në Çanakkale, që është larg 750
km...

Shpesh më këmbë...
Herë 14 vjet, herë 2 vjet... Me plot
mall për çdo sekondë...

Për ne që jemi mësuar me kufijtë shte-
rorë në miniaturë, të ndarë nga kuptimi
mikronacionalist i sotëm (edhe pse kemi
automjete luksoze, avionë dykatësh, auto-
busë me aparate për kafe), sigurisht që
është e vështirë të besohet t'i kalojmë këto
distanca në shërbimin ushtarak...

Pse është e vështirë të besohet?
A mund të jetë se pse besimi, idealet
dhe shpresë tona janë tkurrur, ndërsa mun-
dësitë tona janë rritur?

A mund të jetë për shkak se horizon-
tet, largpamësia dhe vështrimi ynë janë
tkurrur së bashku me kufijtë tanë në rru-
dhje e sipër?

Zoti e di!
Por, nëse është kështu, mjerë ne!

Megjithatë, kjo është e vështirë për t'u
besuar, sepse në Tetovë e në Shkup, që
është vëllai i madh i Stambollit, në zemër
të tij dhe në fshatrat përreth, në çdo dasmë
janë dëgjuar meloditë dhe janë luajtur val-
let më të bukura popullore ("horet"), deri
vonë...

"Adana", "Anadoll", "Bülbülçe",
"Ibrahim Hoxha", "Osman Pasha", "Ça-
nakkale"...



Sidomos fryma "e freskët", e quajtur
"Çanakkale"...

Thoshin: "Nuk mund të ketë dasmë pa
unazën e Çanakkalasë!"... Kur daullet dhe
zurlet binin në atmosferën e "Çanakkales",
në shtëpinë e dasmës do të zbriste një qe-
tësi sublime...

Të gjithë do të zhyteshin në një tri-
shtim të përzier me krenari...

Një traditë sublime ballkanase-anadol-
lake e mençurisë, që ndërthur "dasmën"
dhe "trishtimin" me një stil delikat...

Jonuz Mustafa lindi në vitin 1875 në
fshatin Jazhincë, rrëzë maleve të Sharrit,
të cilat Jahja Kemali në poezinë e tij të
shqar i përshkruan si "male me borë".

Dëgjimi i këngëve popullore të fiseve
Serhat, Pleven, Gazi Osman Pasha,
Jemen... Ai u rrit duke përvetësuar dyvar-
gëshet e Mehmed Yazıcıoğlu-s, Ahmed
Yazıcıoğlu-s dhe Süleyman Çelebiut, që
"ndërtojnë besimin" në zemrën e tij...

Ashtu siç mësoi në epikat e Esztergo-
mit, Kanijes dhe Zigetvarit, të cilat i dëg-
jonte në fëmijëri kur përmendej "shërbimi
ushtarak", la gruan pas një muaji dhe shkoi
në Jemen...

Jemeni...
Vendi i zemrave të djegura dhe i le-
trave të djegura...

Jemeni, që nuk doli kurrë nga jeta e
Jonuz Mustafës...

"Kafja në rërën e Jemenit do të vlonte

për 5 minuta!", do të thosha...

"Nata ishte e ftohtë, ne ishim në zjarr
gjatë ditës!", do të thosha...

"Dielli na shponte çallmën ditën dhe
batanijen tonë të ftohtë natën", do të tho-
sha...

"Edhe uji i detit në plazh do t'ju
digjte!", do të thosha...

Ai shkon nga Jemeni në Qabe mes
72000 njerëzve... Edhe nëse digjet apo
ngrin, Jemeni është një arsye për Jonuz
Mustafën dhe mijëra heronj të tjerë për ta
parë Qabenë me sytë e tyre... Njësoj si
Vejsel Karani, ashiku i hazreti Pejgamberit...

Ai i ka lënë 12 vite në Jemen...

Ai vetë shkruante "letra veterane", që
do të digjen dhe do të zhduken në shtëpinë
e fshatit të tij gjatë viteve të luftërave, gjatë
pushtimeve...

Ai gjithashtu pa robëri në Egjipt...
Kur u kthye në fshatin e tij në vitin
1900, pa për herë të parë vajzën e tij 14-15
vjeçare...

Ai e kujtonte Jemenin me disa këngë
popullore jemenase që i mbetën në kuj-
tesë... Disa rreshta, të cilat as nipërit e tij
nuk mund t'i kujtojnë tani...

"Vijnë vaporat, moj nanë, bregut të
detit,

Disa kajshin, moj nanë, disa knojshin.

Ka një letër, moj nanë, n'vilatë e çoj-
shin,

aq sa edhe vepra e Atai-t (v. 1046/1636-
37) - si një nga autorët më të suksesshëm
në këtë drejtim, nga fakti që vetë Atai
është bazuar në përpilimin e veprës së tij
te Mexhdiu.^{vii}

Terxhemei shekaiki numanij'e është
përkthimi i Ibrahim bin Ahmed Amasi-ut
(v. 998/1589-90), vepër të cilën ai e rea-
lizoi gjatë qëndrimit të tij në Amasia si
kadi, në këtë qytet. Në dallim nga përk-
thimi i Mehmet Mexhdiut, Ibrahim
Amasiu në përkthimin e tij i qëndroi be-
snik tekstut origjinal dhe e përfundoi më
998 Xhumadel ahir/në fund të majit
1590.^{viii}

Nga përkthimet e tjera nga origjinali
kemi edhe kopje të tjera, si ajo e:

- Sejjid Mustafait e titulluar: "*Hakai-
kul bejan fi terxhemeti shekaikun'nu-
man*", mirëpo për këtë kopje nuk ka
shumë të dhëna.^{ix}

- Kopja e Ahmet Dervishit, e titulluar:
"*Ed'devahatul irfanijje fi revdatil ulema
el uthmanijje*", e shkruar më
972/1564/65.^x

- Kopja e Mehmet bin Sinanuddin Ju-
sufit, e titulluar: "*Menakibul ulemai*"
(vd. Rebiul ahir 989/ maj-qershor 1581),
e shkruar më 1595.

**B- Versionet e shkurtra të veprës
"Esh'shekaikun'numanijje".**

Kopja e Sejjid Gulamit, e titulluar:
"*Muhtesar esh'shekaikunnumanijje*".
Për këtë kopje apo dorëshkrim studiuesit
osmanë deklarojnë se është një version i
shkurtuar i origjinalit të veprës "*Esh'she-
kaikunnumanijje*", mirëpo është e man-
gët dhe jo e plotë dhe supozohet që të jetë
e autorit në fjalë.^{xi}

Kopja e Mektubi Zade Abdulaziz
efendiut, e titulluar: "*Esh'shekaikunnu-
manijje ve zejli*", autori i së cilës ishte
pjesë e stafit të Meshihatit Islam deri më
1279 (tetor-nëntor 1862), kur edhe ndër-
roi jetë.

Mektubi Zadeja i kushtoi rëndësi të
madhe Enciklopedisë së Tashkypri Za-
desë (origjinalit), si dhe veprave shtesë
rreth saj, si "*Dev'hatul meshajih*" dhe
"*Hadaikul hakaik fi tekmlitish'shekaik*".

Ai e përpunoi veprën "*Esh'shekaik-
kunnumanijje*" (origjinalin) dhe "*Dev'-
hatul meshajih*" me version të shkurtër,
kurse me veprën "*Hadaikul hakaik*" ver-
sioni i shkurtër arriti deri te qeverisja e
Muratit III (v. 1595) dhe e la të pa përfun-
duar.^{xii}

Kopja "*Muntahabati shekaik ve
zejli*" e autorit Hamid Vehbi, mirëpo për
korrektësi duhet theksuar se autori në
këtë vepër ka bërë një kombinim, duke
përzgjedhur figura me peshë nga vepra

"*Esh'shekaikun'numanijje*", nga njëra
anë, dhe nga vepra "*Hadaikul hakaik fi
tekmlitish'shekaik*", nga ana tjetër, për
ta paraqitur krejt në fund si vepër në vete
me titullin e lartpërmendur, e që në fakt
emri i saj në katalogun e vjetër në Bi-
bliotekën e Fatihut nuk ka ekzistuar si
autor i veprës në fjalë, mirëpo tani në ka-
talogun e ri ekziston.^{xiii}

**C- Shtojcat e veprës "Esh'shekaik-
kun'numanijje"**

"*Ahidhidhil ejdi badhilil ejadi juna-
dil munadi fi kul'li vadi*", e njohur ndry-
she si "*Dhejlush'shekaikun'numanijje fi
ulemaid'devle el uthmanijje*", e autorit
Ashik Çelebi (v. 979/1571).

Emri i plotë i tij: Muhammed bin Ali
Zejnel Abidin bin Muhammed bin Xhe-
laluiddin bin Husejn bin Hasen bin Ali bin
Muhammed bin Er'redivi, i njohur si
Ashik Çelebi.

Është nga pasardhësit e Pejgamberit
(a.s.), nga qyteti i Mosulit në Irak. Disa
historianë mendojnë se ai lindi në Bursa-
^{xiv}, mirëpo mendimi se Ashik Çelebia
lindi në qytetin e Prizrenit është më i
saktë.^{xv}

Një pjesë të bukur të jetës së tij ai e
kaloi në qytete të ndryshme të Ballkanit,
duke u emëruar si kadi (gjykatës) në Qu-
stendil, Kratovë, Prishtinë^{xvi}, në fund
edhe në Shkup, ku edhe ndërroi jetë.^{xvii}

**VEPRA, ME PESHË TË MADHE
SHKENCORE**

Pesha e kësaj vepre shkencore është
e madhe, edhe atë për disa arsye:
është shtojca e parë e veprës "*Esh'-
shekaikun'numanijje*" si në gjuhën arabe,
po ashtu edhe në gjuhën turke.

Ashik Çelebia jetoi dhe veproi në
kohën sa ishte gjallë Tashkypri Zadeja
dhe ishte nga nxënësit më të afërt të tij.

Ai po ashtu është edhe përkthyesi i
parë i veprës në fjalë në gjuhën turke sa
ishte gjallë vetë autori.

Stili i Ashik Çelebisë është më i afërt
me stilin e origjinalit, në krahasim me
shtojcën e Ali Balit, për të cilën do të fla-
sim në vijim.

Shtojca e Ashik Çelebisë konsidero-
het një dokument i vlefshëm, që zbulon
qartë realitetin e jetës shkencore në Pe-
randorinë Osmane në gjysmën e dytë të
shekullit të gjashtëmbëdhjetë etj.^{xviii}

Shtojca "*El ikdil mendhum fi dhikri
efadilir'ruum*", e autorit Ali bin Bali, i
njohur si Minik Ali (v 992/1584).

Këtë vepër (shtojcë) autori Ali bin
Bali e shkroi në gjuhën arabe, njësoj si
origjinali i Tashkypri Zadesë dhe shtojca
e Ashik Çelebisë.

Autori veprën e tij e filloi me biogra-
finë e Tashkypri Zadesë dhe e vazhdoi
me ndriçimin edhe të 88 figurave shken-
core të tjera, edhe atë nga viti 965 e deri
më 989 H.^{xix}

Shtojca "*Hadaikul hakaik fi tekmlit-
ish'shekaik*" e autorit Nevi Zade Atai.

Kjo shtojcë përfshin biografitë e ule-
mave midis viteve (940/1533-34 dhe
1044/1634-35) apo nga sulltani i dhjetë
osman Sulejman Kanuni e deri te sulltani
i shtatëmbëdhjetë osman Murati IV.

Numri i biografive të përfshira në
këtë vepër arrin në 1135, kështu që
ky numër e bën veprën e Atait si
shtojcën më voluminoze të "*Esh'shekaik-
kun'numanijje*" të shkruar ndonjëherë.^{xx}

Nevizade Atai veprën e tij e përfun-
doi në vitin 1634, kur ishte gjykatës i
Shkupit.^{xxi} Ai në fund të librit shkruan:

"*Kemule bi idhnil'lah teala fi ev'veli
rebiul ahiri seneh 1044.*

*har'rerehu el fekir Ataull'llah, el kadi
bi Uskub, qufire lehu.*"^{xxii}

E përfundoi me ndihmën dhe me
lejen e Allahut në fillim të muajit Rebiul
ahir në vitin 1044.

E shkroi – thuhet - varfanjaku (i ne-
vojshmi për mëshirën e Zotit) Ataul-
llahu Kadi në Shkup, Zoti e pastë falur.

**(Autori është Profesor në Medre-
senë Isa Beu në Shkup)**

ⁱ Tashkypri Zade, *Esh'shekaikun'numanijje fi ulemaid'd-
devleti'l uthmanijje*, Darsaadet, Istanbul, fq. 5.

ⁱⁱ Po aty.

ⁱⁱⁱ Po aty, fq. 6.

^{iv} Franz Babiger, *Tashkypri Zade, Dairetul Mearif el
Islamijje*, Darur Marife, Bejrut, vëll. 15, fq. 39.

^v Navi Zade Atai, *Hadaikul Hakaik fi Tekmlitish'she-
kaik*, përgatiti: Suat Donuk, TYEKB, Istanbul,
2017, vëll. 1, fq. 31.

^{vi} Abdulkadir Ozxhan, *Esh'shekaikun'numanijje, Islam
ansiklopedisi*, vëll. 38, fq. 486.

^{vii} Bursali Mehmet Tahir, *Osmanli Muel'lifleri*, përga-
titën: Ismail Ozen, Jajxhalik Matbaasi, Istanbul,
1975, vëll. 3, fq. 98.

^{viii} [http://teis.yesevi.edu.tr/madde-detay/ibrahim-
ibrahim-bin-ahmed-elamasi](http://teis.yesevi.edu.tr/madde-detay/ibrahim-
ibrahim-bin-ahmed-elamasi)

^{ix} *Hadaikul Hakaik fi Tekmlitish'shekaik*, Suat Donuk,
vëll. 1, fq. 31. - [http://teis.yesevi.edu.tr/madde-
detay/ibrahim-ibrahim-bin-ahmed-elamasi](http://teis.yesevi.edu.tr/madde-
detay/ibrahim-ibrahim-bin-ahmed-elamasi)

^x *Hadaikul Hakaik fi Tekmlitish'shekaik*, Suat
Donuk, vëll. 1, fq. 33.

^{xi} Po aty, fq. 32.

^{xii} Po aty.

^{xiii} *Hadaikul Hakaik fi Tekmlitish'shekaik*, Suat Donuk,
vëll. 1, fq. 35.

^{xiv} Po aty, fq. 36.

^{xv} Ashik Çelebi, *Dhejlush'shekaikun'numanijje fi
ulemaid'devle el uthmanijje*, përpunoi: Abdur'rrezak
Berekat, darul hidaje lin'neshri vet'tevzi, Kajro, bot. I,
2007, fq. 28.

^{xvi} Gunaj Kut, *Ashik Çelebi*, Islam ansiklopedisi,
TDV, vëll. 3, fq. 549.

^{xvii} Po aty.

^{xviii} Ashik Çelebi, *Makedonska Enciklopedija I*,
MANU, Skopje, 2009, fq. 108.

^{xix} Ashik Çelebi, *Dhejlush'shekaikun'numanijje
fi ulemaid'devle el uthmanijje*, Abdur'rrezak Berekat,
fq. 26.

^{xx} Po aty.

^{xxi} *Hadaikul Hakaik fi Tekmlitish'shekaik*, Suat
Donuk, vëll. 1, fq. 38.

^{xxii} Haluk Ipekten, *Atai Nev'izade*, Islam ansiklo-
pedisi, vëll. 4, fq. 40.

^{xxiii} *Hadaikul Hakaik fi Tekmlitish'shekaik*, Suat
Donuk vëll. II, fq. 1885.

O, për shtat vjet, o moj nanë, të na presin gratë.

Mos na pritshin, moj nanë, për shtatë vjet,

O, ne t'i marrin, moj nanë, burrat pleq."

Dhe Çanakalaja...

"Aty ku u fundos një epokë!"

Luftëtari i Jemenit, Jonuz Mustafa, nxiton në Çanakalaja për të mbrojtur kryeqytetin e vjetër, Stambollin...

"Ne kemi luftuar fyt për fyt në Dar-danele", do të rrëfente ai...

Ndërsa sytë e tij të lodhur po shikonin larg, dukej sikur po synonte një anije të blinduar, që përpiqej të kalonte përmes ngushticës...

Titulli "Gazi" iu dhurua Jonuz Mustafës...

Ai kishte dy djem dhe një vajzë... Djali i tij më i vogël, Isaku, i lindur në vitin 1917, u bë hafëz i denjë për lavdinë e të atit...

Gazi Jonuz Mustafa, duke u mbështetur në shkopin e tij, u këndoi nipave të tij këngë popullore të Çanakalajasë dhe të Jemenit...

"Ne hipëm mbi sipërfaqen e detit në Stamboll,

Nga malli më kërcitën sytë,

Dëgjoni vëllezër, ma merrni fjalën,

Oh, kapiten, a do të shkojmë në Jemen?"

Gazi Jonuz Mustafa ndërroi jetë në fshatin e tij në vitin 1949...

Varri i tij është në fshat... Edhe pse është i pashkruar, ne vërejmë se s'ka as edhe një gur varri!

Tani, le të kthehemi te...

Nuk duhet të jetë çudi që Gazi Jonuz Mustafa nxitoi në Jemen, 6300 km larg dhe në Çanakalaja, 750 km larg.

Nuk është për t'u habitur që në shumë fshatra të Shkupit, të Tetovës, të Gostivarit dhe të Ballkanit në përgjithësi, ka njerëz të cilët kënga e "Çanakalajasë" këndohet në dasma dhe të vë në kujtime të thella për të kaluarën...

Megjithatë, si në shumë fshatra të Ballkanit, është për t'u habitur që varret e heronjve, si edhe e Gazi Jonuz Mustafës, janë pa vizitorë dhe pa gurë!

(Titulli i origjinalit: Assoc. prof. dr. Ertuğrul KARAKUŞ, Kalkandelen-Yajinse Köyünden Gazi Yunuz Mustafa:

<https://www.maarifinse.com/kalkandelen-yajinse-koyunden-gazi-yunuz-mustafa/> Tekstin e përshtati prof. dr. Muhamed Mustafa, ligjërues i gjuhës arabe në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup dhe njëherësh edhe nip i luftëtarit (gaziut) të periudhës osmane Jonuz Mustafa.)

HAXHI KADRI EF. POLLOZHANI, NJË HOXHË NË SHËRBIM TË KOMBIT

"PA VATAN NUK KA IMAN" (MUHAMEDI A. S.)

Shkruan: prof. dr. Nebi Dervishi

Në galerinë e personaliteteve të njohura kombëtare, krahas emrave të shquar, sigurisht që kanë vend edhe emrat që janë më pak të njohur, të cilët nuk janë vlerësuar aq sa duhet dhe aq sa kanë merituar, ndonëse shumë prej tyre kanë qenë kreatorë dhe faktorë kyç të zhvillimeve që sollën ndryshime domethënëse për fatet e një pjese të madhe të kombit shqiptar.

Në këtë grup pa dyshim që bën pjesë edhe Kadri Pollozhani, i cili i përket gjeneratës (plejadës) së veprimtarëve tanë që dhanë kontributin e tyre përgjatë dekadave në favor të transformimit të vetëdijes kombëtare të shqiptarëve të mbetur nën robërinë sllave, sidomos në momentet vendimtare të riorientimit të veprimtarisë së gjithëmbarshme kombëtare në kontekstin e ri gjeopolitik që nga viti 1945 e deri në Plenumin e Katërt të Brioneve (1 korrik 1966) dhe pas tij.

Që në moshë të re Kadriu u përball me padrejtësitë dhe dhunën e egër që solli ripushtimi sllav në trevat lindore dhe verilindore (Maqedoninë Perëndimore dhe Kosovë) pas Luftës së Dytë Botërore (1944/45), e sidomos me peripeçitë bren-dafamiljare që i përjetoi nga UDB-ja dhe sistemi monist jugosllav. Organet e UDB-së ia burgosën babanë, Azizin, duke e dënuar me 13 vjet heqje lirie në një proces të montuar gjyqësor dhe duke ia konfiskuar pasurinë. Pak kohë më vonë ai do të vdesë në rrethana të pasqaruara në burgun e Manastirit, ndërkohë që familjarëve të tij nuk iu mundësua që, së paku, ta varrosin trupin e pajetë të tij. Madje, ata edhe sot e kësaj dite nuk e dinë se ku prehen eshtrat e Aziz Qerim Pollozhanit, babait të Kadriut.

Kadri Pollozhani që në moshë të re, kur i kishte vetëm 17 vjet, e njohu realitetin e shtypjes së egër, ndaj idealet dhe përcaktimi i tij ishin rrjedhojë e natyrshme e kontekstit jetësor dhe formimit të va-

zhdusëshëm si njeri i fesë dhe intelektual me bindje dhe veprime të qarta atdhetare. Alternativa tjetër e përcaktimit të tij mund të ishte pajtimi me robërinë, gjë që nuk përputhej me karakterin e tij prej kryengritësi e disidenti të pashoq. Në çdo ndejë rasti, në gëzime e dëshpërime, biseda e tij ndiqej me vëmendje e kureshtje nga të pranishmit, sepse ai ndërthurte mjeshtërisht kombëtarën me fetaren, për ta përforcuar akoma më shumë moton parësore të tij se pa vatan nuk ka iman.

Kadri Pollozhani është një personalitet i njohur në Fushëgropën e Ohrit e më gjerë, veçanërisht në mesin e bashkëveprimtarëve dhe bashkëvuajtësve. Ai nuk kishte ardhur në këtë botë sa për të parë e për të ikur, por me mision të përcaktuar, pra për të parë të tjerët se ç'mund të bëjë njeriu kur ka dëshirë, dashuri e vullnet të pathyeshëm për t'i lëvizur jo vetëm gjërat e vogla e të rëndomta, por edhe proceset më të ndërlikuara drejt zhvillimit e përparimit. Megjithatë, me modestinë e tij karakteristike, ai thoshte gjithmonë: "Kam bërë shumë pak."


I ballafaquar me një mijë e një tragjedi, me drama, tortura e padrejtësi, ai përsëri gjente forca për të ecur përpara, për të mos u dorëzuar e gjunjëzuar. Ishte njeri i fjalës dhe i veprave, i urtieve dhe i kuvendeve, i seriozitetit dhe i humorit, i punës dhe i aksionit, i ruajtjes së traditës kombëtare e i trashëgimisë kulturore dhe, mbi të gjitha, kishte në zemër diturinë dhe librin.

Kadri efendi Pollozhani do të mbetet në kujtesën tonë dhe të brezave që do të vijjnë pas nesh si një iluminist i kohëve moderne dhe si një yll i pashuar në horizontin kombëtar.

Parimi i tij jetësor ishte se dy janë parakushtet themelore që një njeri apo një popull të arrijë mirëqenien e tij:

a) Liria (pra, një person apo një popull të jetë i lirë); dhe

b) Shëndeti (pra, një person të gëzojë shëndetin e një popull, të ketë moral të lartë).



Figurat e çmuara të kombit më së paku i takojnë familjes. Kadri efendi ishte humanist, fetar e patriot i guximshëm dhe pikërisht për veprimtarinë e tij atdhetare e humane u arrestua, u burgos e u torturua nga armiqet e kombit tonë, por kurrë nuk mbeti gjakumbur.

Hoxhë Kadriu, siç e njihnin dhe e thërrisnin shumica, ishte imam dhe njeri me virtyte të larta humane e kombëtare. Ai ishte orator i shkëlqyer, haxhi dhe hafëz, njohës dhe interpretues i Kuranit famëlartë. Ishte gojëmbël dhe i ditur, i matur dhe i qetë, ishte edhe dëgjues i kujdesshëm dhe i durueshëm; ndiqte me vëmendje fjalët dhe gjykimet e bashkëbiseduesve. Përgjigjen e kishte gjithmonë në majë të gjuhës dhe asnjëherë nuk hezitonte ta thotë të vërtetën në oda e në ndeja të rastit, pa marrë parasysh se kush ishte përballë tij. I ka dashur dhe i ka respektuar njerëzit e rrethit të vet, por edhe të tjerët, pa dallim kombësie, besimi apo race.

Predikimet dhe interpretimet e fesë i ka zbrëthyer qartë e thjesht në mënyrë që ta kuptonin të gjithë. Asnjëherë nuk i ka përshtatur ato sipas dëshirës së ndonjë pushtetari. Madje, kur rastiste që ndonjë i tillë të ishte i pranishëm, Kadriu ishte edhe më radikal. Frikën dhe interesin personal nuk i ka përfillur kurrë. Nuk ka qenë materialist. Paraja për të ishte diçka, por jo gjithçka.

Ka gëzuar autoritet të madh jo vetëm te xhemati, por edhe në mesin e të tjerëve. Asnjëherë nuk ka rënë në konflikt me mësuesit dhe studentët që në kohërat më të hershme kishin një ideologji ndryshe.

I respektonte më të vjetrit dhe këtë e kërkonte edhe nga ne më të rinjtë. E njihte shumë mirë historinë e popujve të Ballkanit, e sidomos historinë e popullit shqiptar dhe gjeografinë e trojeve etnike shqiptare. Lexonte shumë dhe këto njohuri i rifreskonte nga veprat enciklopedike. "Kamus ul-Al'lâm"-i i Sami Frashërit kishte vend të veçantë në bibliotekën e tij personale.

Xhematin e trajtonte njësoj - si të pasurit, ashtu edhe të varfrit; si shqiptarët, ashtu edhe pjesëtarët e nacionaliteteve të tjera si: egjiptianët, romët, boshnjakët, turqit etj. Pas ceremonisë mortore u shkonte për ngushëllime edhe atyre.

Ai respektonte njësoj edhe bashkëkombësit e besimeve të tjera. Vazhdimisht shkante për ngushëllime, dhe në raste të tjera - gëzimi, te shqiptarët dhe familjet e tjera të besimit të krishterë, ku fjalët e tij dëgjoheshin me vëmendje dhe me respekt. Ndonjëherë thoshte si me shaka: "Nuk e di se si jam bërë hoxhë; se në fisin Pollozhani, edhe kur kemi qenë të besimit të krishterë, nuk kemi pasur priftërinj."

Përcaktimin për të ndjekur mësimet në medrese e lidh me trashëgiminë nga fisi i nënës, prej të cilëve kishte pasur ndonjë hoxhë.

Megjithatë, për pushtetin komunist Kadriu dhe familja Pollozhani, pas vitit 1945, ishin ende në sy të keq sa nga i ati i tij, Aziz Qerimi, po aq edhe nga qëndrimi i tij që nga viti 1978, kur u spikat si njëri ndër organizatorët e kërkesave për hapjen e paraleleve në gjuhën shqipe në gjimnazin e Ohrit, pastaj për kërkesën që shqiptarët që jetonin në këtë qytet të regjistroheshin në regjistrimin e vitit 1981

ashtu siç ishin dhe si ndiheshin (pra shqiptarë dhe jo turq) e për shumë aktivitete të tjera që kishin për qëllim zbatimin në praktikë të barazisë e të drejtësisë në Ohër e më gjerë. Kjo kulmoi me burgosjen e tij më 20 qershor të vitit 1981, kur u dënua me 5 vjet burg të rëndë, prej të cilave i vuajti 3 vjet e gjysmë.

Në këtë pjesë hyrëse të kësaj monografie kushtuar figurës shumëdimensionale të Kadri Pollozhanit duam të prezentojmë, në shenjë respekti dhe mirënjohjeje, jetën dhe kontributin e tij për zhvillimin e gjithëmbarshtëm të shqiptarëve në vendin ku ai jetoi dhe punoi duke dashur të veçojmë dy aspekte të kësaj veprimtarie që e bëjnë atë të veçantë dhe për të cilat do të mbahet mend dhe shpresojmë që do të ndiqet si shembull edhe nga të tjerët dhe ato janë:

- Hoxhë Kadriu si shembull i një njeriu të fesë dhe besimtarit të devotshëm, i cili jetën ia pati kushtuar shërbimit profesional dhe Zotit të gjithëfuqishëm, përkushtimit në shërbim të çështjes kombëtare dhe trumbetimit të pakënaqësive e zgjidhjes së problemeve reale të popullatës; dhe

- Shembull i durimit, i punës këmbëngulëse për të dëshmuar se edhe nëpër vendbanimet ku shqiptarët janë në numër më të vogël mund të organizohen dhe t'u bëjnë ballë padrejtësive, duke mos u përlur para kërcënimeve të pushtetit dhe duke punuar për realizimin e të drejtave të tyre legjitime.

Duhet theksuar se në këtë rrugëtim përgjatë periudhave të ndryshme Kadri hoxha nuk ishte i vetëm. Nuk kanë qenë të paktë dijetarët e fesë, të konfesioneve të ndryshme fetare, duke përfshirë edhe ata të besimit islam, që kanë luajtur rol të rëndësishëm, madje edhe rol kyç, në momente të caktuara historike. Kështu që, Imam Kadriu nuk është as i pari dhe as i vetmi, ndaj dhe jemi të bindur që nuk do të jetë as edhe i fundit i një shembulli të mirë se si një njeri, edhe përballë çdo furtune, mund të qëndrojë vertikalisht dhe stoik. Mund të thuhet se ai jetoi në një kohë dhe në një vend ku mbi bazën e traditës që njihte, e ndjente si obligim ta kryejë pjesën e vet të punës si detyrim moral dhe shpirtëror, sidomos në ato kushte dhe në atë vend specifik siç ishte qyteti i Ohrit.

(Pjesë nga libri "Haxhi Kadri ef. Pollozhani, një hoxhë në shërbim të kombit", botoi Vatra, Shkup, 2021. Recensentë: prof. dr. Mixhait Pollozhani, doc. dr. Besnik Rameti. Për botim këtu, dorëshkrimi është marrë nga prof. dr. Aziz Pollozhani. Redaktimi: "Hëna e Re")

KAPELANIA, NJË SFIDË E RE PËR SHOQËRINË TONË NË RMV

Strukturat e Ushtrisë nuk duhet të mbeten "geto", në të cilat të drejtat dhe liritë individuale - përfshi të drejtat e bindjeve fetare - nuk janë të pranishme. Reflektimi për këto gjëra është një domosdoshmëri për çdo shoqëri sot që pretendon të jetë demokratike. Paragjykimet, keqkuptimet duhen lënë mënjanë.

Nga Shaban Sulejmani

Diskutimet tanimë në koluare të ndryshme të niveleve më të larta, organizimi i një tryeze të rumbullakët për çështjen e oficerëve fetarë në Ushtri, të njohur ndryshe me termin kapelanë, duken për mentalitetin tonë mbase pak të çuditshme, si dhe interesante në pamje të parë. E çuditshme, për ata që hasin për herë të parë një çështje të tillë, deri tani të panjohur në diskursin politik. Është interesante, për ata që tashmë kanë njohuri të caktuara për diçka që është e pranishme, jo vetëm në mjedisin tonë, por edhe më gjerë.

Të paktë janë ata që e dinë se nuk bëhet fjalë për futjen e një praktike të re. Bëhet fjalë vetëm për ringjalljen e një praktike që tashmë është krijuar në zonat tona. Përkatesisht, në vendet e këtushme para Luftës së Dytë Botërore zyrtarët fetarë janë përfshirë drejtpërdrejt në problemet dhe çështjet që kanë të bëjnë me strukturat ushtarake. Dëshmitarë të kësaj janë Kroacia dhe Serbia, si dhe Mbretëria e Jugosllavisë. Këtu bëhej fjalë për realizimin e të drejtave individuale fetare të qytetarëve, veçanërisht në strukturat ushtarake. Dihet qartë se veprimtaria e funksionarëve fetarë i referohet ekskluzivisht nevojës për përmbajtje fetare që nuk guxon të vihet në dyshim për ushtarët dhe oficerët dhe në asnjë rast nuk bëhej fjalë për përfshirje në formimin e çështjeve politike. Prandaj, çështja e të drejtave dhe lirive fetare, si çështje individuale, nuk duhet të neglizhohet në këtë segment të jetës shoqërore, por nuk është çështje politike, por krejtësisht fetare.

PËR ZGJEDHJE TË LIRË

Duke qenë se religjioziteti është një çështje e garantuar me të gjitha aktet lig-



jore, kjo nënkupton që ato akte lënë hapësirë për ta perceptuar këtë problem në Ushtri, ku pjesëtarët e traditave të ndryshme fetare nuk duhet të pengohen, nëse dëshirojnë, me zgjedhje, në plotësimin e nevojave të tyre fetare. Këtu nuk bëhet fjalë për ndonjë lloj indoktrinimi fetar që do të imponohet si i detyrueshëm, por për zgjedhje të lirë. Ajo zgjedhje e lirë e njeriut duhet të dalë në pah edhe në strukturat e Ushtrisë. Çështja e indoktrinimit ateist ishte e pranishme vetëm në sistemin komunist dhe jo në shoqëritë me orientim qytetar. Në shoqëri të tilla, askush nuk lejohet t'i imponojë askujt një besim të caktuar, madje as ateizmin.

Praktika në vendet fqinje ku ky fenomen është i pranishëm edhe sot, pas vitit 2000, tregon rezultate mjaft pozitive në funksionimin e strukturave të Ushtrisë. Bëhet fjalë për një përmbajtje të pastër praktike fetare që kërkon ndihmën e klerikëve (të dijetarëve fetarë) për realizimin e asaj përmbajtjeje, ekskluzivisht si procedura individuale, të parrethura nga çdo mjedis politik. Strukturat ushtarake, së fundmi, nuk mund të izolojnë plotë-

sisht nga ato përmbajtje për të cilat kanë të drejta të plota, për të cilat kanë të drejtë edhe qytetarët tjerë në shoqëri. Në këtë kontekst duhet kuptuar edhe kjo çështje.

Për sa u përket atyre që kanë njëfarë njohurie për këtë problem, ata kanë për detyrë të gjejnë modele vërtet të pranueshme të veprimit të zyrtarëve fetarë në strukturat e Ushtrisë. Edhe këtu del në pah vendosja multikonfesionale e marrëdhënieve që pasqyrohet në jetën politike e shoqërore. Strukturat e Ushtrisë nuk duhet të mbeten "geto", në të cilat të drejtat dhe liritë individuale - përfshi të drejtat e bindjeve fetare - nuk janë të pranishme. Reflektimi për këto gjëra është një domosdoshmëri për çdo shoqëri sot që pretendon të jetë demokratike. Paragjykimet, keqkuptimet duhen lënë mënjanë.

Fakt është se asnjë traditë fetare nuk ka praktika të tilla që mund të ndikojnë negativisht në formimin dhe formësimin e aftësive ushtarake dhe qëllimin e tyre për të cilin ato janë krijuar. Dhe, në këtë segment të jetës shoqërore feja mund të luajë një rol themelor në forcimin e

paqes, të sigurisë dhe të stabilitetit në komunitetet multikonfesionale dhe multietnike. Paqja, siguria, mbrojtja e njeriut dhe dinjiteti i tij janë çështje themelore të traditës fetare. Strukturat ushtarake, si të tilla, mbështeten në jetën multifetare dhe multietnike të shoqërisë. Dhe, për këtë arsye ato nuk mund të izolojnë dhe të përjashtohen nga një mundësi e tillë.

MBËSHTETJE NË VETVETE

Feja nisat nga fakti se nëse njeriu e do Krijuesin, atëherë duhet t'i dojë edhe krijesat që Ai krijoi. Ky është një rregull universal, mbi të cilin mbështetet çdo fe e shpallur. Vetë prania e klerikëve (dijetarëve të fesë) nga tradita të ndryshme fetare dëshmon për dialogun që formon ato marrëdhënie. Ai dialog është i brendshëm, i diktuar nga vetë ato tradita dhe nuk është një projekt i hedhur "nga lart", nga ndonjë element i jashtëm. Kuptimi i atij dialogu dhe marrëdhëniet që mbështeten mbi të janë një garanci e jashtëzakonshme që secili të përcaktojë vetëvazhdimësinë e tij në drejtim të ushtrimit të atyre të drejtave dhe lirive që janë garanci e identitetit të tij - qoftë etnik

apo fetar. Kohët e "misioneve" dhe "misionarëve", kur duhet t'i thuash dikujt se çfarë të bëjë dhe si të vendosë në jetën e vet, kanë ikur. Misionarin sot e zëvendëson komunikimi apo dialogu, biseda e ndërsjellë, mosimponimi i premisave që devijojnë nga parimet universale mbi të cilat bazohet etika fetare. Prandaj, dialogu nuk duhet të kthehet në mision vetëm të njëjës palë, por që ai të mbështetet në vetvete, si i tillë dhe si i tillë ka qenë gjithmonë i pranishëm në këto hapësira.

Prandaj, shtresa e dytë e intelektualeve, ata që i ndjekin tendencat demokratike, ndër të tjera në fushën e të drejtave fetare në strukturat e Ushtrisë duhet të përfshihen më aktivisht në njohjen më të gjerë të këtyre prirjeve dhe gjetjen e modeleve të përshtatshme për formësimin e marrëdhënieve të zyrtarëve fetarë me strukturat ushtarake dhe kanë për qëllim promovimin e paqes, stabilitetit dhe forcimit të vullnetit të ushtarëve që kanë për detyrë mbrojtjen e qytetarëve në një vend të caktuar. Përfitimi kognitiv dhe psikologjik që vjen nga përvoja fetare, e cila kryesisht është e përcaktuar nga brenda,

mund të jetë me përfitim të madh. Feja dhe morali për të cilin ai mbron, ka një ndikim të fortë në jetën mendore të një personi. Jeta ushtarake, e cila është në shërbim të të gjithë qytetarëve të një shoqërie, nuk duhet të përjashtohet nga ai ndikim.

Që këtej, çdo debat që synon të perceptojë përvoja të tjera rreth kësaj çështjeje, në mjedisin tonë dhe më gjerë, duhet të nxitet pikërisht nga strukturat intelektuale që do ta ndriçojnë këtë çështje nga aspekte dhe përvoja të shumta dhe, në të njëjtën kohë, të zgjedhin ato më të përshtatshmet për një mjedis në të cilin jetojmë, i cili, pa dyshim, ka edhe karakteristikat e veta. Respektimi i këtyre karakteristikave është një e drejtë themelore e bartësve të këtyre karakteristikave dhe për ata në strukturat e Ushtrisë. Shpresojmë që ai të thellohet në këtë problematikë dhe vetë nisja e një debati publik për një çështje të tillë tregon, ndonëse pak me vonësë, hapjen ndaj këtij problemi që duhet të dalë në pah dhe të gjejë vendin e tij në diskursin demokratik.

(Autori është Dekan i Fakultetit të Shkencave Islame në Shkup)

PROFIL

ETAPAT E SHPËRNGULJES NË RAJONIN E LIKOVËS

Hoxhallarët në mënyrë të vazhdueshme i bënë thirrje popullatës që mos ta lëshojë vendin. Dhe, si mekanizëm për ndaljen e fluksit të shpërnguljes thoshin: "Haram ka bërë ai që e lëshon vendin." Po ashtu: "Ka bërë haram edhe ai që i përcjell deri te stacioni..."

Shkruan: mr. Seid Fejzuli

Pa Luftës së Parë Botërore (LPB) territori i Maqedonisë (së Veriut) u bë pjesë e Mbretërisë SKS (më pas: jugosllave), e cila u themelua në vitin 1918 dhe ekzistoi si e tillë deri në vitin 1941,¹ mbretëri e cila ndaj shqiptarëve ushtroi dhunë, tortura, padrejtësi, burgosje, mbyllje të shkollave dhe të mejtepeve. Po ashtu, në këtë periudhë kohore viset shqiptare u ballafaquan edhe

me shpërngulje masive të popullatës, gjë që vazhdon të jetë plagë e pashëruar edhe sot e kësaj dite në mesin e shoqërisë sonë.

Shpërngulja në vend të huaj asnjëherë nuk ka mundur të jetë e lehtë, e sidomos në ato kohëra të vështira me varfëri.² Planet për shpërnguljen e shqiptarëve ishin paraparë në laboratet e Vaso Çubrilloviqit dhe të Ivo Andriçit, që zgjati gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave botërore.³

Sa i përket ecurisë së shpërnguljeve

në rajonin e komunës së Likovës, sipas rrëfimeve, me largimin e pushtetit osman dhe ardhjen në pushtet të mbretërisë SKS-së prej vitit 1912, filloi etapa e parë e shpërnguljes.⁴ Destinacioni i parë ishte Shami, apo siç njihet Siria e sotme. Fillimisht, largimi i tyre është bërë drejt Turqisë, pastaj me anije janë transferuar drejt Shamit. Pushteti ndaj popullatës pjesë-pjesë ushtronte dhunë dhe zullum. Dhe ata, ndaj të cilëve bëhej një gjë e tillë, nuk arrinin t'i përballonin dot dhe detyrohe-



shin të shpërnguljen.⁵

Etapa e shpërnguljes në rajonin e Likovës për në Turqi kishte filluar gjatë viti 1912, torturat dhe presionet vazhduan gjatë vitit 1937, ndërsa fluksi i madh ndodhi gjatë viteve 1958-1964. Krahas torturave dhe presioneve që i përjetonin hoxhallarët, ata në mënyrë të vazhdueshme i bënin thirrje popullatës që mos ta lëshojë vendin. Dhe, si mekanizëm për ndaljen e fluksit të shpërnguljes thoshin: "Haram ka bërë ai që e lëshon vendin." Po ashtu: "Ka bërë haram edhe ai që i përcjell deri te stacioni", ku ishte pikënisja për në Turqi.⁶

Azem Latifi, i njohur si Azem Hoxha, ish-vaiz në xhaminë e Kumanovës, ishte kundër politikës diskriminuese ndaj shqiptarëve dhe kundër shpërnguljeve në Turqi. Ai asnjëherë nuk u pajtua me ata që bënin shpërnguljen. Azem Hoxha nuk e njihte Sokratin, mirëpo mendonte si ai: "Më mirë vdekje e ndershme në atdhe, sesa jetë e turpshme në dhe të huaj."⁷

Hoxhallarët i shfrytëzonin të gjitha mundësitë që kishin në dispozicion për ta bindur popullatën që mos të shpërngulej. Ata flisnin nëpër xhami, nëpër mexhlise të ndryshme, nëpër mejtepe, nëpër konakë, nëpër mevlude. Bisedonin edhe me personalitete të ndryshme politike dhe kombëtare. Kundër shpërnguljes ishin të gjithë hoxhallarët, por më të zëshëm ishin: **Shaban ef. Osmani, Hajdar ef. Jashari, Azem Latifi, Abedin Hoxha, Xhafer Azizi, Xhemail ef. Xhemaili** dhe të tjerë. Ata formuan një rrjet të gjerë dhe apelonin që mos t'i lëshojnë vatrat e tyre. Falë aktivitetit të tyre dhe figurave kom-

bëtare, emigrimi nuk mori përmasa të mëdha dhe u evitua spastrimi etnik që kishin planifikuar qarqet sllave.⁸

Sa i përket etapës së Evropës, shpërngulja filloi rreth viteve 1969-1970. Normalisht, fillet e para kanë qenë të vështira. Si destinacion ato kishin shtetin e Gjermanisë dhe secili që merrte rrugë, synonte të qëndrojë përkohësisht. Pra, të tubojnë një shumë të hollash dhe të kthehen në vend, për të blerë mjete teknike që më lehtë t'i realizojnë punët e bujqësisë dhe të blegtorisë. Mirëpo, për disa ndodhi e kundërta, ngase pajiseshin me shtetësinë e atjeshme. Specifikë ishin porosinë e kryefamiljarit, që besimin dhe frikën ndaj Zotit çdoherë ta kenë në rend të parë, ngase kishin frikë se në vend të huaj mos të humben dhe të devijojnë.⁹

Pra, shihet qartë se trendi i shpërnguljes qysh herët ka qenë dhe, për fat të keq, vazhdon edhe sot e kësaj dite me një fluks të madh falë ndikimit të faktorit ekonomik, social, politik, psikologjik dhe të sigurisë.

Pa dyshim se shpërngulja e popullatës jashtë vendit është problem tejet shqetësues, sepse me të po rrezikohet zvogëlimi i numrit të popullsisë, humbja e fuqisë punëtore dhe e klasës intelektuale, e sidomos largimi i gjeneratave të reja. Shqetësim tjetër i saj është asimilimi, duke përfshirë gjuhën, identitetin dhe besimin. Edhe pse si anë pozitive të shpërnguljes veçojmë zhvillimin në aspektin profesional dhe material, por shumë shtëpi po boshatisen dhe po mbylleen, shkollat po zbrazen, kompanitë po shuhen, prindërit dhe gjyshërit po mbe-

sin pa fëmijët, pa nipërit dhe mbesat e tyre.

Ky fenomen lë të kuptosh faktin se qysh herët është punuar dhe janë bërë përpjekje maksimale nga qarqet e ndryshme sllave, përmes skenarëve të errët, që me çdo kusht viset shqiptare të zbrazen, fenomen i cili po vazhdon edhe sot në pluralizëm - me dhunë dhe trysni ndoshta jo, por përmes mekanizmave të tjerë, të cilat po e imponojnë dhe po e joshin shpërnguljen e popullatës.

Pa marrë parasysh kohën dhe vendin ku jetojmë e veprojmë, të gjithë jemi emigruer të vetvetes. Prandaj, duhet bërë përpjekje maksimale në korrigjimin e vetvetes nga virtytet, nga sjelljet, qëndrimet, mendimet, fjalët e veprimet e pahijshme, si dhe nga faktorët dhe ndikimi i kulturave, zakoneve dhe traditave të huaja.

Më parë shpërngulja, në kohërat e hershme, ishte me dhunë, për shkak të spastrimit etnik të shqiptarëve nga trojet e tyre dhe zëvendësimin e tyre me popullatë kolonizuese. Mirëpo, në vitet '70 të shekullit XX filloi emigrimi i shqiptarëve për në vendet e Perëndimit, por pa familje, për përfitime ekonomike. Në kohën e fundit po vazhdon ky trend i shpërnguljes së popullatës shqiptare nga trojet e tyre, duke kërkuar jetë më të mirë - edhe atë, truri i inteligjencies po shpërngulet dhe kjo na dërgon drejt asimilimit modern me vetëdëshirë.

(Autori është Edukator në SHMI "Medreseja Isa Beu", Shkup. Fusnotat nuk janë përfshirë. Recensent i punimit: prof. dr. Minir Ademi, historian.)



KUPTIMI I IMANIT, ISLAMIT DHE IHSANIT



Nga Azir ef. Aziri

Bismilahi-Rrahmani-Rrahim. Falënderimet, Lavdërimet, Adhurimet, Hamdi i qoftë vetëm Al-lahut (xh. sh.), ndërsa salavatet dhe selamet e përzemërta ia dërgojmë shëmbëlltyrës sonë, Mu-hamed Mustafasë (a. s.), familjes së tij, shokëve të tij dhe të gjithë atyre që e ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit. Allah, na bëj prej tyre. Amin.

Vëllezër të dashur dhe motra të nderuara, në hytbet (ligjëratat) e ditëve të xhumaja do të flasim për temat që kanë të bëjnë me kapitullin e imanit (besimit), ndërsa sot fillimisht do ta këshilloj veten time, pastaj edhe juve me temën: Kup-timi i imanit, islamit dhe ihsanit.

Imani (besimi) është besim me zemër, shqiptim me gojë dhe veprim me gjymtyrë.

Imani (besimi) i ka gjashtë kushtet e tij, pa besimin e të cilave njeriu nuk llogaritet besimtar mys-liman.

Islami (aspekti praktik) i ka pesë kushte; mohuesi i tyre nuk llogaritet musliman, ndërsa mospraktikuesi i tyre llogaritet nga gjynahqarët e mëdhenj që duhet të pendohet.

Ihsani (përsosuria në iman dhe në islam) është ta adhurojmë Allahun (xh. sh.), të sillemi në jetën tonë gjithmonë me ndjenjën se Allahut (xh. sh.) na sheh dhe ne duhet të bëjmë kujdes se si sillemi.

Argument për këtë që thamë më lart kemi hadithin e famshëm, të cilin e transmeton Omeri (r. a.):



"Një ditë, gjersa po qëndronim me Pejgamberin, lavdia dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, përpara nesh u paraqit një njeri me rroba shumë të bardha dhe me flokë shumë të zinj.

Tek ai nuk dukeshin shenjat e udhëtimit dhe askush prej nesh nuk e njihte.

U ul pranë Pejgamberit, lavdia dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, i mbështeti gjunjët e tij me gjunjët e Pejgamberit dhe i vendosi duart mbi kofshët e tij dhe tha: 'O Muhamed, më thuaj çfarë është islami?'

Pejgamberi, lavdia dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, tha: 'Islam është: të dëshmosh se nuk meriton askush të adhurohet me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe pe-jgamber i Tij; të falësh namazin, të japësh zeqatin, të agjërosh Ramazanin dhe të bësh haxhin në Qabe, nëse ke mundësi.'

(Njeriu) tha: 'Të vërtetën pohove.' Ne u habitëm nga ajo që ai e pyeste e pastaj thoshte se (Pejgamberi) po pohonte të vërtetën.

Ai tha: 'Më thuaj çfarë është imani (besimi)?'

Ai (Pejgamberi) u përgjigj: 'Të besosh Allahun, melaqet e Tij, Librat e Tij, pejgamberët e Tij, Ditën e Fundit dhe të besosh në Caktimin (kaderin), se e mira dhe e keqja vijnë prej Tij.'

Ai tha: 'Të vërtetën pohove.' Dhe më pas tha: 'Më thuaj, çfarë është ihsani (mirësia e përsosur)?'

Ai u përgjigj: 'Ai është të adhurosh Allahun sikur të jesh duke e parë Atë. Pasi, edhe pse ti nuk e sheh Atë, Ai me të vërtetë të sheh ty...'

Pastaj ai u largua, ndërkohë që unë qëndrova për shumë kohë.

Pejgamberi, lavdia dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, më tha: 'O Omer, a e di kush qe pyetësi?'

Unë i thashë: 'Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri.'

Ai tha: "Ai qe Xhibrili, dhe erdhi që t'ju mësojë fenë tuaj." (Transmeton Muslimi)

I bëjmë lutje Allahut (xh. sh.) që me emrat e Tij të bukur dhe me cilësitë e Tij të larta të na mundësojë neve, fëmijëve tanë dhe mbarë besimtarëve myslimanë ta arrijmë përsosurinë në iman dhe në islam. Amin.

(Autori është Imam në xhaminë "Ikre" në Thun, Zvicër/në bashkëpunim)

NUK LEXOHEP PAS IMAMIT

Sipas shkollës hanefite, kur namazi falet me xhematë, një person që pason imamin nuk e lexon Fatihanë dhe ajetin ose suren e recituar pas saj. Obligimi i leximit të Kuranit në namaz i bie plotësisht Imamit (Meusili, el-Ihtijar, I, 170-171).

Ata si argument kanë ajetin kuranor ku Allahu (xh. sh.) thotë: "Kur të lexohet Kurani, dëgjoni dhe heshtni, që të jeni të mëshiruar." (sure A'raf, 7/204)

Po ashtu, edhe hadithet si: "Kush falet pas imamit, leximi i imamit është lexim edhe i tij." (Ibn Maxhe, Ikametu's-salat, 13)

"Kur imami lexon, heshtni." (Ibn Maxhe, Ikametu's-salat, 13)

Burimi: Din İşleri Yüksek Kurulu, Kurul.diyaret.gov.tr

Përgatiti: Adnan Skenderi/në bashkëpunim





NGA ZVICRA DREJT QABESË SË BEKUAR



Reportazh nga Irfan Agushi
(Enkas për HeR)

U zgjuam herët në mëngjes. Ora ishte 3:30 minuta. Pasi bëra gati valixhen, u përshëndeta me fëmijët dhe gruan, dola dhe oficalisht fillova udhëtimin tim njëjavor për në vendet e shenjta, në Mekka dhe Medina.

Jashtë bënte shumë ftohtë. Veturën dhe rrugën që duhej të përshkoja e kishte mbuluar një akull i hollë, ndërsa moti të thante. Gjithandej akull. Bëra mirë që dola herët, pasi disa miq të mi më pritnin në një qytezë afër Alpeve në ora 5:00 të mëngjesit.

Ashtu siç planifikuam, po në të njëjtën kohë u takuam. Aty u bëmë bashkë 5 persona, ndërsa rrugës për në Milano, prej ku do merrnim aeroplanin për në Jeddah, na prisnin dhe dy miq të tjerë. Njëri në afërsi të Bernës dhe tjetri diku afër Lucernit.

Pasi u bëmë bashkë i gjithë grupi, pa kup-tuar fare kishim kaluar dhe tunelin e famshëm të Gotthard-it. Nuk më kishte ndodhur ta kaloj këtë tunel pa e vënë re, pasi gjatësia e tij arrin deri në 18 kilometra.

Rrugës për në Itali bëmë një ndalesë të shkurtër, në një pushimore të afërsi të Berlinzonës. Aty pos për nga një kafe sa për të na kthjellur, u ndalëm për të falur dhe namazin e sabahut. Pasi gjetëm një hapësirë paksa më të qetë, ku nuk frekuentohej prej njerëzve, falëm sabahun dhe menjëherë filluam udhëtimin tonë drejt Milanos.

Në Aeroportin e Milanos arritëm në kohë. Dorëzua valixhet, kaluam zonën e sigurisë dhe hipëm në aeroplan. Këtu ndodhi diçka e papritur! Kur të gjithë udhëtarët ishin rehatuar në vendet e tyre, nga ekuipazhi na informuan se duhet të kthehemi përsëri në sallën e pritjes, pasi aeroplani nuk do nisej për shkaqe sigurie. Ngadalë, por me një dozë nervozizmi, u larguan të gjithë udhëtarët. Më pas na thanë se atë natë duhej të qëndronim në një hotel në Milano dhe tek të nesërmen në mëngjes do të mund të fluturonim.

ARRITJA NË TOKËN E MBRETËRISË SAUDITE

Lëshuam Italinë, rrjedhimisht edhe kontinentin evropian dhe pasi kaluam disa



shtete, piloti na bëri të ditur se kishim hyrë në hapësirën ajrore të Arabisë Saudite. Disa udhëtarë filluan me Telbijjen (**Le bejke All-llahumme Lebejk - Të përgjigjem ty, o Allah, të përgjigjem**), pasi i kishin veshur ihramet e tyre që në Milano, ndërsa disa të tjerë i bllokuan tualetet e aeroplanit për të veshur ihramet e tyre, diçka të cilën nuk ia rekomandoj asnjëri. Për t'u ikur këtyre komplikimeve, ne patëm vendosur që në Zvicër që pasi të zbresim në Xheddah, të udhëtonim për Medine dhe pastaj prej andej do të vinim për të bërë Umren (Umrah).

Në Xheddah arritëm në orët e pasdites. Pritnim që koha do të ishte shumë e nxehtë, por kësaj radhe nuk ndodhi ashtu. Edhe pse me diell, nuk ndihej i nxehti përveçues, të cili zakonisht e përjetojmë në këto vende.

Pritja dhe kalimi në pikën e kontrollave ishin të shpejta. Aty kontrollonin pasaportat dhe vizat për Umre ose vizat turistike. Ne vinim nga Zvicra dhe në mesin tonë kishim udhëtarët me pasaportë zvicerane. Këta kishin mundësinë të merrnin një vizë në formë elektronike për disa minuta. Viza turistike në këtë rast ishte valide për një vit dhe mundësia e qëndrimit

në total në Arabinë Saudite zgjaste 90 ditë. Një vizë e këtitill kushtonte 130 franga. Ndërsa ata që posedonin një pasaportë të Maqedonisë së Veriut, vizat nuk i merrnin dot në formë elektronike, por duhet të drejtoheshin në një agjenci dhe aty merrnin një vizë për një muaj, vizë për Umre. Udhëtarëve tanë një vizë e këtitill për Umre (Umrah), e marrë nga një agjenci tursitike, u ka kushtuar 320 euro. Çmimi mund të ndryshojë varësisht prej agjencisë.

NGA XHEDDAH PËR MEDINË

Me të kaluar në anën tjetër të aeroportit, në xhaminë e madhe që gjendet brenda aeroportit falëm dy kohët e namazeve - drekën dhe iqindinë në rolin e udhëtarit. Më pas morëm një minibus, i cili do të na dërgonte në Medinë. Ideja ishte të qëndronim tri ditë në Medinë dhe prej andej të shkonim për të bërë Umren.

Pas një pazari me taksistët arabë, arritëm të merrnim një minibus për 9 veta, që na kushtoi 700 realë, apo diku rreth 180 franga. Ishin dhe 470 kilometra rrugë që duheshin bërë.

Rrugës ndaluam për darkë dhe për të provuar çajin arab, që është i mrekullueshëm.

Gjatë këtij udhëtimi shumë gjëra kishin ndryshuar. Gjatë autostradës, në vende të caktuara, kishin ndërtuar pushimore me restorante, dyqane e kafiteri të bukura, të cilat nuk i gjeje dot para 5 viteve.

Pas bisedave të shumta, dhe pas disa orëve udhëtim, më në fund arritëm të shikonim minaret e larta të Xhamisë së Resulullahut. Ngjyra jeshile, që reflektonte nga dritat, i bënte këto minare edhe më madhështore. Siç zvogëlohej distanca me Xhaminë, në të njëjtën mënyrë rritej dhe entuziazmi ynë.

Udhëtimi zgjati plot 4 orë.

Ishim të lodhur dhe të rraskapitur nga udhëtimi. Megjithatë, dëshira për të parë Xhaminë e Resulullahut, varrin e tij dhe gjithë atë që ofron Medina, na bënte që të harrojmë lodhjen.

Diku para mesnatës arritëm te hoteli që kishim rezervuar. Hoteli ishte i mirë dhe shumë afër oborrit të Xhamisë së Re-

sulullahut. Pasi u regjistruam, hipëm lart, ndërruam rrobat dhe u përgatitëm për namazin e jacisë, të cilin nuk e kishim falur ende.

Dolëm dhe u nisëm drejt Xhamisë, në pjesën ku pushon trupi i pejgamberit tonë të dashur. Aty, në një skaj të Xhamisë, falëm namazin e jacisë dhe disa reقاتë nafie. Natyrisht, nuk mund të mos e provonim edhe ujin Zem-Zem.

Atë natë vendosëm që të vizitonim dhe varrin e Resulullahut, të Ebu Bekrit dhe të Omerit (Allahu qoftë i kënaqur me ta). Për habinë time, nuk kishte shumë njerëz që prisnin në radhë për të hyrë dhe për të vizituar varrin e Resulullahut. Arsyeja ishte se, tanimë, në vendin e quajtur „Bafçja e Xhenetit“, nuk kishte tollovi sikur përpara. Tani, për të falur disa reقاتë në këtë vend të bekuar duhej të regjistrohesh në një aplikacion, të bësh një termin dhe pastaj brenda disa dhjetëra minutash e gjeje veten brenda Xhamisë dhe afër Mihrabit të Resulullahut.

Pasi përshëndetëm pejgamberin Muhamed (alejhisselam) dhe dy sahabët e drejtë, u kthyem në hotel për të pushuar paksa, pasi koha e namazit të sabahut ishte shumë afër.

VIZITAT NË MEDINË

Të nesërmen na priste një ditë me një program të plotë. Pasi falëm namazin e sabahut, u nisëm për të vizituar vendet historike të Medinës. Në radhë të parë, ishte Uhudi, varrezat e dëshmorëve, aty ku pushonte dhe trupi i Hamzasë (r. a.).

Qëndruam për disa çaste mbi kodrën e vogël të shigjetarëve, më pas u afuam te kompleksi i varrezave të Uhudit. Aty besohej se janë varrosur 70 shehidët e kësaj lufte të famshme, e cila bëri një kthesë të madhe në historinë e myslimanëve.

Xhamia me Dy Kible ishte destinacioni tjetër. Aty, në atë vend, transmetohet se Muhamedi (s.a.v.s.) dhe, sipas një transmetimi tjetër, disa sahabë po faleshin në drejtim të Kudsit, kur erdhi lajmi se Allahu i urdhëron myslimanët që të falen në drejtim të Mekës. Prandaj kjo xhami sot njihet si Xhamia me Dy Kible.

Ajo që për një vizitor të Medinës është e një rëndësie të madhe, ishte dhe Xhamia Kuba, e para në të cilën Muhamedi (s.a.v.s.) fali namaz para se të ndërtonte xhaminë e madhe, që njihet si Xhamia e Resulullahut.

Aty falëm nga dy reقاتë namaz dhe pasi bëmë sqarimet e duhura që lidheshin me këtë xhami, u nisëm për tek Hendeku. Shumë shenja nga e kaluara e lavdishme e kësaj lufte nuk gjetëm, megjithatë mjaftonte të qëndroje për një çast te vendi ku myslimanët kishin ndërtuar hendekun e

gjatë rreth 5 km, me një gjërësi dhe thellësi të madhe, e cila ua bënte të pamundur mu-shrikëve kalimin në anën tjetër.

Nga vizitat tona në Medinë, ishte dhe ajo e Muzeut të sapohapur që fliste në detaje për Xhaminë e Muhamedit (s.a.v.s.) që nga themelimi, zgjerimi i saj, rindërtimet e bëra në të kaluarën, e deri te detajet më të vogla të saj.

Dua të kujtoj dhe një darkë të mrekullueshme, të cilën na e shtruan disa studentë shqiptarë që jetonin në Medinë. Ishte hera e parë që provova mishin e devesë. Sa për informacion, mishi i devesë nuk dallonte dhe aq shumë nga ai i lopës.

TAVAF, VETËM ME IHRAM

Shumë shpejt erdhi dhe dita për t'u përshëndetur me Xhaminë e Pejgamberit, me qytetin e tij dhe gjithçka që përjetuam aty.

Në ditën e tretë, pas namazit të drekës, veshëm ihramet dhe u nisëm për në Mikatin e Medinës - një xhami kjo e cila është vetëm 20 minuta larg nga Xhamia e Pejgamberit. Aty falëm nga dy reقاتë nafie namaz, bëmë nijetin e Umres, vizitorët morën informatat për rregullat dhe me **Bismilah** u nisëm për në Mekë.

Rruga ishte e gjatë dhe aty-këtu bëmë disa ndalesa. Kur arritëm në hotel, dëgjuam ezanin e mrekullueshëm, që thirrte besimtarët për namazin e jacisë. Megjithatë, për ne ishte shumë vonë.

Pasi u rehatuam dhe pushuam pak në hotel, jo më shumë se një orë, vendosëm të bëjmë Umren, e cila do të na merete disa orë. Dolëm jashtë hotelit, duke ecur në drejtim të Qabesë, në vazhdimësi këndonim **Telbijet**. Kur u ofruam afër xhamisë, ushtarët që mbajnë rend brenda dhe jashtë Qabesë na orientuan në një hyrje, ku i lëshonin vetëm ata burra që kishin veshur ihrame dhe gratë, natyrisht, që vinin për Umre.

Më pas mësuam se pas këtij viti tavaf afër Qabesë mund të bësh vetëm me ihram, që i bie se vetëm ata që bëjmë Umre, ndërsa tavafe të tjera vullnetare duhej bërë në katet sipër.

Si zakonisht, me të parë Qabënë, besimtarët luten dhe diku afër Gurit të Zi, duke ngritur dorën lart dhe duke thënë **Bismilah**, **Allahu Ekber**, fillojnë dhe rrotullimin e parë të tavafit.

Njerëz të shumë, nga vende të ndryshme, të gjithë të ardhur për një qëllim: për të qenë sa më afër Allahut.

Jo të gjithë, por tre prej nesh arritën të puthnin Gurin e Zi.

Pas 7 rrotullimeve, u ndalëm diku pas Mekamu Ibrahim dhe falëm dy reقاتë namaz. U freskuam pak me ujë zem-zemi dhe filluam **sajjin** - ritualin tjetër, që kër-

konte edhe më shumë energji se tavafi. Është kjo, pra, ecja nga kodra Saffa dhe Merva, ashtu siç bëri dikur Haxherja - Allahu qoftë i kënaqur me të, kur po kërkonte ndihmë për djalin e saj të vogël Ibrahimin (a. s.). Aty, mes dy kodrave, duhej ecur plot 7 herë, në vazhdimësi duke u lutur, duke kënduar Kuran dhe duke i dërguar salavate Muhamedit (s.a.v.s.).

Diku kah ora 2:00 pas mesanate përfunduam Umren dhe u nisëm në drejtim të hotelit. Aty kishte një dyqan berberi, i cili përfundonte dhe punën e fundit që kishte të bënte me këtë udhëtim. Qethja e flokëve është dhe nga obligimet që besimtari të lirohet nga ihrami. Por, atë nuk guxon ta bëjë vetë; atë duhet ta realizojë dikush që nuk është nën ihram, apo me nijetin për Umre.

KODRINAT E MEKËS, TË GJELBËRUARA

Në Mekë qëndruam katër net dhe katër ditë. U munduam të ishim sa më shumë prezent në xhami, pasi ky ishte dhe qëllimi ynë. Një namaz i falur në Qabe e ka vlerën sa 100.000 namaze diku tjetër. Dhe ne nuk guxonim të mungonim qoftë edhe në faljen e një namazi me xhematë.

Dita e xhuma qëlloi në Mekë. Dolëm herët për të zënë ndonjë vend brenda xhamisë, pasi njerëzit vërshuan si lumenj nga të gjitha anët. Ishte një kënaqësi e veçantë të falje namazin e xhumasë në këtë vend të bekuar.

Katër ditë ikën sikur të ishin katër orë dhe erdhi dita të përshëndetemi edhe me Qabënë e Bekuar, duke lutur Allahun që kjo vizitë të mos jetë e fundit në këtë vend të bekuar.

Bëmë gati valixhet, i ngarkuam në taksit dhe u nisëm për në Xheddah. Rrugës dukej shumë gjelbërim. E pyeta Mensurin - ashtu quhej shoferi - nëse çdo vit në këtë kohë kishte kaq gjelbërim në kodrat afër Mekës dhe ato që shihnim rrugës. Ai na tha se kjo ishte hera e parë që ai kishte përjetuar një gjelbërim të këtitill. „Këtë vit Allahu ka lëshuar bereqet dhe gjithçka rreth e përqark Mekës është gjelbëruar“, tha ai.

Disa orë para kohës së fluturimit tonë arritëm në aeroport. Dorëzua valixhet dhe hymë te porta për të pritur aeroplanin tonë. Gjithçka shkoi siç planifikuam.

Vonë në mesnatë mbërritëm në Milano. Aty kishim veturën. Pasi na e sollën, filluam dhe një udhëtim rreth 6 orësh për në Zvicër. Falë Zotit, diku para kohës së sabahut arritëm në shtëpitë tona.

(Autori është hoxhë, gazetar dhe kryetar i shoqatës humanitare „Keuther“ në Zvicër. Është nga Radusha, Shkup)

“ALLAHU I DO ATA QË MBAJNË DREJTËSINË”

Në bazë të studimit, na bëhet e qartë se vizita ndaj të sëmurit jomysliman është një rast dhe mundësi e mirë, ku ne si myslimanë duhet të demonstrojmë anën humane dhe shpirtërore të Islamit, duke krijuar një imazh të mirë tek i sëmuri mbi Islamit. Vizita ndaj të sëmurit ndikon në aspektin shpirtëror, emocional, psikik, duke e dhënë shpresë, forcë dhe energji për ta përballuar sëmundjen me lehtësi.

Shkruan: Zejnulla Sadiku

Islami na sqaron se diversiteti dhe llojshmëria e njerëzve është vullnet i Allahut. Ai na urdhëron që të jemi të mirësjellshëm në përgjithësi ndaj krijesave dhe në veçanti ndaj njeriut si krijesë. Për këtë ka caktuar disa rregulla dhe limite për besimtarët, të cilat duhet respektuar. Andaj, në këtë punim do të flasim mbi atë se a na lejohet neve si myslimanë vizita të sëmurit jomysliman, duke iu referuar argumenteve islame. Si rezultat i hulumtimit, na bëhet e qartë se Islami na urdhëron dhe na nxit për një gjë të tillë.

Në këtë punim jemi munduar të flasim mbi një normë etike dhe rregull fetar, duke sjellë argumente nga Kurani dhe nga jeta praktike e Pejgamberit (a. s.): “vizita e të sëmurit jomysliman”.

Duke pasur parasysh që sot një pjesë e konsiderueshme e myslimanëve, e në veçanti këtu në Evropë, lidhjet me jomyslimanët i kanë të pandashme - lidhjet e gjakut, të miqësisë, të shoqërisë etj. - mund të shtrohet pyetja se si duhet të silllemi ne si myslimanë në këtë rast.

Duke e parë të rëndësishme dhe të nevojshme, hulumtimit fillimisht i jemi qasur se si duhet të jenë marrëdhëniet e myslimanit me jomyslimanin në përgjithësi dhe më pas, me theks të veçantë - sjellja dhe raporti i tij ndaj të sëmurit jomysliman. Në këto rrethana, kemi shtruar pyetjen: Si duhet të veprojmë një besimtar mysliman? A duhet ta vizitojë ose jo myslimani jomyslimanin?

Vizita e të sëmurit, para së gjithash, është e drejtë njerëzore. Ajo ndikon në aspektin shpirtëror, emocional e psikik

tek i sëmuri. Mirëpo, kur i sëmuri ka sëmundje ngjitesë dhe është në pyetje shendeti dhe interesi kolektiv, a duhet dhe a mund ta vizitojmë një të sëmurë edhe nëse ai është mysliman?

MARRËDHËNIA ME JOMYSLIMANIN

Islami i ka hequr të gjitha dallimet dhe diskriminimet në racë, ngjyrë, nacionalitet, gjuhë etj. Ai i sheh njerëzit krejt në bazë humane. Në të njëjtën kohë, u garanton atyre liri të plotë në përzgjedhjen e religjionit. Boshti i Islamit është ajeti kuranor **“Nuk ka dhunë në fe.”** (Bekare: 256)ⁱ

Nëse dëshirojmë t’i përmbledhim mësimet islame për marrëdhëniet me jomyslimanët (të lejuara e të ndaluara), mjafton të cekim dy ajete kuranore, të cilat meritojnë të jenë rregulla gjithëpërfshirëse të kësaj çështjeje.¹

“Allahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja. Allahu i do ata që mbajnë drejtësinë.” “Allahu ua ndalon t’u afroheni vetëm atyre që ju luftuan për shkak të fesë, që ju nxorën prej shtëpive tuaja dhe që ndihmuan dëbimin tuaj; ju ndalon të miqësoheni me ta. Kush miqësohet me ta, të tillët janë dëmtues të vetvetes.” (Mumtehine: 8-9)

Shkaku i zbritjes së këtyre ajeteve është ndodhia e Esmes (r. a.), së bijës së Ebu Bekrit (r. a.):

Nga Esmë, e bija e Ebu Bekrit, Allahu qoftë i kënaqur me të dy, tregohet se e ëma e saj, e cila ishte idhujtare, erdhi t’i kërkojë ndihmë në kohën që i dërguari i

Allahut kishte bërë marrëveshje paqeje me banorët e Mekës. Esmë me këtë rast i kërkoj leje të dërguarit të Allahut që ta ndihmonte. I dërguari i Allahut i tha: **“Po, ndihmoje nënën tënde.”** Thotë Ibn Ujejne: **Allahu shpalli për të: “Allahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja. Allahu i do ata që mbajnë drejtësinë.”** (Mumtehine: 8)ⁱⁱ

Shejh Kardavi thotë: “Kurani na ka vënë rregullat e sjelljeve apo të raporteve mes myslimanëve dhe të tjerëve në këto dy ajete. Këto dy ajete kanë bërë dallimin mes atyre që sillen butë me myslimanët dhe atyre që i luftojnë myslimanët.”

Ndërkaq, **“Komisioni i Fetvave i Egjiptit”** mes të tjerash thotë: “Argumenti kryesor ku bazohet kjo fetva është ajeti kuranor i sures **Mumtehine**, që na vërteton qartazi se Allahu (xh. sh.) nuk na ka ndaluar nga mirësia ndaj jomyslimanëve, ruajtja e lidhjeve me ta, shkëmbimi i dhuratave me ta dhe sende të tjera që kanë të bëjnë me mirësjelljen.”ⁱⁱⁱ

MUHAMEDI (A. S.) SI MODEL I SJELLJES

Vizita dhe kujdesi ndaj një të sëmuri janë të detyrueshme në rast kur ai (i sëmurë) është në prag të vdekjes dhe i cili paraprakisht ka mungesë të kujdesit dhe të vëmendjes. Ndërkaq, ta vizitosh dhe të kujdesesh për dikë që ka ndonjë sëmundje të lehtë, përkatësisht grip apo të ftohtë, atëherë kjo është punë të cilën e ka rekomanduar Pejgamberi (a. s.), pra



sunnet. I dërguari i Allahut e zbatonte këtë gjë pa bërë dallime mes të lartit të ulët, mes zotërisë dhe shërbëtorit, mes të pasuritë e të varfrit, mes myslimanit e jomyslimanit e kështu me radhë.^v

Muhamedi (a. s.) është modeli i sjelljes ideale për të gjithë myslimanët. Allahu thotë

“Ju e kishit shembullin më të lartë tek i dërguari i Allahut; kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e Allahut në botën tjetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh Allahun.” (Ahzab: 21)

Sjellja e Pejgamberit (a. s.) është modeli më i përkryer për myslimanin; ajo është modeli më i përsosur; sjellja e Pejgamberit (a. s.) ishte e shkëlqyeshme, ishte faktor në përfitimin e zemrave të njerëzve në drejtim dhe udhëzim të Islamit.^{vi}

Një poet ka thënë: **“Bëju mirë njerëzve, ua robëron zemrat, pasi mirësia e robëron njeriun.”**^{vii}

Ebu Musa (r. a.) përcjell se Pejgamberi (a. s.) ka thënë **“Ushqeni të varfrit, vizitoni të sëmurët dhe lironi robërit.”**

(Buhariu)^{vi}

Fakti që vizita e të sëmurit është obligim i myslimanit ndaj vëllait të vet mysliman, konform haditheve të vërteta, nuk do të thotë se i sëmuri jomysliman nuk bën të vizitohet.

Kjo edhe më tepër forcohet, nëse jomyslimanin e lidh diçka me myslimanin, si: fqinjësia, shoqëria, afërsia familjare, vjehëria etj.^{ix}

Imam Buhariu shënoi një kapitull me titull: “Vizita e idhujtarit” dhe këtu e përmendi hadithin e Enesit për djalosin hebre, të cilin e vizitoi i dërguari i Allahut (a. s.) dhe e thirri në Islam dhe ai e përqafoi Islamit.

Enesi (r. a.) trasmeton se një djalosh çifut që i shërbente të Dërguarit (a. s.) u sëmur. Erdhi Pejgamberi (a. s.) tek ai dhe u ul afër, te koka e tij, dhe i tha: **“Bëhu mysliman.”** (Djaloshi) shikoi nga babai i tij, i cili ia ktheu: **“Bindju Ebu El-Kasimit, biri im.”** Kështu edhe veproi djaloshi dhe me pas ndërroi jetë. I Dërguari (a. s.) doli duke thënë: **“I tërë falënderimi i takon Allahut, i cili e shpëtoi atë nga zjarri.”**^{ix} (Buhariu, Muslimi dhe të tjerët)

Po ashtu, e përmend edhe hadithin e Seid ibn el-Musejibit, i cili përcjell për babait të vet rastin kur Ebu Talibi ishte në shtratin e vdekjes dhe i erdhi i dërguari i Allahut (Fet’hul Bari, nr: 5657).

Pak para vdekjes, në vitin e dhjetë të pejgamberisë, Ebu Talibi u sëmur dhe filloi të ankohet për shëndetin e tij. Ebu Talibi i dhimbej të Dërguarit (a. s.) dhe vazhdimisht e ftonte në Islam dhe mirësi qysh prej fillimit të pejgamberisë së tij. Mirëpo, ai nuk besoi dhe nuk e shprehu Islamit. Buhariu transmeton se Ebu Talibi pasi i ka ardhur vdekja, ka hyrë tek ai Pejgamberi (a. s.), derisa aty ka qenë Ebu Xhehli, dhe i ka thënë: **“O xhaxha, thauj *Lailahe il Allah* - fjalë me të cilën arsyetohem për ty tek Allahu.”**^{ix}

Nuk është mirë që myslimani të jetë më pak fisnik dhe me hise më të vogël nga morali se sa të tjerët. Myslimani duhet të ketë hise më të madhe në sjellje të mirë dhe të jetë me moral më të përsosur. Në hadith qëndron: **“Besimtarët me besim me të plotë kanë edhe moral më të mirë.”**^{ix}



VIZITA TË SËMURIT, E DREJTË NJERËZORE

Vizita të sëmurit është ndër të drejtat më të rëndësishme të ndërsjella të njeriut.^{xi} Obligimi për të kryer vizitën bëhet më i theksuar në rastet kur personi i sëmurë është nga të afërmit, është prindi, fëmija, bashkëshorti, bashkëshortja, ndonjë i afërm tjetër gjithashtu dhe fqinji.^{xii} Allahu thotë:

"Adhurojeni Allahun e mos i shoqëroni Atij asnjë send. Silluni mirë ndaj prindërve, ndaj të afërmeve, ndaj jetimëve, ndaj të varfërve, ndaj fqinjve të afërt, ndaj fqinjve të largët, ndaj shokut pranë vetes, ndaj udhëtarit të largët dhe ndaj robërve. Allahu nuk e do atë që është kryelartë dhe atë që lavdërohet." (Nisa; 36)

Nocioni "fqinj" përfshin myslimanin dhe jomyslimanin. Janë tri lloje fqinjësh: "Ai që ka një të drejtë, ai që ka dy të drejta dhe ai që ka tri të drejta. Fqinji me tri të drejta është fqinji mysliman-farefis dhe atij i takojnë: e drejta e fqinjësisë, e drejta e Islamit dhe e drejta e farefisit. Ai që ka dy të drejta është fqinji mysliman: ai ka të drejtën e Islamit dhe të drejtën e fqinjësisë. Ai që ka vetëm një të drejtë është fqinji politeist (jomysliman)."^{xv}

VIZITA, SHPRESË DHE QETËSI PËR TË SËMURIN

I sëmuri është njëri i dobët, ka nevojë për ndihmë dhe për mbikëqyrje, ndërkaq

këto gjëra nuk janë vetëm materiale, por: materiale dhe morale. Vizita e bën të sëmurin të kuptojë se është i rëndësishëm për ata që i ka përreth vetes, se ata e duan, ineresohen për të dhe i dëshirojnë shërimin. Të gjitha këto kuptime i japin atij fuqi shpirtërore, me të cilën do t'i përballojë sulmit fizik të sëmundjes.^{xvi}

Sëmundja, pa dyshim, ndikon edhe në shëndetin psikik të sëmurit. I sëmurit ndjen dobësi e plogështi dhe atij i nevojitet mbështetje e përkrahje nga mjedisi ku jeton. Në vend të parë, i nevojitet edhe mbështetja shoqërore, për t'i dhënë moral dhe që ai ta inkurajojë dhe t'ia bëjë të qartë se edhe më tutje e ka mbështetjen e tij dhe se nuk e ka braktisur.

Ndodhi: Në gazetën franceze "Afrika e Re", në njërin nga numrat që është publikuar në vitin 1985, thuhet se si një mjek ka të drejtë të shkaktojë vdekjen e lehtë mbi të sëmurin që ka humbur shpresën për jetë. Qëndrimin e tij e provoi edhe me shembullin e gruas së sëmurë nga kanceri i gjirit, e cila ishte e sëmurë qysh në moshën njëzetvjeçare. Gjurmët e kësaj sëmundjeje në formë të lëkurës se ënjtur iu shfaqën asaj në disa pjesë të trupit. E ka vuajtur dhe e ka duruar këtë sëmundje me dhimbje të rëndë, por ato shkuan përtej durimit dhe përmbajtjes së saj. Kur ato u bënë të padurueshme, shkoi te ky mjek dhe i kërkoi ndihmë atij, që t'i ndërpriste dhimbjet e padurueshme. Ishte ankuar se ishte e vetmuar dhe se më

askush nuk i trokiste në derë. Nga gjithë familja e madhe dhe shoqëria, pranë saj kishte mbetur vetëm motra, e cila e kishte vizituar kohë pas kohe. Telefoni i saj kishte mbetur i shurdher, sepse askush nuk ishte lajmëruar që të pyeste për të. Të gjitha lidhjet me njerëzit dhe me rrethinën ishin shkëputur. Dhe, ajo vetmi e kishte munduar dhe lënduar më shumë se sëmundja. Mjeku, nga ai i cili ajo kishte kërkuar vdekjen e lehtë, tregon se si ajo me guxim dhe vetëdije e kishte kërkuar këtë nën depresion dhe me nerva të prishura. Ai më në fund ka pranuar të dalë përballë dhe të bëjë vdekjen e lehtë (eutazinë). Ishte marrë vesh me të pas orës tetë, ndërsa ishte stina e dimrit. Jashtë atë ditë ishte mjegull dhe kishte rënë shi, andaj nuk kishte mundur të arrijë deri të banesa e saj dhe për këtë arsye ishte kthyer në banesën e tij. Të nesërmen i kishte rënë telefoni. Kur e ngriti degjuesen, motra e saj e lajmëroi që pacientja kishte bërë vetëvrasje, duke u hedhur nga dritarja e katit të shtatë dhe ishte bërë copë-copë në trotuar.

Ky është vetëm një shembull nga miliona sish që ekzistojnë në botën moderne. Dita-ditës njerëzit po bëhen më shumë e më shumë të vetmuar. Materializmi dhe egoizmi janë aq të pamëshirshëm, saqë çuan në një gjendje që edhe i shëndoshi edhe i sëmuri të ndihen të vetmuar në këtë botë - pavarësisht këtyre qyteteve të mëdha dhe numrit të madh të banorëve. Për këtë

arsye, Islami veçanërisht e ceku rëndësinë e vizitës së komshiut të sëmurë, të familjes dhe të njerëzve në përgjithësi.^{xvii}

Shëndeti është një nga dhuntitë që Allahu i Madhërishtëm u ka dhënë njerëzve. Njeriu është i detyruar të kujdeset për shëndetin e tij, për higjienën personale dhe pastërtinë, të marrë ushqimin dhe pijen e lejuar në mënyrë të moderuar. Por, pa marrë parasysh se sa kujdesemi për shëndetin tonë, secili prej nesh mund të tundohej nga sëmundja.

Qëndrimi i mjedisit ndaj pacientit është shumë i rëndësishëm dhe varet se si ai person do të përballë me vështirësinë e sëmundjes. Kërkimet shkencore moderne kanë treguar se vizita e një personi të sëmurë ka efekt pozitiv në gjendjen e tij mendore dhe shërimin më të shpejtë të tij. Mjekët këshillojnë që gjatë shërimit të një personi të sëmurë duhet të ketë gjithmonë dikë me të, përndryshe mendimet e një pacienti të vetmuar përqendrohen te sëmundja, gjë që e bën më të vështirë shërimin dhe trajtimin e saj.^{xviii}

Vlen të theksohet se ekziston dallim ndërmjet gjendjes kur i sëmuri e humb shpresën për jetë dhe gjendjes kur ai bëhet burim potencial i dëmit për të tjerët edhe kur duhet të izolohet. Në këtë rast bëhet fjalë për përplasje interesash të bashkësisë me ndjenjat e individit dhe normalisht se preferohet interesi i bashkësisë. (Ky rregull vlen si për myslimanin, ashtu dhe për jomyslimanin.)

Është shënuar se kur tek i Dërguari (a. s.) ka dashur të vinte një njeri që vuante nga lebra për të marrë një betim, i Dërguari (a. s.) e ka porositur që të kthehet dhe mos të vijë, sepse, tashmë, me dëshirën e tij që ka shprehur për të ardhur, unë ia kam dhënë betimin.^{xix}

Nuk lejohet vizita ndaj atyre që kanë sëmundje ngjitesë. Madje, urdhërohet shmangia e vizitave të tilla. Mjafton ta pyesim rreth tyre dike nga të afërmit e te sëmurit, ose ta thërrasim atë në celular.

Ebu Hurejre (r. a.) trasmeton se i Dërguari (a. s.) ka thënë: "Ikni nga i lebrosur, ashtu siç ikni nga luani."^{xx}

Omeri (r. a.) trasmeton se i Dërguari (a. s.) ka thënë: "Në rast se dëgjoni se mortaja ka rënë në një ndonjë vend të caktuar, mos shkoni atje. Dhe, në rast se e godet vendin ku ndodhni, atëherë mos u largoni prej aty."^{xxi}

VIZITA TË SËMURIT ME SËMUNDJE NGJITËSE

(Studim: Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë, 2023; Mentor: prof. dr. Islam Hasani, Dekan. Redaktimi: "Hëna e Re")

Burimet dhe literatura:

- Ahmeti h. Sherif, (1998) Kurani, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Prishtinë.
- El Gazali, Ebu Hamid Muhamed. (2017-2018), Rilindja e shkencave fetare Ihjai-Ulumid-din, Shkup: Furkan ISM.
- El Kardavi, Dr. Jusuf. (2000), Hallalli dhe harami në Islam, Shkup, 2000: Furkan ISM.
- El Kardavi, Dr. Jusuf. (2015), Fetva bashkekohore II, Shkup; Furkan ISM.
- El Kardavi, Dr. Jusuf. (2015), Fetva bashkekohore III, Shkup: Furkan ISM.
- Xhibali, Muhamed. (2019), Sëmundja, rregulla dhe dispozita, Shkup: Furkan ISM.
- El Kudri, Muhamed. (2013), Kodi social dhe moral në Islam, Shkup: Furkan ISM.
- Topoljak, Prof. dr. Sylejman (2013), Pergjigje islame, Prishtinë: Sfera sh.p.k.

PËRFUNDIMI

Në përfundim të këtij punimi, duke sjellë disa nga argumentet, na bëhet e qartë se myslimani e ka obligim që të sillet me njerëzit në mënyrë sa me të mirë, e nga sjellja e tij e mirë është që të vizitojë të sëmurin - qoftë ai edhe jomysliman me të cilin ka lidhje gjaku, miqësie apo, pa marrë parasysh, lidhje të tjera. Në veçanti, sot kur myslimanët akuzohen për jotolerancë e dhunë, myslimani duhet ta tregojë tolerancën islame. Në bazë të studimit, na bëhet e qartë se vizita ndaj të sëmurit jomysliman është një rast dhe mundësi e mirë ku ne si myslimanë duhet të demonstrojmë anën humane dhe shpirtërore të Islamit, duke krijuar një imazh të mire tek i sëmuri mbi Islamit. Vizita ndaj të sëmurit ndikon në aspektin shpirtëror, emocional, psikik, duke i dhënë shpresë, forcë dhe energji për ta përballuar sëmundjen me lehtësi.

Dhe, për fund, falënderimi i takon Allahut, Krijuesit të gjithësisë, për mirësitë e pafundme që na ka dhuruar, si dhe për shëndetin. I bëjmë lutje Allahut, që Allahu të ju japë shëndet të plotë, ndërsa ata që janë të sëmurë Allahu t'i shërojë. Amin!

(Studim: Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë, 2023; Mentor: prof. dr. Islam Hasani, Dekan. Redaktimi: "Hëna e Re")

Burimet dhe literatura:

- Ahmeti h. Sherif, (1998) Kurani, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Prishtinë.
- El Gazali, Ebu Hamid Muhamed. (2017-2018), Rilindja e shkencave fetare Ihjai-Ulumid-din, Shkup: Furkan ISM.
- El Kardavi, Dr. Jusuf. (2000), Hallalli dhe harami në Islam, Shkup, 2000: Furkan ISM.
- El Kardavi, Dr. Jusuf. (2015), Fetva bashkekohore II, Shkup; Furkan ISM.
- El Kardavi, Dr. Jusuf. (2015), Fetva bashkekohore III, Shkup: Furkan ISM.
- Xhibali, Muhamed. (2019), Sëmundja, rregulla dhe dispozita, Shkup: Furkan ISM.
- El Kudri, Muhamed. (2013), Kodi social dhe moral në Islam, Shkup: Furkan ISM.
- Topoljak, Prof. dr. Sylejman (2013), Pergjigje islame, Prishtinë: Sfera sh.p.k.

- Ibrahim el-Umeri, Dr. Abdulaziz. (2020), Jetëshkrimi i të Dërguarit, Shkup: Furkan ISM.
- Krasniqi, Dr. Shefqet. (2017), Fikhu i pakicave myslimane, Prishtinë; Fakulteti i Studimeve Islame, Bashkësia Islame e Kosovës.
- <https://www.fikhguide.com> (parë për herë të fundit më 24.01.2023).
- <https://www.islamgjakova.net/artikulli.php?id=12737> (parë për herë të fundit më 14.02.2023).
- <https://www.facebook.com/281723721959205/photos/a.282407121890865/1755938627871033/?type=3> (parë për herë të fundit më 13.02.2023).

ⁱ Muhammed el Kudri, Kodi social dhe moral në Islam (Shkup, 2013), fq. 127.

ⁱⁱ Dr. Jusuf Kardavi, Hallalli dhe harami në Islam (Furkan Ism, 2000), fq. 304.

ⁱⁱⁱ <https://www.alukah.net/sharia/> (parë për herë të fundit më 7.02.2023).

ⁱ Dr. Shefqet Krasniqi, Fikhu i pakicave myslimane (Prishtinë, 2017), fq. 398.

^v Muhammed el Kudri, Kodi social dhe moral në Islam (Shkup, 2013), fq. 104.

^v Po aty.

^{vi} Dr. Jusuf Kardavi, Fetva bashkekohore, vëlimi III (Shkup, 2015), fq. 647.

^{viii} Muhamed Xhibali, Sëmundja, rregulla dhe dispozita (Shkup, 2019), fq. 89.

^{ix} <https://www.facebook.com/281723721959205/photos/a.282407121890865/1755938627871033/?type=3> (parë për herë të fundit më 13.02.2023).

^x Muhamed Xhibali, Sëmundja, rregulla dhe dispozita (Shkup, 2019), fq. 101.

^{xi} Dr. Abdulaziz b. Ibrahim el-Umeri, Jetëshkrimi i të Dërguarit (Furkan ISM, Shkup, 2020), fq. 101.

^{xii} Dr. Jusuf Kardavi, Fetva bashkekohore, vëlimi III (Shkup, 2015), fq. 650.

^{xiii} Muhamed Xhibali, Sëmundja, rregulla dhe dispozita (Shkup, 2019), fq. 88.

^{xiv} Muhamed Xhibali, Sëmundja, rregulla dhe dispozita (Shkup, 2019), fq. 90.

^{xv} Ebu Hamid Muhamed el Gazali, Rilindja e shkencave fetare Ihjai-Ulumid-din (Furkan ISM, Shkup 2017-2018). fq. 540.

^{xvi} Dr. Jusuf Kardavi, Fetva bashkekohore, vëlimi II (Shkup, 2015), fq. 485.

^{xvii} Prof. dr. Sylejman Topoljak, Pergjigje islame (Prishtinë, 2013), fq. 395.

^{xviii} <https://www.islamgjakova.net/artikulli.php?id=12737> (parë për herë të fundit më 14.02.2023).

^{xix} Prof. dr. Sylejman Topoljak, Pergjigje islame (Prishtinë, 2013), fq.404.

^{xx} Muhamed Xhibali, Sëmundja, rregulla dhe dispozita (Shkup, 2019), fq.101.

^{xxi} Po aty.

VEHBI SULEJMAN GAVOÇI: 10 VJET MALL

Dhjetë vjet qëkur Hoxha ynë, shejh Vehbi Sulejman Gavoçi, kaloi nga kjo botë...

Koha kalon, kujtimet ruajnë qetësinë e mallit. Gjurmët e diturisë, të përhapura në faqe librash, vazhdojnë të rrezatojnë në çdo shfletim, duke ngritur në piedestalet e nderimit dhe të mirënjohjes, ditë pas dite e kohë pas kohe, imazhin e Dijetarit, të Edukatorit, të Mësuesit, të Shembullit, të Udhëzuesit drejt moralit të fesë së tij dhe traditave të të parëve, kalorësit të mjadaneve të dijes e trashëgimisë së lidhur brez pas brez e të dalë nga gjokset e burrave besnikë - h. Vehbi Sulejman Gavoçi.

Nuri i shfaqjes së Hoxhës ditë pas dite shkëlqen si diell që na ngroh, edhe pse shpeshherë, si pa dashje, e harrojmë; a edhe e neglizhojmë praninë e tij. Kujtohemi ta kërkojmë vetëm kur bie shi, a kur qielli e mbulojnë re ngjyrë gri, ndonëse ai është përherë aty, si një bekim dhe mëshirë prej Allahut për ne. Edhe pse drita e tij është përherë aty, tamam si atë ditë të parë të takimit tonë, e atë ditë të fundit të tele-

fonatës që u mbyll me bekimet dhe lutjet e tij prindërore.

Vitet kalojnë, por lidhja e zemrës nuk e ka humbur fillin, nuk e ka thyer besën, as e ka shkelur premtimin; vazhdon me bindje e dashuri, me durim e sakrificë të mbajë në shpirt torçën e amanetit, duke u përballur me lloj-lloj shfaqjesh e fenomesh, përherë në besë e me lutje për ta forcuar Zoti në çdo rrahje e frymë.

Vitet kalojnë, madhështia e pranisë së Edukatorit vazhdon të dëshmojë mirësinë e Allahut ndaj nesh, fatmirësinë e takimit, bukurinë e shkëndijës së parë të ndezur, që nga momenti i kontaktit të parë të syve dhe, pa dyshim, rrugëtimin me bindje në atë rrugë të vizatuar nga zemra e të Bardhit Hoxhë, këshillat e të cilit na mëkuan për të mos u dorëzuar në rrugëtimet tona të dijes dhe të urtësisë...

Emri i Hoxhës vazhdon të përmendet përherë e më shumë, plot dinjitet e krenari, në një kohë krizash, dilemash e padrejtësish; në kohët kur imazhi i Prijësit është mjegulluar, e ku duar të shumta janë për-



zier për të devijuar rrugën, imazhin, mesazhin, duke e zëvendësuar portretin e Mësuesit tradicional me copëza të ngjitura portretesh artificiale, që s'formojnë dot një imazh...


Bukuria jusufike e shfaqjes Tënde, i Shtrenjti Mësues, mbetet kible për zemrën, dritësim për çdo hap, udhëzim për mendjen, e, mbi të gjitha, borxh i shpirtit, deri në ditën e kiametit!

Rahmet të pastë Shpirti, i Dritshmi Hoxhë Vehbi Sulejman Gavoçi!
Muhamed B. Sytari
(Shkodër, 19 shkurt 2023)



Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu mori pjesë në Akademinë përkujtimore të pesëvjetorit të ndërrimit jetë të Abdilaqim Ademit (1969-2018), Sekretar i Përgjithshëm i BDI-së, më parë Ministër i Arsimit dhe Shkencës i RMV. Njoftimi, shoqëruar me fotografi, është dhënë nga BFI dhe nga vetë Kryetari i BFI të RMV më 16.02.2023.

PËRKTHEU GËTEN DHE MBYLLI SYTË



Më 13 shkurt, 2023, në Tiranë, u nda nga jeta në moshën 89-vjeçare mjeshtri i lapsit dhe i fjalës Petraq Kolevica (lindur në Korçë, më 11 janar 1934). Me profesion ka qenë arkitekt, ndërsa në mënyrë aktive është marrë edhe me shkrime letrare.

“Arkitekti Kolevica i dha Korçës dhe Tiranës tendencat evropiane të ndërtimeve, të cilat u rezistuan dekadave me radhë për nga autenticiteti dhe koherenca e fasadave. Intellektuali i madh Petraq Kolevica ka qenë botues i disa studimeve dhe ka dhënë kontribut të çmuar në fushën e përkthimeve. Është nderuar me dekorata dhe çmime nga autoritete dhe institucione të ndryshme”, ka shkruar Ledina Alolli.

Për lexuesit tanë, me këtë rast, sjellim poezinë “Katër dhuratat” të Johann Wolfgang von Goethe (Gëte), të përkthyer nga gjermanishtja. Në shqip ajo tingëllon më bukur se në gjermanisht, kanë vlerësuar njohësit e përkthimeve të Petraq Kolevicës.

Katër dhuratat
Allah i madh e fuqiplotë,
Shkretirash të pamata,
Arabit na i dha për short
Këto katër dhuratat:
Një çallmë që më bukur ndrin
Se çdo kurorë mbreti,
Një çadër që e mban mbi shpinë,
Nën të pushoi e fjete.
Një shpatë që më tepër mbron
Se shkëmbi e se muri,
Një këngë që shpirti e këndon,
Kur vajza çel si nuri!
Përktheu nga gjermanishtja: Petraq Kolevica

KA NDËRRUAR JETË IMAMI I ULQINIT



Siç njoftohet, më 11 shkurt, 2023, ka ndërruar jetë Nusret Bajram Cenaj, Imam i Xhamisë së Pashës - Ulqin.

Në njoftimin që ka dhënë Ali Bardhi në Facebook thuhet:

“Haxhi Nusret ef. Cenaj me thjeshtësinë e tij udhëtoi pesë herë në ditë nga shtëpia në Kodra e deri te Xhamia e Pashës, duke filluar mëngjesve për namazin e sabahut e po ashtu kthehej mbrëmjeve vonë pas namazit të jashtë, shërbim të cilin e filloi në vitin 1998 dhe e vazhdoi deri në ditët e para të janarit të vitit 2023.

Ngushëllimet më të sinqerta familjarëve, besimtarëve të qytetit të Ulqinit, xhematit të Xhamisë së Pashës dhe Bashkësisë Islame. I bëjmë lutje Allahut të madhërishtëm ta mëshirojë dhe t'i sigurojë Xhenetin Firdeus. Amin.”

Me këtë rast, Myftinia Shkodër ka shprehur ngushëllime për ndërrimin jetë të Imamit nga Ulqini, h. Nusret ef. Cenaj. Në mesazhin e Myftiut Muhamed B. Sytari thuhet:

“I nderuar mr. Ali Bardhi. Nëpërmjet këtij mesazhi më lejoni të shpreh ngushëllimet e përzemërta familjes, Juve personalisht, Bashkësisë Islame të Ulqinit dhe krejt xhematit të Xhamisë së Pashës dhe përtej, për ndërrimin jetë të Imamit të nderuar h. Nusret ef. Cenaj.

Rahmetliu e kujtojmë për buzëqeshjen e tij, për qetësinë, komunikimin e çiltër dhe dashamirësinë me të cilat karakterizohej, duke dëshmuar shembullin e mirë të Imamit të përkushtuar dhe të njeriut me vlerat më të mira të besimit.

Të dorëzuar përpara caktimit të Allahut (xh. sh), lutemi që Krijuesi Fuqiplotë ta mëshirojë, ta falë dhe t'i pranojë veprat e mira, shërbimet dhe kontributet e tij në rrugën e Thirrjes Islame.

Allahu (xh. sh.) ju forcoftë, ju dhashtë sabër dhe rahmetliu e bëftë prej xhenetlive!”

NDËRROI JETË BEGZAT ALIU, KËRÇOVË

Ndërroi jetë Sekretari i Këshillit të Xhamisë së Qytetit, z. Begzat Aliu, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Kërçovës.

Më 4 shkurt, 2023, përcollëm për në botën e amshueshme z. Begzat Aliu, i cili shërbeu për një kohë të gjatë si Sekretar i Këshillit të Xhamisë Sulltan Pajazit, krahas punës së tij të rregullt në Komunën e Kërçovës.

Në emër të Myftiut të Kërçovës, të imamëve dhe të xhematit kërçovar, familjes Aliu i shprehim ngushëllimet e sinqerta, me lutjen që të ndjerin, xha Begzatin, Allahu (f. p.) ta mëshirojë për kontributin e dhënë, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Kërçovës, të nënshkruar nga Myftiu Qamil ef. Ru-shiti.

PËR NGUSHËLLIME TE FAMILJA HASANI



Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu qëndroi për ngushëllime te familja Hasani në fshatin Dëbërcë (Tetovë), me rastin e ndërrimit jetë të bashkëshortes së hoxhës së mirënjohur dhe të nderuar hfz. Bajram ef. Hasani.

Në emër të BFI të RMV u shprehën ngushëllime të thella, duke iu lutur Allahut fuqiplotë që merhumes t'i falë xhenetin, ndërsa hafëz Bajramit, z. Hasan ef. Hasanit, të birit, dhe familjes në përgjithësi t'u japë durimin e pashoq.

Hafëz Bajram efendiu me përkushtimin më të madh tërë jetën ia ka kushtuar

dhe vazhdon t'ia kushtojë Islamit si Imam në fshatin Dëbërc, si dhe duke qenë në funksione të ndryshme në Myftininë e Tetovës e më gjerë. Tash rrugën e tij po e vazhdon Hasan ef. Hasani, nëpunës i Myftinisë së Tetovës.

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahun e shoqëruan dr. Selver ef. Xhemaili, Drejtor i Mërgatës në BFI; z. Musanif ef. Rufati, Drejtor i Sektorit për Shkencë dhe Kulturë; dhe h. Ibrahim ef. Abdurrahimi, Imam në fshatin Çegran, Gostivar. (Shaqir ef. Fetahu, Facebook, 19.02.2023)



Agjencia për Hallall Standard
Агенција за Халал Стандард
Helal Standard Ajansı
Agency for Halal Standard
مكتب شهادة للمنتجات الحلال



Bashkësia Fetare Islame e R.M.V.

Add: Cairska 52.1000 Skopje, North Macedonia.
Tel: + +389(0)2 3117410; 3117 412.
Fax: + +389 (0)23117 883

websait: www.bfi.mk
email: halal.bfi@gmail.com